



PËLLUM B KULLA

PO MARTOJMË MALON

HUMOR-SATIRË

PO MARTOJME MALON Pëllumb Kulla


844-2
KPS

Pëllumb
Kulla

*Po martojmë
Malon*

MONOLOGË, DIALOGË, SKEÇE
KOMEDI ME NJË AKT ETJ.

48215
SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»



NGA BLOKU I SHËNIMEVE

1.

Një grua me tualet të rënduar nxitonte drejt stacionit të trenit. Ishte aq e kujdesshme për pamjen e saj të jashtme, saqë nuk lejonte as çrregullimin më të vogël. Lëshoi valixhet dhe shtriu çorapen e rrüdhosur. E pagoi. E la trenin.

2.

Ishte një ditë e bukur me diell të ngrohtë. Dolëm në ballkon, u ulëm atje dhe teshtitëm, teshtitëm... U kënaqëm.

3.

Mblesi është njeriu që shpie e sjell mesazhet e dashurisë së madhe të dy njerëzve që... s'janë njohur akoma.

4.

— Mami a do të jetë ditë pushimi më 18 maj? A do të varin flamurka nëpër rrugë?

— Jo, moj bija e mamit...

— Po ditët e festave bëhen pushim. Apo jo, mami?

— E ç'festë është 18 maji?

— Ditëlindja ime, moj mami!

5.

Një libër mund të lexohet me ëndje. Libri mund të përdoret edhe për të mbajtur pulla poste...

6.

— Çudi, o babi, unë këtu te lavamani i aneksit jam më e gjatë, te lavamani i banjës, nuk e kuptoj, jam më e shkurtër!...

7.

Nuk është shenjë edukate që atë nuse që tërë jetën ka shkuar keq me vjehrrën, ditën që i vdes vjehrra, ta shikosh në sy e në shami...

8.

Një dialog të dashuruarish në stacionin e trenit:

— Ke dalë të më presësh, Sokol?! Unë s'të lajmërova kur do të vija. Si e gjete ti?

— Kam metodën time.

— E si qenka kjo metodë?

— Asnjë metodë, moj budallaçkë e vogël. Thjesht: e dija që këto ditë do të vije.

— Po si qëlloi që dole të presësh këtë tren? Telepati? Komunikim mendimesh? Rastësi?

— Asnjë rastësi, Arta... Kam një javë që dal e pres çdo tren...

9.

Kur një pasagjer i zgjat shoferit para për nderin që i bëri duke e marrë në makinë e kur shoferi i shtyn paratë ngaqë nuk do t'ia pranojë (përralla)... e kur pasagjeri e shtyn t'i marrë... Shkurt: paratë mbeten tek ai që pushon së shtyri!

10.

Albana e vogël ra të flerë në krahët e gjyshit dhe pa në ëndërr gjyshin të veshur me të bardha, duke shitur akullore.

11.

Ai i gëzohej funksionit të ri. U gëzohej njerëzve që e përshëndetnin, se ndalonin dhe e takonin. U gëzohej ftesave, mbledhjeve... U gëzohej aq shumë sa që nata e bezdiste... Kur binte të flinte vetja i dukej pa vlerë. Kush e pat shpikur gjumin! Po dita a nuk është pak vetëm me njëzet e katër orë?!

12.

Atë që «qeni që leh nuk të ha», e mira e të mirave është ta dinë vetë qentë...

13.

Çdo gjë e bukur është bija e pagjumësisë.

14.

Regjisori i paaftë është edhe i mërzitshëm. Ai rri e shpjegon dy orë një gjë që aktorët e kanë kuptuar që në minutën e parë.

15.

Gjitoni im kishte tridhjetë vjet që mësonte frëngjisht. Ia dinte vlerën gjuhës së huaj dhe tridhjetë vjet s'bënte gjë tjetër veç hapte metodën edhe përsëriste: «Leve-vu! Aseje-vu».

Pardje vdiq. Sa e rëndë është vdekja nëpër

shënimet humoristike! E rëndë, jo e rëndë — ai vdiq!)

— Isha në paradhomë kur doli doktori.

— Nuk e zë mesnata, — tha duke larë duart.

Nga dhoma e të sëmurit doli edhe e shoqja.

— I hapi sytë, — tha ajo.

— T'i japim një lugë kos, — propozoi dikush.

— Jo, — ia bëri e shoqja me zë të mbytur nga vaji e duke fshirë hundët, — kërkon metodën e frëngjishtes...

16.

Shoku Telemak vuan nga skleroza. Dje na martoi dy fjalë të urta dhe ato pollën një të tretë. Tha: I zoti e di se ku i pikon gomari!

17.

Një drejtues i ansamblit amator të ndërmarrjes mbiu në zyrën e kuadrit.

— Të lutem shumë, shoqja shefe, kur i pranon në punë shikoi pak edhe nga zëri. S'kemi gjë në torbë po nuk patëm një bas. Na merr një bas!

18.

Kam punuar në turnin e tretë dhe dua të fle. Më zë gjumi. Fëmijët në dhomën e tyre nuk i zë aspak. Ata bëjnë zhurmë dhe gruaja i bie derës së tyre me grushta. Bam! Bam! Bam!

— Pushoni se do të zgjoni babanë! Bam! Bam! Bam!

— Unë jam i bindur se volejbollin e femrave në qytetin tonë mund ta ngremë me anë të... meshkujve. Mos më ndërprisni! Shtatë a tetë djem të mirë i trajton, i udhëzon dhe i dërgon me shërbim, fjala vjen, në Korçë. Me detyrë konkrete, të ndershme. Në gusht, shtatë-tetë martesa! Do të bëhet kampionati i ardhshëm: Korça në fund të klasifikimit. Ne — kampionë! Dëgjomëni mua: Për volejbollin e femrave vetëm meshkujt mund të na e zbardhin faqen.

Dimri erdhi. Zuri e ftohta. Kaldaja duhej riparuar, qymyr nuk kishim dhe disa xhama duheshin ndërruar. Dimri na zuri papritur, si të thuash pabesisht. Na zuri pabesisht, tamam siç na zuri vjet, siç na zuri parvjet, si na kish-te zënë vazhdimisht, që kur mbaj mend unë...



ASAF LALA KËRKON LARGIMIN

Komedi me një akt

VETAT: ASAFI — nëpunës BEKTASHI — drejtor
LIGORI — nëpunës NAZIFI — nëpunës LESKOJA —
inxhinier NËPUNËS TË TJERË

TABLOJA E PARË

Në bufe. Nazifi dhe Ligori pinë kafe. Leskoja ndahet me shokët. Vjen të ndahet dhe me Nazifin e Ligorin.

- LESKOJA — Mbetshi me shëndet!
NAZIFI — *(Duke i dhënë dorën)* Fillove atje?
LESKOJA — Fillova.
LIGORI — Urime! Punë të mbarë!
LESKOJA — Falemnderit! Edhe një herë: Mbetshi me shëndet!
(Përqafohen. Në atë kohë nga bufeja Asafi ka marrë bukën me kremviçe e vjen të hajë. Leskoja e takon edhe Asafin.)
LESKOJA — Asaf, mirupafshim!
ASAFI — Rrugë të mbarë!
(Leskoja largohet. Të tjerët që mbetën e ndjekin me sy.)
LIGORI — Çudi, si na iku ky djalë!
NAZIFI — U mërzit. Tani është mirë me ekspeditat.
LIGORI — Habitem si e lëshuan nga dora këta të drejtorisë. Punë e madhe se u mërzit!
ASAFI — Ka dy javë këtu vetëm ikja e Leskos diskutohet. Si iku?!... Qysh na iku? Nuk gjejmë më si Leskoja! Si e lanë? Na hëngrën veshët!
NAZIFI — Si thua ti, Safe? Pse e lanë të ikte?
ASAFI — Se nuk u prishte punë. Se nuk vlente një grosh!
NAZIFI — Leskoja ishte inxhinier i zoti. Studimet i mbaroi shkëlqyeshëm.
ASAFI — Hajde, se po e besoj. Po këtu ç'bëri? Për drejtorinë tonë Leskoja ishte një kuadër që si të ikte si të rrinte puna as ndre-

- qej as prishej. (*Ligorit*) Pa provo të kërkosh largimin ti! S'të lë njeri.
- LIGORI — Jo more! Nuk është ashtu.
- ASAFI — Ashtu dhe pikë! Pse nuk më lënë mua e tjetrin e tjetrin? Kuadrin me vlerë nuk e lëshon njeri. Të ishte veç me dëshirë, unë do të kisha ikur i pari. Pa provo t'u thuash shefave: lëreni Safen të largohet! Rrezik të të futen me grushta.
- NAZIFI — O oooo!
- LIGORI — Ke provuar të kërkosh largimin ti?
- ASAFI — Pesë herë.
- LIGORI — Kushedi si kanë qenë rrethanat më parë. Tani ka quadro plot. Nuk ka njeri të pazëvendësueshëm.
- ASAFI — Zëvendësohen ca si Leskoja.
- NAZIFI — Dhe Asafët dhe Asafët!
- ASAFI — (*Duke zier përbrenda*) Po më ofendon.
- NAZIFI — Aspak. Dhe për vete e them.
- ASAFI — Ty mbase, po mua nuk më lë njeri. Dëgjon! Dhe ja ku të them: mati fjalët! (*Asafi largohet me nervozizëm.*)
- LIGORI — Po ky ç'pati?
- NAZIFI — Përkëdhelet.
- LIGORI — Vërtet ka bërë pesë kërkesa për largim?
- NAZIFI — Deri tani as edhe një. Përkëdhelet.

TABLOJA E DYTË

Një javë më pas. Në drejtori. Bektashi po punon në tryezë. Troket dera.

- BEKTASHI — Hyrë!
 (*Hyn Asafi. Bektashi ngrihet, e takon Asafin dhe e fton të ulet në kolltuk.*)

ASAFI — Më kërkuat, shoku drejtor?

BEKTASHI — Po, ulu!

(Ulen së bashku.)

BEKTASHI — Si i ke nga shtëpia?

ASAFI — Mirë, çka.

(Zilja e telefonit. Bektashi ngrihet dhe merr receptorin. Pastaj e lëshon përsëri dhe vjen ulet afër Asafit. Nuk flet as njëri as tjetri. Drejtori i hedh dorën në gjunjë.)

BEKTASHI — Po si kështu, more Safe?

ASAFI — Ja kështu!

BEKTASHI — *(I zgjat paketën.)* Ndize!

(Të dy ndezin cigaret në heshtje.)

BEKTASHI — Po na ikën eh?

(Pauzë.)

ASAFI — Urdhëro?!

BEKTASHI — Po na ikën them, ëh?

ASAFI — Kush po ikën?

BEKTASHI — Ti de... Lexova kërkesën tënde. Ma përcollën ata të kuadrit dhe, të them të drejtën, se si më erdhi. «Ja edhe Safja ka dëshirë që të largohet, të lëvizë», thashë me vete.

ASAFI — Dhe ju do të më lini?!

BEKTASHI — Nuk duam të të pengojmë. Të kemi pasur shok të mirë e punëtor.

ASAFI — Dhe do të më lini?!

(Pauzë.)

BEKTASHI — Nuk të kuptoj, Safe.

ASAFI — S'ka ndonjë zor për ta kuptuar, shoku Bektash. Po ju pyes: ju jeni gati... si t'ju them? Ju, pa dredhur qerpikun, do të më lini që t'ju iki?!

(Bektashi ia hedh sytë tryezës dhe ngri-

het tërësisht i hutuar. Vete në tryezë e merr kërkesën.)

BEKTASHI — Po, më fal, a e ke bërë ti këtë kërkesë?

ASAFI — Unë.

BEKTASHI — S'po kuptoj...

ASAFI — (Duke u ngritur në këmbë) Atë kërkesë e kam bërë unë. Me këto duar. Kup-ton, shoku Bektash?

BEKTASHI — Jo, tani të them të drejtën, nuk po kuptoj asgjë.

ASAFI — Unë e humba arsyen. U çmenda... Harrova interesat e punës... ose nuk i harrova, xhanëm, por nuk desha t'i përfill. Ose më keq akoma: desha t'i dëmtoj. Ju do të më lejoni?

BEKTASHI — T'i dëmtosh? Jo! Në asnjë mënyrë.

ASAFI — Po atëherë ç'po mateni të bëni?

BEKTASHI — (Buzëqesh) Po ja, si thua ti? Si të veprojmë?

ASAFI — (Prerë) Si të veproni, gjejeni vetë! Unë po të isha në vendin tuaj do të thosha: «Ne, ore Safe, s'të lëmë të ikësh, sikur ta bësh dhëmbin kaq! Se të kemi kolonë. Se na ke ardhur këtu me pantallona të shkurtra. Pa të dirsur faqja. Se vezën tënde s'na e bën dot njeri».

BEKTASHI — Avash ti, Safe, avash!

ASAFI — Ç'avash! Unë jam shumë i ofenduar.

BEKTASHI — Po unë nuk po të kuptoj tani; ke apo nuk ke dëshirë të largohesh?

ASAFI — Ore, po unë po vë re gatishmërinë tuaj.

(Pauzë)

BEKTASHI — Shiko, shoku Asaf, ne kemi shu-

më punëra e nuk do të merremi me lodra tani. (Prerë) E ke shkruar ti këtë kërkesë?

ASAFI — Unë.

BEKTASHI — Atëherë pse merr përsipër të na mësosh si të gjykojmë?

ASAFI — (Duk u gëlltitur) Jo po...

BEKTASHI — Ti ulërin sikur po të pushojnë. Sikur po të lë njeri pa bukë. Do të ikësh që këtej, do të shkosh në një vend tjetër. Bile ne të kemi pasë projektuar nja dy herë të të lëviznim vetë që këtej.

ASAFI — Mua?!

BEKTASHI — Po ty.
(Pauzë.)

ASAFI — E... e pse nuk më keni lëvizur?

BEKTASHI — Ku di unë... Projekte janë këto. E nuk do të përmbysesj bota. As për ty as për mua... Vitet e shumta të punës nuk janë ndonjë meritë që ta tundim kaq lart... Ne i japim punës ajo na jep ne. Kalitet sa kalitet hekuri në zjarr e në ujë e pastaj u nxjerr gjuhën të dyve. Demek është vetëm merita ime!... Të dua por mos na u përkëdhel, Safe!
(Bektashi nis të lëvizë nëpër zyrë.)

BEKTASHI — Të mori e mira, të mori! Na hëngre gjithë këtë kohë. (Duke tundur kërkesën) Ç'të bëjmë me këtë?

ASAFI — Ku di unë!

BEKTASHI — A do që të ta plotësojmë dëshirën?
(Pauzë e gjatë.) Apo do që ta quajmë sikur nuk na e ke bërë këtë kërkesë?

ASAFI — (Duke psherëtitur.) Kjo do të ishte tamam zgjidhje e pjekur.
(Bektashi buzëqesh dhe e bën kërkesën)

*copë-copë. Në zyrë ka heshtje e Asaf La-
la ka frikë ta prishë.)*

ASAFI — Të dal unë, shoku Bektash? Se kam
ca punëra që nuk presin...

BEKTASHI — *(Duke e goditur supeve)* Të mo-
ri e mira, more Safe!

T'I MËSOJMË EMRIN AUTORIT

Dialog

VETAT: REDAKTORI I «HOSTENIT» XHEVDETI

Xhevdeti ngjit me nxitim shkallët e godinës së revistës «Hosteni». Ndalet përpara një dere. Troket. Dëgjohet thirrja «Hyrë!». Xhevdeti hap derën dhe hyn.

REDAKTORI — Xhevdet?

XHEVDETI — Si të kam, o kushëri?

(Përqafohen dhe puthen.)

Si jeni nga shtëpia?

REDAKTORI — Mirë. Ju si jeni?

XHEVDETI — Ja, me punë. E puna na ka zënë këmbët. Ndaj edhe nuk kemi ardhur. Ç'ke bërë ti? U fejove apo akoma?

REDAKTORI — U fejova edhe unë si të gjithë.

XHEVDETI — Ç'thua? Po ka shumë?

REDAKTORI — Ka ca.

XHEVDETI — Epo urime! Dasmën...

REDAKTORI — E bëra dhe dasmën.

XHEVDETI — Jo, mor, jo! Epo të trashëgohesh!
Nusja shkon në punë?

- REDAKTORI — Jo, tani nuk punon.
- XHEVDETI — Pse?
- REDAKTORI — Sapo ka lindur. Mban beben.
- XHEVDETI — Ç'thua, o kusho?! Të të rrojë edhe bebjat! Po nuk ka kush të ta mbanjë beben?
- REDAKTORI — Kush?! Djali i madh vazhdon shkollën, çupa në punë... Çupa tjetër s'e mban dot...
- XHEVDETI — *(I hutuar, mezi e mbledh veten.)* Ndahet njeriu... Ja unë... Dhe kushërinj të parë...
- REDAKTORI — Të dytë.
- XHEVDETI — Të dytë, po si të parë!... Harro hemi, se nuk takohemi... Nuk na lidh as puna.
- REDAKTORI — Po tani, ç'të lidh?
- XHEVDETI — Më kanë sjellë emrin këtu te ju. Në «Hosteni».
- REDAKTORI — Ç'thua? Në redaksinë tonë?
- XHEVDETI — Posi, në gazetë.
- REDAKTORI — Kryeredaktor?
- XHEVDETI — Jooo!
- REDAKTORI — Redaktor? Fotograf? Piktore?
- XHEVDETI — Jo, or jo! Brenda në gazetë. Kanë bërë një shkrim. Më kritikojnë.
- REDAKTORI — Aha...!
(Pauzë.)
- XHEVDETI — Mirë, por nuk e dimë, kush e ka bërë?
- REDAKTORI — S'është e drejtë kritika?
- XHEVDETI — Shumë e drejtë. Po dua ta di kush e ka bërë, që t'i them dy llafe. Ta lavdërojmë. T'i shtrëngojmë dorën. Me një fjalë dua emrin e tij, pa di unë si veprojnë pastaj.... Është një farë Peço Piperka. Pseudonim, patjetër.

REDAKTORI — Po ti duhet të vesh në zyrën e madhe, poshtë.

XHEVDETI — Ç'është kjo zyrë e madhe?

REDAKTORI — Atje ku tregohen emrat. Se ka shumë që bëjnë kritika, po nuk e shënojnë emrin.

XHEVDETI — Hë, atë dua edhe unë.

REDAKTORI — Shko pyet.

XHEVDETI — Po do të ma thonë mua ata?

REDAKTORI — Të jap unë një letër.

(Nxjerr një letër dhe udhëzon duke shkruar.)

REDAKTORI — Do të dalësh që këtej majtas, do të zbresësh shkallët.

XHEVDETI — Kati poshtë?

REDAKTORI — Kati poshtë... Do të ecësh djathtas, përballë është një portë e madhe.

XHEVDETI — E madhe?

REDAKTORI — Me dy kanata ...Trokit e mos u druaj, po hidh prakun... Aty trego letrën. Ta thonë ata.

XHEVDETI — *(Merr letrën)* Rrofsh, o kusho, e të fala gruas e fëmijëve. *(Me frikë)* Apo ke edhe nipër?

REDAKTORI — Jo, jo.

XHEVDETI — Bëj shaka, se do ta kishim marrë vesh. Ne pyesim gjithnjë për ju. *(Xhevde ti merr letrën e fluturon nga gëzimi. Del duke përsëritur: «Majtas! Zbresim shkallët! Djathtas!... Porta me dy kanata!» Troket dhe hap portën. Ka dalë... Jashtë në rrugë. Ka mbetur si i goditur. Lexon letrën. Aty shkruhet: «Të fala nga shtëpia!»).*

GABIME TË ÇUDITSHME

Dialog

VETAT: MËSUESI GIMI

(Në klasë. Mësuesi kontrollon detyrat e shtëpisë.)

MËSUESI — Gabime! Gabime! Shumë gabime ke bërë, more Gimi! I shikon?

GIMI — (Gati në të qarë) I shikoj.

MËSUESI — Lëri lotët tani! Edhë i ke bërë gabimet, edhe qan.

GIMI — (Ia shkrepi të qarit.) Gabimet... nuk... Unë... Detyrat m'i ka bërë babai.


(Pauzë. Gimi qan.)

MËSUESI — Fillove edhe të gënjeshtani. Kjo nuk është e mundur. Pa shiko: gjashtë herë gjashtë — tridhjetë e tetë. Shtatë herë tre-njëzet e pesë. Këtu: katër edhe tetë — gjashtëmbëdhjetë. Gjithnjë më shumë se sa duhet. Këtu njëzet më shumë. Këtu: dymbëdhjetë më shumë. Asnjëherë tamam. Asnjëherë më pak. Nuk i bën këto gabime një i rritur.

GIMI — (Qaraman.) E pra, ai m'i bëri.

MËSUESI — Ç'punë bën babai?

GIMI — Ka-me-rier...



MOTRA BËN DASHURI

S k e ç

VETAT: LIRIKA AGRONI MIRA FATOSI

(Është natë. Buzë një lulishteje. Lirika dhe Agroni po shëtitin të zënë përkrahu.)

LIRIKA — Agron, pse sa ishim pa martuar ne futeshim nëpër lulishte, uleshim në stola e sodisnim mbrëmjen. Tani as e kthejmë më kokën nga lulishtet. Parku nuk është vetëm për të pamartuarit. Eja të futemi edhe ne.

AGRONI — Sikur... sikur nuk ka lezet.

LIRIKA — E shikon sa keq mendon ti?! Hajde, për hatrin tim! (Hyjnë në park. Pak më tej në një stol është ulur një çift. Bien ca pika të rralla shiu, ndaj janë mbuluar me çadër.)

AGRONI — Ja, të gjithë stolat janë të zënë.

LIRIKA — Presim, se do të lirohet ndonjë.

AGRONI — Kush? Këta... As në mes të natës. Këta nuk i shkul që këtej as shiu, as breshëri.

LIRIKA — Agron!

AGRONI — Ç'pate?

LIRIKA — Ajo vajza qenka Mira, jot motër.

AGRONI — Vërtet?... Po, ajo qenka.

LIRIKA — Na panë. E shikon si e hapën çadrën për t'u fshehur? (Agroni nisët për te çifti. Lirika e kap për krahu.) Agron, mos bësh ndonjë marrëzi!

AGRONI — Jo, jo, lëshomë!

(Agroni u afrohet atyre të stolit. U del nga e majta, ata e spostojnë çadrën anë e majta, u del djathtas, po në çdo anë i vihet përballë një çadër e madhe e zezë. Agroni nxjerr një cigare.) Me leje, keni gjë shkrepsë? (Nën çadër ndizet një çakmak dhe pastaj një dorë e nxjerr çak-

makun jashtë.) Falemnderit! (Pas pak) Pushi shiu, shoko.

(Agroni kthehet tek e shoqja.)

LIRIKA — Agron, më dukesh pak i nevrikor-sur... Nuk e prisja këtë nga ti.

AGRONI — Nuk kam ndonjë kundërshtim të shëtitë me shokun. Le të ulet dhe në park. Po pse të fshihet? Mos është gjë frikacak ai?

LIRIKA — Edhe ti je fshehur.

AGRONI — Nga babai. Po ata fshihen nga unë. Mua ajo më ka shok, nuk më ka vetëm vëlla. Dhe me atë djalin më ka njohur.

LIRIKA — Ai ishte?

AGRONI — Po, po, E njoha nga çakmaku. Po ajo nuk më ka thënë asnjëherë që e do... Unë gjithnjë e kam pyetur.

LIRIKA — Ka pasur frikë.

AGRONI — Ashtu. Le të ketë frikë. Meqë ka frikë, hajde!

(Hiqen mënjanë. Në skenë mbetet çifti.)

MIRA — Ngrihemi tani. Të paktën të jem përpara tyre në shtëpi. Nga shkuan?

FATOSI — E ku i pashë unë? Më linte çadra mua!

MIRA — Ti më duket se po dridhesh.

FATOSI — Unë? Jo. Po edhe në dridhem, dridhem për ty.

MIRA — Ikim që këtej.

(Ngrihen. Ndërkohë Agroni dhe Lirika u dalin përballë.) (E hutuar.) Mirëmbërëma!

AGRONI — Hë, u ngrysët mirë?

FATOSI — Mirë falemnderit!... Çka...

AGRONI — Nga ishit kështu?

MIRA — Ja...

FATOSI — Dolëm njëherë, kështu... Vërdallë... Ç'të bësh?

AGRONI — Nuk ke ç'i bën jo... Nuk ke ç'bën...

Ti, motër, do të vish në shtëpi apo ke qejf të sillesh akoma vërdallë?

MIRA — Jo, jo, në shtëpi do të vij.

AGRONI — *(Fatosit)* Këtej e ke rrugën ti? *(Bën me dorë djathtas.)*

FATOSI — *(I vendosur të mos ndahet.)* Po, këtej.

AGRONI — *(Ndërron drejtim.)* E po ne e kemi këtej. *(Bën me dorë majtas.)*

FATOSI — *(Aty për aty.)* Në fakt unë e kam andej nga thashë, por andej është hapur një kanal dhe unë i bie këtej nga ju. *(Pauzë.)*

AGRONI — Mos ishit ulur në atë stolin atje pak më parë?

FATOSI — Po.

AGRONI — Mirë, mor shok i dashur... Me ç'të drejtë ulesh ti në orën 10 të darkës në një park të errët edhe mbulohesh me çadër kur nuk bie as edhe një pikë shi?!

FATOSI — E ç'ka?... Na pëlqente dhe...

AGRONI — Po nuk më pëlqen mua se... Çfarë e ke ti motrën time?

MIRA — Shiko, Agron... Unë Fatosin e kam... e kam... shok të ngushtë.


FATOSI — E ç'të keqe ka se u mbulova me çadër?

AGRONI — More, ti mbulohu. Le të mos bjerë shi, ti dili së keqes përpara. Po belaja është se nën atë çadër ndodhej rastësisht edhe motra ime, e cila ka lajmëruar babanë se do të vonohet në një mbledhje me temën: «Ta bëjmë librin mik të shtëpisë».

FATOSI — Ta bëjmë posi!

AGRONI — More, ta bëjmë që ç'ke me të! Mos m'u përdridh ti... Nejse ti, Mira, eja të

- shkojmë, se e vazhdojmë bisedën në shtëpi.
- FATOSI — E ç'do t'i bësh?
- AGRONI — Nuk do t'u jap llogari shokëve të ngushtë...
- FATOSI — Unë nuk e kam vetëm shoqe të ngushtë... Unë e dua atë.
(Pauzë.)
- AGRONI — Ashtu? (Mirës) Po ti?
- MIRA — Ne me Fatosin do të martohemi.
(Pauzë. *Lirika qesh.*)
- FATOSI — U qetësuar tani?
- AGRONI — Aspak. Bile jam shumë i prekur. Bile, bile shumë i fyer.
- MIRA — Pse?
- AGRONI — Unë nuk dua që motra ime ta dojë djalnin fshehur si ndonjë hajdut. Kjo nuk na nderon as ne as ju. Ne do të na kujtojnë bota syleshë e juve frikacakë. Kështu u lihet shteg qindra thashethemeve. Kurrë mos u fshihni më.
- MIRA — Mirë, Agron, po ti e di që babi...
- AGRONI — Hajd, hajde se do të na kuptojë edhe ai... Tani do të vini?
- FATOSI — Bobo, vajti vonë... Kemi ditë plot.
(U jep dorën femrave, pastaj Agronit.)
- AGRONI — Unë të mora për frikacak, po ti qenke...
- AGRONI — Unë të mora për frikacak, po ti qenke...
- AGRONI — Të të them të drejtën kur ju pashë, më hipi gjaku në kokë.
- FATOSI — Dhe unë, të të them të drejtën, kur të pashë u tremba ca... Natën e mirë!
- MIRA — Tosi, kujdes mos biesh në kanal!
- FATOSI — Mirë, mirë... (Me vete) Pyes më për kanale unë ore!...



PRINDËR NË PROVË

Ata që e njohin djalin tim tetëvjeçar, Titin, e marrin me mend se si më pyeti atë natë kur u ktheva nga mbledhja që bëmë në shkollën e tij.

Kuzhina plot. Aty nëna ime, babai, vjehri dhe vjehrra.

— E ba, u zgjodh komiteti i prindërve?

— U zgjodh, — ia bëra unë.

Qetësi. Në lavaman çukiste një pikë e rrallë.

— Ty... të zgjodhën?

Unë s'iu përgjigja.

— Të zgjodhën, ba?

— Jo, — i thashë unë si fajtor.

Ai më pa me keqardhje dhe unë ula kokën. Në atë çast për atë isha njeriu më i pavlerë në botë.

Kolektivi gjyshëror u hodh në ndihmë.

— Epo nuk zgjidhen të gjithë. Dhe komiteti i prindërve i duhet Lames! S'u zgjodh Lamja e kushedi ç'humbëm! Hë-Hë!...

Po për sytë e Titit unë kisha humbur shumë. Ai mori çantën, më pa dhe një herë si me përçmim e iku në dhomën tjetër për të bërë detyrat.

Për Titin s'kishte rëndësi që në punë unë jam kryetar i organizatës të bashkimeve profesionale, që jam kryetar për zgjidhjen e konflikteve, që në lagje jam aktivist i kalitur e nënkryetar i komisionit për higjienën e shkollëve... S'isha zgjedhur në shkollë! — të kurdisura ishin edhe të tjerat...

Të gjithë fajin ma ka ime shoqe. Se nga vete e për Titin më merr mua si shembull të gjallë. Më quan shembull të punëtorit duarartë, të prindit korrekt, të qytetarit të stëredukuar, që jo vetëm nuk hedh cigaren përdhe, por mbledh edhe fletët që rrëzon vjeshta; të ba-bait ish-kalama, që ka qenë nxënësi më i rregullt, më i pastër e më i zgjuar në mes të të gjithëve: që ka qenë shembull i shembujve. I thotë bile që kanë qenë nisur çdo ditë me qindra e qindra nxënës, në ekskursion, nga Kukësi e Saranda me autobusë, për të më parë mua! E se,

gjoja, për herë të parë në historinë e arsimit botëror, nota dhjetë ishte pak dhe për mua përdorej nota njëmbëdhjetë... «Lame, dua që djali të na bëhet i mirë, prandaj t'i zmadhoj vlerat ty e të bëj si monument nër sytë e tij. Dua t'i zgjoj sedrën!» Fol me time shoqe! Po sedra ime?... I shkreti monumenti im, si është katan-disur! Ca nga gruaja e ca nga mësuesja e djalit.

Unë s'di për ju, or vëllezër, por mua mësuesja e djalit më jep detyra:

— Me kompensato, — u thotë fëmijëve, — do të bëni një kazmë, një lopatë, një çekan dhe një vapor. Do t'i bëni ju! Ju s'i bëni dot kurrë, por t'jua bëjnë prindërit. T'i sillni nesër, se do t'ju vë nota...

Prindërit... Sa për Titin tim, ajo dihet. Nga këta lloj prindërish ai vetëm një ka... Monumentin!... Se ime shoqe nuk ia vërshellen fare.

Pa vete gjej kompensato, sharrë. Pa i sharroj. Pa s'më bëhen të mira. Pa djali qan. Pa më vete shpirti në majë të hundës...

Të nesërmen djali më hedh në tavolinë një fletore me notën e mësueses.

— Na, ba. Gjashtë more.

— Unë apo ti?! — i them duke mposhtur inatin.

— Ti, ti, — më thotë. — Unë s'bëra gjë. Ti e bëre. Dhe je duarartë! Hm!

— Po Vasoja? — pyes për fqinjin sipër, që ka vajzën në një klasë me Titin.

— Xhaxhi Vasoja, dhjetë.

— Do të ketë ndonjë kompensato të mirë ai, — them nëpër dhëmbë. — Varet nga kompensatoja...

— E-e-e! Duhet të të vijë një çikë turp! Ti nxënës i njëmbëdhjetës! — më ysht djali. — Sot ke një detyrë tjetër: do të më bësh një metër

prej kartoni dhe këtë problemin: Çimi hëngri pesë akullore më pak se Tefta, e cila hëngri dy akullore më shumë se Genci. Sa akullore..., — dhe — vazhdon një xhumbë akulloresh, që të shuajnë nga bajamet e duan një qerre penicilina

— Mësuesja tha që të na i bëni ju prindërit, se për ne është e vështirë.

Po kjo pikë e zezë!

Këtë radhë i futem punës seriozisht. Ia kaloj Vasos. Unë nëntë, ai shtatë.

Titi prapë s'është i kënaqur.

— Çka, — thotë. — Sot do të më bësh një orë muri prej kompensatoje dhe tetë fjali me fjalën «lopa».

— Lopa! — i them i tmerruar. — Unë?!

— Ti, po kush unë? — ma pret djali. — Për prindërit, — tha mësuesja.

— Po ky është kulmi, more bir! Po unë kam punë të tjera. Këto mësueset pse s'japin detyra që mund t'i bëni ju? Unë kam kryer shkollë të lartë. Shkollën fillore e kam të vështirë...


Po pyet djali?...

— U trembe, ba?! Eh, se ke qenë dhe nxënësi i njëmbëdhjetës!

Ah, grua, grua! Ah, moj e uruara mësuese! Më turpëruat! Le që s'kam kohë të dal me një shok. Kur takoj Vason, ai s'ndalon fare...

— Më lërë, — thotë, — kam detyrat.

Ja, po dëgjoj të trokitura nga kati i sipërm. Është Vasoja. Ka një raport për të shkruar, i ziu, e më thërret për detyrat që na ka dërguar mësuesja. Do t'i kopjojë nga unë... Ç'na gjeti!...



XHA RRAPI SHFAQ SHENJA
TË ARROGANCËS

S k e ç

VETAT VANGOJA — zëvendës drejtor i ndërmarrjes
SHEFITI — punonjës i llogarisë RRAPI — karrocier

Në zyrën e Vangos. Vangoja dikton, Shefiti shkruan e Rrapi pi duhan.

VANGOJA — Fakti që plani i ndërmarrjes ka ecurinë e tij brenda limiteve të arsyeshme demonstroi në mënyrë të pakontestueshme se të metat që ndeshim aty-këtu janë të padenja për konsideracionin minimal.

SHEFITI — (Mbaron frazën) ...minimal.

RRAPI — (Me admirim) Sa bukur llafoseni ju... E moj shkollë, eh!

VANGOJA — (Shefitit) U lodhe?

SHEFITI — Ç'thoni ashtu, shoku nëndrejtor! Këtë punë kam unë. Ditë të tëra mund të shkruaj e të mos lodhem hiç.

VANGOJA — Pra të metave relativisht të pakta ekzistuese ne u kemi deklaruar një luftë ofensive, pa pauza e pa kompromis. Shkurt, gjendje e shkëlqyer e përzier me vështirësi të rritjes. (Rrapit). Do të shtosh gjë ti, xha Rrapi?

RRAPI — A jo, jo!... Si të shtoj? Ku di unë nga këto kështu.

SHEFITI — Po atëherë ta mbyllim.

VANGOJA — Shëno emrat e komisionit. Në krye vë xha Rrapin. Në krye!

SHEFITI — T'ia japim edhe drejtorit t'i hedhë një sy.

VANGOJA — Jepja drejtorit. Patjetër. Daktilografoje e na e sill për firmë.

RRAPI — Po mua ç'më ngatërron, o shoku nëndrejtor?

VANGOJA — Ty të kemi të parin, xha Rrapi... Ne ngarkohemi të bëjmë një informacion

zyrtar e në komision të futim dhe ty...
Pse? Se fjala jote bën vend. Se të kemi
punëtor të vjetër. Ti sjell frymën... ti... ti...

RRAPI — E e... ja i thatë ju ashtu si i thatë
dhe...

SHEFITI — Po ti po pate gjë e shtojmë.

RRAPI — I kam si të pakrehura llafet unë e
sesi më duken pas atyre tuajave, që kur i
dëgjon të bën rehat veshi.

VANGOJA — Duhet t'i thuash, xha Rrapi.
Shkruaj, Shefit!

(Rrapi gëlltitet. Shefiti bëhet gati.)

RRAPI — Po ja... T'i themi edhe ca gjëra copë.
Të themi aty se ca nga javashllëku i fur-
nizimit e ca ngaqë puna s'u ka hyrë ta-
mam në gjak ata të repartit të tretë pu-
nojnë... ç'të them, mesatarja gjashtë orë!
Rrezik edhe pesë! Ku i shpie mushka?

SHEFITI — *(Vangos, i pakënaqur.)* Mushka do
të shkruaj unë tani?!

VANGOJA — *(Duke u menduar)* Xha Rrapi tho-
të... shkruaj! Xha Rrapi thotë: *(dikton)*
Me gjithë rezultatet jashtëzakonisht të
pëlqyeshme duhet parë edhe më tej shfry-
tëzimi racional dhe rendimental i minuta-
zhit në dispozicion.

RRAPI — Kështu them unë?! Tëmën, thënkam
bukur!

SHEFITI — Kështu po. Vërtet, nuk të duket
bukur?

RRAPI — O po unë nuk e marr vesh, por
mjaft që të dalë aty se në repartin e tre-
të punohet gjashtë orë në ditë.

SHEFITI — Del. Vetëm mushkën ta hoqëm.

RRAPI — Të themi dhe për dushet. Për nëntë
metro tub nuk u vjen uji dhe nuk la-
hen punëtorët. Dushet janë e ujë s'ka. Pi-
kë e zezë!

- SHEFITI — (*Duke pritur nga Vangoja*) Si ta...
- VANGOJA — (*Përkthen fluturimthi*) Me gjithë arritjet e pakrahasueshme anekënd e tej-embanë mjediseve të ndërmarrjes në drejtim të kushteve komode, ende tek-tuk...
- SHEFITI — (*Duke shkruar*) ...tek-tuk...
- VANGOJA — ...kërkohen përpjekje për një përsosmëri edukate dhe me kontinuitet. (*prerë*) Mbyllë tani, Shefit!
- RRAPI — Kam edhe diçka tjetër.
- SHEFITI — Thuaje! Ti folë — unë shkruaj!
- RRAPI — Të vëmë edhe një kritikë për drejtorin. Personale.
- SHEFITI — (*Shtyn fletët*) Tani u lodha unë. M'u lodh dora. (*Pauzë e rëndë.*)
- VANGOJA — Ç'kishte për drejtorin?
- RRAPI — Po ja... është allosoj. Të them aty që thërret... ulërin pa vend. (*Pauzë. Shefiti shikon Vangon.*)
- VANGOJA — (*Sqaron*) Ky informacion, xha Rrapi, do të vejë lart. Kupton? Lart.
- RRAPI — Kuptoj. Unë prandaj e them. Që ata lart në Komitet ta dinë sagllam. (*Përsëri pauzë*)
- SHEFITI — (*Vangos*) Si t'ia bëjmë? (*Përsëri pauzë*)
- RRAPI — Unë them ta shënojmë. (*Përsëri pauzë.*)
- VANGOJA — (*Mbledh supet*) Ta shënojmë.
- SHEFITI — (*Rrapit*) Pra ti thua që të shënojmë se drejtorin e kemi arrogant.
- RRAPI — E, arrogant! Se s'po e gjeja dot si i thoni ju. Ashtu vëre. Se e ndreqim. Erdhi një ditëzaj... As mirëmëngjes nuk tha, por nisi t'u ulurinte atyre të ngarkim-shkarkimit... Dhe në zyrë është arrogant.
- VANGOJA — Shënoje. Nuk do ta lëmë pa e shë-

nuar vërejtjen e xha Rrapit. Shëno: Të shokët e drejtorisë herë-herë ka shfaqje të arrogancës.

RRAPI — Jo te shokët e drejtorisë. Unë e kam për drejtorin.

VANGOJA — E njëjta gjë është.

SHEFITI — Epo kuptohet, xha Rrapit!... Po u tha «shokët e drejtorisë» kjo kritikë mbi drejtorin bie.

(Pauzë.)

RRAPI — Epo mirë... Vere «shokët e drejtorisë».

SHEFITI — (Nis të shkruajë, pastaj e lë.) Po sikur të themi «shokët e administratës»? Në kolektivin e administratës ka shfaqje të arrogancës.

RRAPI — Jo «të administratës». A e lamë «të drejtorisë»?!... Asëll, asëll unë e kisha për drejtorin...

VANGOJA — Po ç'është administrata? Nuk është drejtoria me krahët e saj? Kështu bie më rëndë.

SHEFITI — (Rrapit) Ta bëjmë «administratës»?

RRAPI — Mirë. Bëje, meqë administrata qenka drejtoria e meqë drejtoria rëndoka mbi drejtorin.

VANGOJA — Shkruaje, Shefit! Hë, përse mendohesh?

SHEFITI — Mendohem se pastaj do të thonë...

RRAPI — O po mos ma thirrni, kaq shumë se edhe unë jam në komision. A e lamë «të administratës»?

SHEFITI — Po nesër do të na thonë se edhe administrata është pjesë përbërëse e tërë kolektivit. Pse e veçoni administratën, do të na thonë.

VANGOJA — Ashtu është. Administrata e veçuar nuk tingëllon mirë.

(Pauzë.)

RRAPI — Po ju vetë u futët nëpër këto monopate. Unë e kisha për drejtorin.

(Të tre mendohen)

VANGOJA — Do ta lëmë kështu. Shëno: E pranojmë hapur se në kolektivin tonë ka shfaqje të arrogancës. Dhe mbylle raportin.

RRAPI — *(Duke parë herë Vangon, herë letrën që shkruan Shefiti)* Kolektivi?! Po për drejtorin nuk u tha gjë? Këtu s'del hiç. U zbut... u... u... rrumbullakos... u... u... zbut... Daleni!

VANGOJA — Të pranosh që në kolektiv ka shenja të shfaqjes së arrogancës është goditje përmbi titullarin e saj. *(Shefitit)* Mbarove? Pikë. Mbylle.

RRAPI — *(Befas i vendosur)* Ky raport nuk vete lart.


VANGOJA — Si?!

RRAPI — Do të bëjmë tjetër.

(Rrapi e merr informacionin dhe e gris çika-çika.)

SHEFITI — Xha Rrapi, ç'na bëre?!

RRAPI — Mos ma vini re. Jam arrogant. A thamë që në kolektiv ka shenja? Ato shenja i kam unë. Do të raportojmë për së mbari!...



PO MARTOJMË MALON

S k e ç

VETAT: TOLI ARSHIU HALLA VJEHRRI VJEHRRA
NUSJA E MALOS

Mëngjesi pas dasmës. Në mes të çrregullimit të heshtur të dasmës shihen pjatata të stivosura, shishe të zbrazura. Ata dasmorë që kanë dashur ta gdhijnë vazhdojnë të këndojnë:

Po martojmë Malon,
harxhet shkojnë lumë;
gjashtëqind dasmorë,
gjashtë net pa gjumë.

Çelur që dy javë,
këngë e karamele!
Tridhjetë damixhanë,
tridhjetë kokë dele.

Të na trashëgohesh, Malo!
Mot me borokoç, o Malo!
Si kjo dasmë s'bëhet, Malo!
Rrofsh, o Malo, që na thirre!
Rrofsh, o Malo, që na ngjire!

Po martojmë Malon
me tri palë saze,
njëra qan Minushin,
dy tango dhe valse.

Po martojmë Malon,
dasmë në tri salla!
Atje vallen tezja,
këtu këndon halla!

Rrofsh, o Malo, që e tunde!
Rrofsh, o Malo, që na shkunde!

(Që nga dhomat e tjera vijnë ende të përgjumur Toli dhe Arshiu, që përgatiten të largohen në heshtje.)

—

TOLI — E martuam dhe Malon!

ARSHIU — Ikim, se do të na lërë treni. E kemi harruar punën kaq ditë.

TOLI — Lëre, lëre... Po si do të ikim pa takuar njerëzit e shtëpisë?

ARSHIU — I takuam gjashtë ditë rresht... Tani të nxitojmë, se do të na lërë treni.

TOLI — Kemi dhe gjysmë ore... Sikur të pinim dhe një kafe.

(Troket te dera e një dhome). Hallë! Hallë, moj!

(Duke hedhur trikon krahëve shfaqet halla.)

HALLA — E e... U ngritët ju?

TOLI — T'i takojmë të zotët e shtëpisë? Apo...

HALLA — T'u bëftë halla... Zakoni e do t'i takosh e t'i urosh.

ARSHIU — Po ne i uruam kaq ditë e kaq herë. Do të na lërë treni.

HALLA — Nuk ka lezet të ikni ashtu. Nusja po ju bën kafetë.

TOLI — Hë m'i lumshin duart! Këto kafetë! Më duket zakoni më i bukur i dasmës.

VJEHRRI — (Duke ardhur.) Po ikni, or miq?

ARSHIU — Po ikim... Në gëzime të tjera tani! Treni po afron.

VJEHRRI — Të tuajat!

(Shfaqet dhe vjehra.)

VJEHRRA — Po ikni?

TOLI — Në gëzime të tjera, mama!

- VJEHRRA — Në tuajat! (*thërret*) Nuse!
 (*Që tej duket nusja me tabaka. Në të janë vendosur dy filxhanë.*)
- TOLI — (*Duke fërkuar duart*) Erdhi kafeja!
- HALLA — (*I pëshpërit*) Zakoni e do të darovitet nusja.
 (*Pauzë.*)
- TOLI — (*Me pëshpërimë.*) O o, po ne kemi harxhuar para sa s'bëhet më.
- HALLA — (*Me pëshpërimë*) Nuk do të prishim zakonin.
- TOLI — (*Me pëshpërimë.*) Nga sa duhet të hedhim?
- HALLA — (*Me pëshpërimë.*) Nga pesëdhjetë lekë.
 (*Pauzë e rëndë, ndërsa nusja afrohet*)
- ARSHIU — (*Me pëshpërimë*) Të thashë, të kishim ikur. Deshe kafe ti. (*Nusja u jep kafetë. Ata i hedhin në tabaka nga pesëdhjetë lekë. Vjehrrin tashmë e ka zënë gjumi përsëri.*)
 — Pije tani, se erdhi treni.
- TOLI — Është e nxehtë. (*Nuses*) A ka mundësi një gotë ujë? (*Hallës*) Pse nuk flet nusja? As nuk lëviz.
- HALLA — (*Shpjegon*) Zakoni e do që ujin ta sjellë vjehrra. (*Duket vjehrra me një tabaka me gotat e ujit.*)
- TOLI — (*Hallës me pëshpërimë.*) Duhet hedhur gjë?
- HALLA — (*Me pëshpërimë*) Po nuk hodhe është turp. Zakoni.
- TOLI — Zakoni, zakoni po...
 (*Hedh në tabaka njëzet e pesë lekë. Vjehrra i zgjat Arshiut gotën tjetër.*)
- ARSHIU — Falemnderit! Ujë nuk dua.
- VJEHRRA — Është zakoni, biro.

HALLA — E do zakoni.

(Arshiu hedh dhe ai njëzet e pesë lekë duke parë Tolin me inat. Toli zgjat në tabaka gotën e boshatisur, por vjehrra nuk ia merr. Gotat i merr nusja. Ata hedhin lekë përsëri e japin gotat.)

Kot i hodhët këto. Gotat kthehen pa darovë, pa para.

TOLI — Le t'i marrë. Ku dimë më ne ç'është zakon e ç'nuk është zakon.

(Fishkëllima e trenit.)

VJEHRRRA — *(Hyn me vrap.)* Treni! Erdhi treni!

(Toli dhe Arshiu pinë qetësisht kafetë.)

HALLA — Dëgjoni? Lini kafetë! Treni! Nisuni!

TOLI — Unë do të pi kafenë.

ARSHIU — Ku do të vemë?! Gjashtë ditë dasma e Malos. S'na ka mbetur më asnjë lek.

(Pinë kafetë pa u nxituar. Sirena fishkëllen e fishkëllen.)

MANUAL PËR DREJTORË TEATROSH

(Fraza të gatshme për marrëdhëniet me dramaturgët)

KUR AI TË VJEN NË ZYRË:

- Varianti I O, mirë se na erdhët, ju prisnim!
» II — Sa do t'ju telefonoja!
» III — Ejani, ejani. Drama juaj na ka vënë në lëvizje tërë teatrin.

KUR NUK KE PASUR KOHË T'I LEXOSH DRAMËN:

- Varianti I — E fillova që atë ditë, s'më pritej, por vetëm një tablo kam lexuar. Ku të lë puna! Por ama, po qe e tëra në nivelin e tablosë së parë, më lejoni t'ju vë mbi të gjithë dramaturgët që kemi.
- » II — Një kopje kemi. Po e qarkullojmë. Merre me mend, s'po më bie në dorë. Duket që është me interes.

- » III — Drama më tronditi. Nuk do ta besosh, por nuk e vazhdoja dot. Dhe e lashë fare. Takohemi pas dy javësh. Do të më ketë kaluar tronditja.

KUR KE VENDOSUR TË MOS MERRESH ME TË:

Varianti I — Drama s'na ngopi.

» II — Drama fironte nëpër faqe.

» III — Tingëllon e thatë, ka shumë ujë brenda.

» IV — Ka vetëm një veprim. Të mërzit.

» V — Ka shumë vende veprimi. Copëzohet.

PËR TEMËN E DITËS:

Varianti I — Tema e ditës është e vështirë. Presim nga ju një dramë me temën e luftës.

PËR TEMËN E LUFTËS:

Varianti I — Tema e luftës është rrahur shumë. Publiku mezi pret temën e ditës.

» II — Drama juaj ka një temë, si të thuash... kemi vënë me këtë temë. S'vëmë më.

Varianti ekstra — Nga kjo temë s'kemi vënë e se si na vjen...

KUR DO QË TË ZBUTËSH ZEMËRIMIN E AUTORIT:

Varianti «Hiqe qafe» — Pse nuk e bëni skenar këtë dramë? Do të dilte vërtet një film i rrallë. Fenomenal!

Një të vjetri — Ju jeni i vjetër në këtë fushë. E dini sa e vështirë është dramaturgjia. Ju pata thënë që në fillim: shkruani më mirë vargje.

Një të riu — Mos u nxitoni. As mos t'ju priten forcat. Ju jeni i ri. Dramaturgjia është rrugë e vështirë. Ama mos iu ndani, se është e bukur.

Varianti «Diagonal» — Ju shkruani bukur, ama këtë dramë sikur nuk e keni shkruar ju. Mos keni pasur ndonjë hall? Vërtet, si i keni nga shtëpia?

KUR DO QË T'I HAPËSH PUNË

Varianti «Bombë» — Plase konfliktin që në faqen e parë. A ka mundësi që në kapak?

Varianti «Peshë» — Dramën e ke të rëndë. Futti pak humor.

Varianti «I lehtë» — Pastroje nga komizmat. Ato ta bëjnë dramën të lehtë.

Varianti «Sasi» — Bukur që drama zhvillohet në një organizatë grash, por ka një të metë të madhe. Ka shumë femra.

Varianti «Pykë» — Dashurinë do t'jua heqim. Puthjen nuk e realizojmë dot.

Varianti «Kafe» — Atë personazhin negativ si shumë e lë të livadhisë. Na e vdis sa më

shpejt, se mezi durohet. Ja edhe tani që e kujtoj më hipën gjaku. Dalim, t'ju jap një kafe.

KUR E PËRCJELL:

Varianti «Eja» — Ndreçini këto vërejtje dhe ejani të merrni të tjera.

Varianti «Brenda» — Mos u nxitoni në riparimin e dramës. Kemi kohë. Ndërkaq ne po vëmë dramën «Lulja mbi shkëmb». Ajo është e njohur, e kolauduar. Është vënë në pesë teatro.

Varianti «Jashtë» — Kështu, mos u druani të trokisni në teatrin tonë. Vërtet drama juaj mbetet jashtë, por për ju dyert janë të hapura.

KUR KE DËGJUAR SE DO TË TË HEQIN SI TË PAAFTË:

Varianti «Për herë të fundit» — Shikoni, kur ta sillni veprën mund të gjeni një drejtor të ri. Prej vitesh po kërkohet të iki. Deri tani nuk më kanë lënë. Më në fund po ma miratojnë kërkesën. Do t'u çalojë ca puna, por më shumë u dhimbset shëndeti im. Do të largohem...



SERVET BEU JEP ZGJIDHJE

S k e ç

(Nga fondi i humorit popullor)

VETAT: NEXHIP EFENDIU — kryetar i bashkisë OS-MANI — sekretar në bashki SERVET BEU — nëpunës i lartë i ardhur nga Tirana MEMUSHI — shërbëtor.

Ngjarja zhvillohet rreth pesëdhjetë vjet më parë në kohën e regjimit antipopullor zogist. Nexhip efendiu ndodhet në zyrën e tij.

MEMUSHI — Zotin sekretar e thirra. Po vjen.

NEXHIPI — Si i the?

MEMUSHI — I thashë: Z. kryetar i bashkisë të kërkon në zyrën e tij.

NEXHIPI — Ç'po bënte?

MEMUSHI — Kish shpënë kolltukum te penxherja, shihte jashtë e pinte duhan.

NEXHIPI — Mirë. Tani zbrit e na sill dy kafe. (*Memushi del. Pas pak në zyrë hyn Osmani.*)

NEXHIPI — Urdhëro, zoti Osman!

OSMANI — Më thanë se këtu paska ardhur nga Tirana Servet beu.

NEXHIPI — Për këtë të kam thirrur. Urdhëro e ulu. Që të mos të të zërë apansëz, zoti Osman, do të të them se për ç'punë ka ardhur këtu Servet beu. Të mos të të thosha do të të dukej si e bërë prapa krahëve.

OSMANI — Urdhëro, Nexhip efendi. (*Osmani mbush llullën. Ndërkohë Memushi sjell kafetë dhe del.*)

NEXHIPI — Servet beu ka ardhur këtu për punën tënde.

OSMANI — Për punën time?!

NEXHIPI — Siç e di, zoti Osman, unë punova këtu një vit e ca pa sekretar bashkie. Punë kisha shumë. Prit miletin e lexo lutjet e kthe përgjigjet... Kërko e kërko sekretar...

OSMANI — Po ja erdha unë.

NEXHIPI — Belaja është se puna nuk m'u hoq nga këmbët. Unë kam po ato telashe. Zotrote nuk lexon as lutjet e as përgjigje nuk bën. Ti vetëm rri, vërdallosesh e pi duhan. ...Këtë duhet ta themi... Këtu e dy muaj unë nisa në Tiranë një letër ku ankohesha...

OSMANI — Ke bërë letër zotrote?!

NEXHIPI — Letër, posi... Këtë duhet ta themi... Unë dua një sekretar tamam. Sahanët pa kapak: ti s'bën asnjë punë!

OSMANI — Shkurt hesapi: do që të më heqësh që këtej?

NEXHIPI — Dua të më bëhet puna. Unë jam kryetar bashkie, nuk do të rri të bëj punët e tua!

(Pauzë.)

OSMANI — Nuk më heq dot, Nexhip efendi. Zotrote mblidhe mendjen top!

NEXHIPI — Do të të heq.

OSMANI — Jo. Nuk më heq dot!

NEXHIPI — Ti harron që në Tiranë ma dëgjojnë në llafin. Ti harron që unë jam kryetar bashkie. Pastaj ti harron më të madhen: Servet beu ka ardhur apostafat.

MEMUSH — *(Hyn e njofton.)* Servet beu!
(Nexhipi e Osmani ngrihen e dalin ta presin. Pas disa çastesh hyjnë bashkë me Servet beun.)

SERVET BEU — *(Që mezi merr frymë nga lodhja nëpër shkallë.)* S'jam për rrugë unë tani në pleqëri. Nganjëherë them gjynah që s'i bëjnë këto makinat të ngjiten nëpër shkallë e të më lënë këtu prapa derës. Po kjo do kohë e nuk dimë a do t'ia arrijmë asaj dite.

OSMANI — Ishallah, Servet bej! Rrofsh e arrifsh!
SERVET BEU — Llafu yt në vesh të perëndisë.
Ti je Osmani? Nuk ditke gramë ti, Osman?

OSMANI — *(I zënë ngushtë.)* Urdhëro?!

SERVET BEU — S'ditke shkrim them...

OSMANI — *(Gjithnjë e më ngushtë.)* Nuk prof-tasa dot, Servet bej. Iku mosha... Nuk...
E kam eksiq... Si e kam Avdulla bejnë?

SERVET BEU — Mirë e ke... Mirë.

NEXHIPI — Zoti Mensur mbahet ndonjëçikë?

SERVET BEU — Mensuri mbahet mirë.

OSMANI — Xhevdet beu, mirë?

NEXHIPI — Kasëm efendiu si është me shëndet?

OSMANI — Zoti Arif mirë e ka zonjën?

NEXHIPI — Zoti Nestor që kthyer nga Roma më thanë?!

OSMANI — Xhemal beu si është?

(Servet beu kthen kokën nga Nexhipi, i cili nuk ka për cilin të pyesë më. Atëherë Osmani nuk e lë të marrë frymë.)

OSMANI — Si është Nazif beu? Po Maksut beu? Emin efendiu? Naxhije hanëmi?

SERVET BEU — Mirë janë të gjithë. *(Nexhipit)*
Nexhip efendi, këtë punë s'do ta lëmë kë-shtu. Sekretari pa shkollë, s'vete. Sekreta-ri nuk di të shkruajë e punët ia bën krye-tari. Ku është parë kjo! Ta zgjidhim që sot: Sekretari të bëhet kryetar e kryetari të vejë sekretar. Do bërë puna...

OSMANI — *(Zë vendin e Nexhipit.)* Nexhip efendi, zbrit poshtë e na porosit dy kafel!...

TË SHTYHET VITI I RI

M o n o l o g

Zyra e nëpunësit të shërbimit, me shumë telefona. Mbrëmje. Shefi i planit, në merak të madh, bën me ngut llogaritë.

— Mmm... Treqind e dyzet e shtatë... mm... pesëdhjetë e tre, tetëdhjetë e gjashtë, shtatë mijë e treqind e dy... Fiu! (*Formon shpejt numrin e telefonit*)... Alo, shefi i planit jam... Kemi, si ndërmarrje, një kërkesë urgjente:

Të shtyhet patjetër ardhja e Vitit të Ri! Në asnjë mënyrë nuk duhet të vijë sontel! Kemi edhe ca gjëra pa plotësuar... Dëgjo, i dashur, për Vitin e Ri mos më folë!... Viti i Ri është festë e bukur, e gëzuar... Dakord... Ou!... (*Mbyll telefonin*) Këtij ia kanë prishur mendjen ata të tregtisë së verës, të gjelave të detit e të kukullave. Ata kanë propozuar që Viti i Ri të festohet në çdo tre muaj. (*Merr telefonin i menduar.*) Cilin të marr unë i ziu? Të gjithëve u qesh buza, me tejkalime... Kush e ka në nomenklaturë Vitin e Ri? Të marr komunalen apo ata që rregullojnë sahatet? (*Bie zilja e telefonit tje-*

tër. *E rrëmben*) Alo... Sektori dy? Hë e përmbushët?... Më përmbushët zemrën!... Hë më ju lumtë!... Ja, e mora shënim. Drejtori me shokët e tjerë kanë vajtur në sektorin një... Gëzuar-gëzuar! (*Mbyll telefonin*) Ç'gëzuar, more! Kemi dhe një sektor pa plotësuar... Kush vajti e bëri këtë muaj me 31 ditë ...Bëje, more, me 35. Ja, merrja tetorit, korrikut e gushtit!... (*Merr telefonin, formon numrin... formon edhe një numër me telefonin tjetër dhe flet me të dy njëkohësisht*). Alo, Viti i Ri jam... Dua të them, jam shefi i planit... More një të mirë dua nga ju: Turp, ndër-sa shtyni Vitin e Ri!... Janë përgatitur të tërë?... Obobo... Janë therur mishrat? Po nuk i futin dot nëpër frigoriferë?... Po të na shtyhet ca orë të paktën. Ore, e nisëm mengadalë në fillim... E qartë, e qartë. Duhet nisur me sulm sa të hyjë janari. (*Zilja*) Pa dale! (*Në telefonin tjetër.*) Hë... Sektori një?... Po hë, more, se na ngritë gjakun... Mirë që më njoftuat se, për nder, për pak e shtyva Vitin e Ri... S'e bëja dot?! Epo i kam dy-tre miq dhe unë... (*Dy telefonave të tjerë.*) Anuloni kërkesën që ju bëmë!... Tani le të urdhërojë... Na! Po deshi le të vijë që në ora 11. Dhe ne si tërë shokët... Si tërë Republika! ...Ç'the, more?... Pse e lamë planin për çastet e fundit? Pse kujtoje se u shqetësuam për planin? Planin e mbyllëm që në nëntor ne ...Ky shqetësim ishte për zotimin... U arrit edhe ai tani: **GËZUAR VITIN E RI!**



RRUGA PËR NË PLEPAS

Komedi me një akt

VETAT: REXHEPI — shefi i planit në kooperativën bujqësore «Liria» SPIROJA — shefi i llogarisë DRITA — punonjëse në zyrën e planit LLAMBI — gazetar MEMUSHI — student.

Është stinë vere. Skena paraqet verandën përpara zyrave të kryesisë së kooperativës «Liria». Drita po rregullon grafikët në tabelën e emulacionit. Spiroja del nga dera dhe vjen ta ndihmojë. Dëgjohet si afrohet një makinë dhe frenon.

NJË ZË — (Që jashtë) Na falni! Këtu është kooperativa bujqësore e Plepasit?

SPIROJA — Jo, jo...

DRITA — Këtu është kooperativa «Liria».

SPIROJA — Plepasi është edhe njëzet kilometra më tej. Vazhdoni.

ZËRI — Falemnderit!

(Makina niset e zhurma e saj tretet larg. Spiroja dhe Drita e ndjekin me sy.)

SPIROJA — Për të marrë përvojën e Plepasit me siguri. Të ishte ndodhur Rexhepi, do t'i kthente të gjithë këtu.

DRITA — Shtatë makina me targa të ndryshme kanë kaluar për në Plepas. Ja e teta!

(Dëgjohet zhurma e makinës tjetër e pastaj frenimi i saj.)

NJË ZË — Plepasi?

SPIROJA — «Liria», «Liria»...

DRITA — Vazhdoni edhe njëzet kilometra!

(Makinat nisen.)

REXHEPI — (Duke hyrë me vrap.) Këtu, këtu! Plepasin e keni këtu. Heeej! Na... Ikën.

(Makina ka vazhduar rrugën. Drita dhe Spiroja shohin me habi ardhjen e Rexhepit.)

SPIROJA — Paske ardhur nga qyteti, Rexhep?

REXHEPI — Pse nuk i ndalët? Plepasi është këtu! Këtu është! Këtu është drithi, për-

voja e përparuar. Eh, ju jeni të humbur.
Ikni, more, shkunduni!

DRITA — Epo ne nuk gënjejmë dot.

REXHEPI — Kush thotë të gënjeni?! Ata nuk shkojnë në Plepas për sytë e bukur. Ja ku i kanë rendimentet e Plepasit, këtu te ne.

SPIROJA — Ata duan Plepasin. Le të venë në Plepas!

REXHEPI — E kanë gabim, jua them unë! Ne po e arrijmë Plepasin.

DRITA — Kur ta arrijmë. I kemi ne patatet e tyre, fasulet e panxharin?

REXHEPI — Eh, more, pse i latë? Eh, si është kjo punë. Fati, rrethanat, historia, gjeografia e kanë vënë kooperativën tonë në rrugë, e një e dy jemi të detyruar t'u tregojmë udhëtarëve rrugën e Plepasit. Nuk ka fyerje më të madhe. Jua them unë. Cili djall vajti e hoqi tabelën rrugore?! Tani punën e tabelave e bëjmë ne. (Zgjat krahun.) Plepasi — 20 km!

(Drita me Spiron qeshin. Kjo e inatos Rexhepin më shumë.) Ta kalojmë Plepasin sa më parë, mor aman, se do të bëjmë një punë të paqme patriotike. Ja dhe karburanti i këtyre varavingove sa bën! Eh! (Dëgjohet përsëri një zhurmë makine.) Këta do t'i kthej. (I del makinës përpara.) Na! Plepasi! Plepasi! (Makina nuk ndalet po vazhdon rrugën.) Këta s'paskan nevojë për tabela. E ditkan vetë Plepasin.

DRITA — Nuk të ndezi, shoku Rexhep.

REXHEPI — (Me një farë djallëzie.) Kujt s'i ndezi? Shkunduni! Unë e kam bërë punën time. Në mensë i keni. (Pauzë.)

SPIROJA — (*I habitur*) Në mensë?!

DRITA — (*E habitur.*) Çfarë kemi në mensë?

REXHEPI — Dy veta që deshën të shkonin në Plepas i solla këtu.

SPIROJA — Je në vete, Rexhep?

DRITA — Ç'ke bërë, shoku Rexhep?!

REXHEPI — E bëra. Në turizëm ramë në një tavolinë. Duam të vemi në Plepas, thanë. Hajdeni t'ju shpie unë, u thashë. Erdhën. I futa nëpër grunjërat, u mahnitën. I shpura nga misri, u tronditën. Plepas e kaluar Plepasit. Ja ç'bëra.

DRITA — Pse nuk i shpure nga fasulet e patatet?

REXHEPI — Ju qepeni! E di unë atë punë.

DRITA — Nga kanë ardhur?

REXHEPI — Nga Tirana. Njëri është... se shkençëtar, se gazetar. Tjetri është çunak. Student.

SPIROJA — Kjo nuk është serioze, Rexhep.

REXHEPI — Ç'nuk është serioze?! Të jesh krenar për rezultatet e kooperativës tënde? Ikni, more, shkunduni!

SPIROJA — Si duket e harrove vërejtjen që hëngre kur solle këtu atë grupin (*Futet brenda.*)

REXHEPI — Vërejtja që gabim. Unë s'gënjeva njeri. Ata që solla u kënaqën me grurin tonë. Kur i përcolla u thashë të vërtetën. Ata qeshën me mua e më thanë hapur. Gëzohemi që «Liria» qenka njësoj si Plepasi. Këta, bamp me kritika! Dhe tani, ai gazetari: gër-gër, mban shënime.

DRITA — Po ai studenti?

REXHEPI — Ai ka ardhur kot, më duket. Më shikon mua si i goditur. Ai vjen për Plepasin pas berihajt. Nuk di të dallojë mis-

rin nga jonxha. Rri e rri e më pyet: «Ju jeni shefi i planit?» Tuhaf njeri!

DRITA — Po ku i le tani mysafirët?

REXHEPI — Po mbarojnë së ngrëni. U kënaqën. Unë dola të porosis kafetë. S'dua t'i vonoj. Ika.

(Rexhepi del në drejtim të kafenesë. Drita vazhdon punën. Që nga mensa vjen pranë saj Memushi.)

MEMUSHI — Punë e mbarë, shoqe!

DRITA — (I jep dorën.) Mirë se erdhët!

MEMUSHI — Qenka bukur këtu te ju.

DRITA — Bukur është.

MEMUSHI — Kooperativë e tipit të lartë është Plepasi?

DRITA — Plepasi? (E zënë ngushtë) Po. Plepasi është e tipit të lartë. Ju jeni student?

MEMUSHI — Po. Inxhinieri ndërtimi. (Shikon përqark.) Ku janë këtu stallat e viçave?

DRITA — Ja, pas atyre shtëpive. (I afron karrigen.) Uluni.

MEMUSHI — Dua t'ju them diçka... Është diçka intime, por s'di kujt t'ja them tjetër. Unë këtu në Plepas kërkoj një vajzë.

DRITA — Një vajzë?

MEMUSHI — Po, e kam njohur e jam miqësuar me të. Në aksion. Drita e quajnë.

DRITA — Këtu ne jemi shumë Drita... se edhe unë Drita quhem.

MEMUSHI — Oh gëzohem! Po... natyrisht nuk jeni ju. (Qeshin të dy.) Ajo është vajza e këtij shefit të planit që na solli këtu.

DRITA — Ah!

MEMUSHI — Ju kujtohet? Punon në stallat e viçave, ajo nuk di që unë kam ardhur...

DRITA — Po nuk i thatë shokut Rexhep se...

MEMUSHI — Nuk po gjej rast. Ai po na shpie grurë më grurë e unë s'po mbetem dot vetëm me të.

DRITA — Shikoni... Si t'ju them, shoku Rexhep nuk...

MEMUSHI — Nuk është shefi i planit?

DRITA — Jo i planit, planit, por... e dini si...

MEMUSHI — Shshsht...

(Vjen Spiroja. I jep dorën memushit. Në atë çast nga të dy anët hyjnë njëkohësisht Llambi e Rexhepi. Llambi takon Spiroton dhe Dritën.)

REXHEPI — Do të pimë kafe?

LLAMBI — Jo. Unë nuk pi më shumë se një kafe në ditë.

MEMUSHI — Kurse unë nuk pi asnjë. Nuk pi as kafe, as duhan.

REXHEPI — Aty kishte birrë të ftohtë.

MEMUSHI — Unë nuk vë në gojë asnjë lloj alkooli. *(Rexhepit)* Më falni! Ju, jeni?...

REXHEPI — *(I mërzhitur)* Ju thashë: shefi i planit!

MEMUSHI — Këtu në Plepas?

REXHEPI — E... Këtu...

LLAMBI — Gruri juaj ishte fantastik. Unë po bëj një studim mbi rritjen e mirëqenies së fshatarësisë kooperativiste. Nga specialiteti nuk marr vesh, po grurin e kishit...

REXHEPI — Ju pëlqeu, ëh?

LLAMBI — Shumë. Sa parashikohet të merrni?

REXHEPI — Vjet ne morëm tetëdhjetë. Sivjet nëntëdhjetë kuintalë për hektar. Me siguri.

LLAMBI — E mahnitshme!

REXHEPI — Shkenca, shok, shkenca! Këtu ne punojmë me shkencë. Dhe e mbështetim me punë. Nuk e di ç'bëjnë të tjerët, por

ne e vaditim me djersë! Ja. A shikoni njeri të sillet vërdallë? Asnjë. Të gjithë janë në fushë. Vetëm ne të zyrove të llogarisë e të planit.

MEMUSHI — *(Dritës.)* Ju punoni në llogari?

DRITA — Jo. Në plan.

MEMUSHI — Dhe shokun Rexhep e keni...

REXHEPI — Shef!

MEMUSHI — A mund të bëj një shëtitje nga stallat e vëçave? Të shoh si i kanë ndërtuar... nga jashtë...

REXHEPI — Drita, shoqëroje!

MEMUSHI — Jo, s'ka nevojë Shkoj vetë.

(Memushi largohet. Rexhepi e shikon Dritën me inat.)

LLAMBI — *(Pasi ka parë grafikun.)* Dhe misrin e kishit të mbarë.

SPIROJA — Si misri jonë edhe gjen. Po më të mirë, si zor të gjesh.

DRITA — Me misër do t'ia kalojmë edhe Plepasit.

LLAMBI — Bukur! *(Befas)* Plepasit?! Si... Plepasit?! Po a nuk jemi... në Plepas?

REXHEPI — *(Nxiton.)* Në Plepas jemi, por ne... ne... jemi në garë me veten tonë. Do t'ia kalojmë vetes. Rezultatet e arritura do t'i kapërcejmë.

LLAMBI — Kur e keni ndërtuar këtë pallat kulturë?

SPIROJA — Para tre vjetësh.

REXHEPI — Pesëqind e dyzet vende salla. Skena është të luash Otelon pa frikë.

LLAMBI — Ka shtëpi pa televizor?

SPIROJA — Unë nuk e di mirë, po...

DRITA — Edhe ka ndonjë...

REXHEPI — Ja, shiko çatitë me antena e shkruaj!

- DRITA — Plepasi ka më shumë.
- REXHEPI — Jo, moj...
- SPIROJA — Po, Plepasi ka më shumë.
- REXHEPI — (*Befas e kupton gafën dhe sqaron Llambin e hutuar.*) Ne të Plepasis kemi më shumë se çdo kooperativë tjetër.
- LLAMBI — Kulturat e tjera si ju venë?
- REXHEPI — Mirë... (*I zënë ngushtë.*) Mirë. (*Drita del, se nuk do që të flasë për këto.*) Ama për grurin tonë e dini se ç'thonë?
- LLAMBI — Gruri siç duket qenka krenaria juaj. Sa lekë marrin njerëzit për ditë punë?
- SPIROJA — Tetëmbëdhjetë-nëntëmbëdhjetë.
- LLAMBI — Ka kooperativa që ndajnë më shumë?
(*Spiroja e Rexhepi nuk flasin.*) Pse nuk flisni?
- SPIROJA — Ka... Marrin më shumë. (*Llambi sodit grafikët.*)
- REXHEPI — (*Nën zë.*) Nuk iku me kaq ky! U fut thellë.
- SPIROJA — Vetë e solle.
- REXHEPI — E solla për grurin. Aty ne jemi baras.
- SPIROJA — (*Nën zë.*) Fol vetë tani. Të thashë do të na turpërosh.
- LLAMBI — (*Kthehet.*) More, si shkon veprimtaria kulturore?
(*Pauzë.*)
- REXHEPI — (*Vendos të hapet.*) Turp, nder, more mik, unë ju kam gënjer. Këtu je në kooperativën «Liria».
- LLAMBI — «Liria»?!
(*Pauzë.*)

REXHEPI — Kisha qejf të të sillja... E të mos e merrje vesh... Po është akoma shpejt. Plepasi është më mirë në të gjitha. E di që të harxhova një ditë të tërë.

LLAMBI — (*Qetë, nis të qeshë.*) Po mirë, more shokë... Nuk më prish punë...

SPIROJA — (*Ia hedh fajin shokut*) Dhe i thashë eh... Dhe i kemi thënë... E bën shpesh këtë... E arritëm Plepasin në dy-tri pika dhe o burra!

LLAMBI — Dhe ka të drejtë të jetë krenar. Mua më pëlqejnë arritjet tuaja. Dhe ambicia. (*Befas.*) Tani meqë më mbajtët... Më shpini të shoh çerdhet, banjot. (*Niset.*)

REXHEPI — Shoqëroje pak, Spiro, se unë nuk kam sy e faqe. (*Kthehet Drita.*) Drita nuk e mbajta dot të fshehtë. (*Spiros.*) Shko, de. Unë do t'i marr në shtëpi son-te këta. Që të dy. (*Spiroja shkon me Llambin. Që tej duket Memushi, që kthehet.*)

DRITA — Po studentit, ai the?

REXHEPI — Jo. Do t'i kërkoj falje dhe atij. Sa mirë u nis. Ndenjën shumë e na i panë lakrat.

DRITA — Pse, i shpure dhe nga lakrat?

REXHEPI — Jo, moj... them. Hajde, djalosh. Drita na lër pak vetëm.

MEMUSHI — Ju lutem, shoqja Drita! (*I emocionuar*) Na lini pak vetëm (*Drita futet brenda.*) Shoku Rexhep unë kam ardhur...

REXHEPI — Ke ardhur po të them të drejtën unë ju kam gënjer...

MEMUSHI — Çfarë? Nuk jeni shef plani?

REXHEPI — Jo, more! Shef plani jam por...
MEMUSHI — (*I vendosur.*) Nuk kanë rëndësi të tjerat. Shifrat e kulturat... Puna është se unë me vajzën tuaj jam da... jam mi... jam da... jam mi-mi-miqësuar. Në aksion... Me Dritën tuaj.

REXHEPI — Dëgjo këtu, mor djalë!

MEMUSHI — S'dëgjoj asgjë. E di. Ju do të thoni: S'jam dakord, por...

REXHEPI — Mos u nxitoni.

MEMUSHI — E di: do të thoni që jemi nxituar. Po nuk është ashtu. Unë prandaj po ju takoj ju të parin.

REXHEPI — Ka një ngatërresë...

MEMUSHI — Troç. Unë për të kam ardhur në Plepas.

REXHEPI — Po më lër të flas, se plasa! Me vajzën time s'keni gjë.

MEMUSHI — Pse? (*Proteston*) Nuk është e drejtë.

REXHEPI — Është shumë e drejtë. E para: vajza ime s'ka qenë në aksion... E dyta: nuk quhet Drita, por Albana. Dhe e treta: sapo mbushi dy vjeçët. (*Memushi ka mbetur i hutuar.*) Plepasi është njëzet kilometra larg që këtej. Njëzet km!

MEMUSHI — (*Gjithnjë më i hutuar.*) Ç'thoni kështu?

REXHEPI — Ju gënjeva. Për mirë. Shoku juaj s'u mërzit. Bile u kënaq. Ai do të rrijë e unë do ta marr për darkë. Do të më gëzosh të rrish dhe ti.

MEMUSHI — Bah! Më paske fikur! Unë ju uroj për rezultatet, por më morët në qafë... Ika... Nga shkohet për Plepas?

REXHEPI — Ta thotë tabela... Këtej... (*Shikon një makinë që po afrohet.*) Ja, hip

në këtë makinë. Me siguri atje po shkon:
(Dëgjohen frenat e makinës.)

NJË ZË — Është larg Plepasi?

REXHEPI — Është edhe ca. Jua tregojmë ne.
Sa nuk e kemi kaluar do të bëjmë punën e tabelës. Këtej! (Zgjat krahun) Plepasi 20 km.

I ZIU METO KOTOLE, PRISH
SHTËPINË E BËN KASOLLE

(CA FJALË MË SHUMË MBI FJALËT
E URTA)

Dialog

VETAT: VANI LELOJA

Një e ndarë në bibliotekë. Vani hyn rëndë-rëndë, var kapelen dhe ulet në krye të tryezës, pranë Lelos, që e pret me penë në dorë.

VANI — Pak kemi punuar dje, Lelo.

LELOJA — Mbase do të të duket gudi, shoku Vani, por unë propozoj ta lëmë fare këtë punë. T'ia japim popullit fjalët e urta ashtu siç janë.

VANI — Në asnjë mënyrë! Janë të papastra. Çdo kohë ka lënë mbi to gjurma e bllanga. Ca duken arkaike. Fjalët e urta duhet t'ua japim njerëzve të fuqishme, aktuale, tingëlluese. Vazhdojmë, ku jemi?

LELOJA — «Dardha e ka bishtin prapa».

VANI — Përfytyrim i gabuar. Po që e shkëputur dardha mund ta ketë bishtin nga të dojë. Apo jo?

LELOJA — Flitet për dardhat e pakëputura.

- VANI — Në degë dardha e ka bishin lart.
- LELOJA — Ja, e rregulluam: «Dardha e ka bishtin lart» (Lexon tjetrën.) «Gur-gur bëhet kalaja».
- VANI — Ja!... A gjen më arkaike se kjo? Nuk vlen sot. E ç'kuptim ka të mundohet i ziu njeri të mbledhë gurë?! Për kala!
- LELOJA — E shuajmë fare.
- VANI — Aspak. Kalaja s'na duhet por... gurët ne mund t'i mbledhim.
- LELOJA — Përse?
- VANI — Po sikur të themi: «Gur gur bëhet banesa me kontribut vullnetar?»
- LELOJA — Hm! Aktualizim. (E shkruan.) «Gur gur bëhet...»
- VANI — Tjetër!
- LELOJA — «Demi zihet nga brirët»
- VANI — Prishe, se do të na vrasë njeri demi! Prishe!
- LELOJA — E prishim. Tjetër. (Lexon.) (Prit, gomar, të mbijë bar».
- VANI — Në asnjë mënyrë. Kjo është e padurueshme. Me këtë ne i themi gomarit: Rri ti, vëlla, se do të dalë bari afër gojës. Jo, jo dhe jo! Këshilla më idiote që mund t'i jepet një kafshe. Jemi njerëz apo ç'jemi?! E pse t'ia japim këtë këshillë çnjerëzore? Apo sepse lodhet tërë ditën e ditës, i bie bretku dhe ne: Prit të mbijë bar! Në asnjë mënyrë! «Mos prit hiç, gomar, po vrapo gjej bar!»
- LELOJA — Se do të të ndihmojmë dhe ne.
- VANI — Po o o... «Se do të të ndihmojmë». Të dalë dhe interesimi ynë.
- LELOJA — (Pasi e shkruan.) «Hall me burrë, hall pa burrë, hall të mos martohesh kurrë.»
(Të dy mbeten.)

VANI — (I hutuar.) Kjo s'të jep rrugë. Na e bën martesën gogol.

LELOJA — Si ta lëmë?

VANI — Thjesht: «Hall pa burrë!»

LELOJA — «Hall pa burrë!» (E shkruan dhe vazhdon.) «Prindi për fëmijën e tij e heq kafshatën nga goja.»

VANI — More, merrnin vesh nga higjiena këta të parët tanë apo ishin tapë topi?! Po qe prind i dhembshur, pse e vë fare në gojë? Le t'ia japë menjëherë. Ndryshe është antihigjienike. Hiqe fare!

LELOJA — «Qengji i urtë pi dy nëna».

VANI — Kush e thotë këtë?

LELOJA — Populli.

VANI — Po cili popull se?!... Populli ynë s'mund të thotë kurrë këtë. Nga na ka hyrë kjo parullë antiekonomike? Të hiqet! ...Po të jetë se do të hedhim qumështin kështu kot për të shpërblyer, për të qerasur qengjat e urtë, atëherë rritja e prodhimit të qumështit kërkon...

LELOJA — Mirë, shoku Vani, po dhe qengjat s'mund t'i lëmë pa stimul. Ne duam që ata të rrinë urtë.

VANI — Stimuj të tjerë... Ka stimuj plot.

LELOJA — Epo të vegjël janë. Le të pinë diçka.

VANI — Hiqe një nënë! Mjaft e ka një. Radha.

LELOJA — «Tjetrit mos i shiko gunën, po shikoi punën».

VANI — Ajo më shqetëson te kjo është se nuk përgjithëson.

LELOJA — Si jo...

VANI — Po ja, p.sh., a mund ta thuash këtë në punishten e gunave? Atje domosdo

do t'i shikosh gunën, se pastaj i thua cilësisë së dobët bujrum. Fshije!

LELOJA — «*Ku hyn dielli, nuk hyn mjeku*»

VANI — Hyn. Është shpifje për mjekët.

LELOJA — «*Frika ruan vreshtin*».

VANI — Vreshtin e ruan roja. Ahu, po thamë frika, rojat pastaj ia futin gjumit.

LELOJA — «*Mos hidh kripë në gjellë të botës*»

VANI — Për cilin e ke?

LELOJA — «*Duke parë punën e tjetrit, po lë mangut punën tënde*».

VANI — Lelo!

LELOJA — «*Ku di dhia ç'është tagjia!*»

«*Dhelpëra s'i arriti rrushtë e tha janë të pabërë*». «*I ziu Meto Kotole, prish shtëpi e bën kasolle*».

VANI — Lelo!

LELOJA — «*Mendja bën hata, mendja bën kala*».

VANI — Po e lamë ndërtimin e kalave, more Lelo! Se më plase!

MUÇOJA BËN OPERACION

S k i c ë

Sa herë bëhej fjalë për të paaftët, për ata të paaftë që pengojnë ecjen tonë përpara, merrnin si shembull Muçon. Vërtet pas mbarimit të universitetit ai nuk studionte, vërtet nuk përpigëj si gjithë kirurgët e tjerë, vërtet gjatë një operacioni për pak desh la pincat në barkun e pacientit, por unë, që kisha mundësi dhe që më dëgjohej fjala, e thosha një llaf të mirë për Muçon, se më vinte keq. E kisha nipin e krushkut. Pastaj, ne kirurgë të mirë kemi plot dhe s'kish mbetur puna në dorë të Muços. Atij i jepnin operacione të dorës së tretë. Operonte ndonjë të thatë, digjte iriqet, operonte kallot.

— Ta zëvendësojmë Muçon, — thoshin në mbledhje.

— Po lereni të gjorin Muço, u thosha unë.
— Ato operacione i ngarkojnë, ato bën. Do të vijë dita që do ta provojë dhe ai veten.

Të them të drejtën edhe unë e shikoja që Muçoja nuk ishte në rregull, nuk e meritonte atë vend. I thosha edhe krushkut që Muçoja

nuk i ka punët në rregull, s'është i zoti, nuk po jep prova.

— Do të japë, — më thoshte krushku.

Dhe rasti për të provuar Muçon erdhi. Do të operohej një stomak. Operacioni nuk ishte shumë i ndërlikuar. E ndërlikuar ishte situata se stomaku ishte imi. Më thanë se operacionin do t'ia besonin doktor Muços. Ta provonin, se kallot i kishin vajtur në majë të hundës.

Ç'të bëja? Të mos pranoja, do të thoshin se i ndaja fjalët nga veprat. Vendosa: Le të vdes, po fjalën do ta mbaj. Stomakun do ta operoj. Me Muçon!

Kur e morën vesh njerëzit e shtëpisë, vunë kujën.

— Mos, — më thoshin, — do të marrësh veten më qafë, do të mbetesh pa stomak.

— Jo! — përgjigjesha unë. — Do e bëj që do e bëj!

Kur u nisa për t'u operuar, të gjithë po qanin. Unë e mbajta veten. Vetëm kur u ndava me krushkun, nuk i mbajta dot lotët.

— Kujdes! — më tha. — Ndihmoma nipin.

Sikur do ta operoja unë Muçon!

Po më çonin mbi shtratin me rrota drejt sallës së operacionit dhe unë po mendohesha. «Ka akoma kohë, të kërkoj të më operojë ndonjë tjetër. Muçoja pat bërë atë gabimin e pincetës. Mos e bëjë dhe tek unë?»

Në hundë ndjeva një erë dhe si nëpër ëndërr dëgjoja zhurmë. «Jepi, Muço, — thashë me vete. — Shkrije talentin tënd, po qe se e ke. Dalshim faqebardhë!» Dhe humba.

U zgjova pas operacionit. Në dhomën time dëgjoja infermieret që po bisedonin.

— Në sallën e operacionit nuk po gjendet një gërshërë dhe një ombrellë.

«Bobo! — thashë me vete. — Ombrellën nuk besoj ta kem në bark, se do të dukej bishti nga goja, po gërshërën me siguri!»

U thashë të më thërresin menjëherë Muçon, por mbas pak erdhi doktor Qanoja.

— Si je? — më tha. — U provua dhe Muçoja që kishe merak. Të shkuara!

— Falemnderit! — i thashë. — Po gërshërët u gjetën?

— U gjetën, u gjetën, — tha duke qeshur, — edhe gërshërët, edhe ombrella. I kishte marrë Muçoja kur e thirrën të operonte urgjentisht një kallo. Operacionin tënd e bëra unë...

U qetësova. Tani më mbetej të qetësoja edhe krushkun, se Muçoja me siguri ishte qetësuar. Megjithatë frika më mbeti, dhe sa herë që guas i del ndonjë punë dhe më kërkon mua gërshërët, instinktivist të dorën në bark.

ASORTIMENTE ME KOS

Dialog

VETAT: KLIENTI KAMERIERJA

Klienti është ulur në tryezë. Kamerierja vjen e i sjell listën e gjellëve.

KLIENTI — *(Duke kontrolluar listën.) Ç'ka këtu për të ngrënë?*

KAMERIERJA — *(Përmendësh) Kemi tavë kosi, kungulleshka me kos, salcë kosi të trajtuar, pilaf me kos, byrek me kos...*

KLIENTI — *(Që e ka disa të prishur oreksin.) E di ç'ke ti, shoqë, më sill thjesht një kos.*

KAMERIERJA — *(Me keqardhje) Ah, kos nuk kemi.*

SHTRATI DHE TYTA

S k e ç

VETAT: LEKSI ZENELI TELI GUROJA

Një terren kodrinor. Rreth e rrotull gjelbërim i rrallë. Leksi dhe Zeneli hyjnë me vrap e shtrihen pranë njëri-tjetrit. Zëri nga altoparlanti: Artileria!

LEKSI — Mos lëviz! Të pushojë zjarri!

(Dëgjohen goditje të artilerisë «armike».)

ZENELI — Mitralozi ynë i rëndë nuk vihet në gatishmëri luftarake.

LEKSI — Po si dreqin është puna?

ZENELI — E mësova shkakun.

LEKSI — Pa hë?

ZENELI — Guroja, që mban shtratin, dhe Teli, që ka tytën, nuk flasin me njëri-tjetrin.

LEKSI — A, bukur! Kanë ndonjë grindje kru-shqie?

ZENELI — Jo, or jo...

LEKSI — Apo çështje gjaku? Gjyshi i TELIT ka vrrarë gjyshin e Guros në kohë të turkut, kështu?

ZENELI — Jo, or jo... Janë zënë para dy javësh në mensën e ndërmarrjes për punë të një koce...

LEKSI — Për punën e një goce... Dashurie d.m.th....

ZENELI — Jo goce — koooce!

LEKSI — Peshku, mo?

ZENELI — E, o i zi! Teli thotë që e pjekur në furrë bëhet më e mirë... Guroja thotë për të zgarës... Meseleja vajti gjatë... Jo ti s'kupton, jo ti s'merr vesh! Jo ke shije, jo s'ke shije. Ti je krap, ti je qefull, zgarra-furra, furra-zgara.

(Të shtënat nuk dëgjohen më.)

ZËRI NGA ALTOPARLANTI — Me shpejtësi për zënien e pozicionit të zjarrit — nis! Armiku me forca të shumta mësyn në drejtim të lartësisë së kodrave. Shpejt, shpejt!

(Hyjnë duke gulçuar Guroja dhe Teli. Guroja lëshon shtratin dhe nuk merret vesh me Telin, i cili me tytën në krah' ka përparuar më tej, aty ku i duket vendi më i përshtatshëm për të vendosur armën... Të dy nuk e ulin veten që ta ftojnë shoku-shokun aty ku janë.)

TELI — *(Që nga vendi i avancuar nuk di si ta thërresë Guron.)* Përpara, shokë, dhe nja dy-tre metra! Urraa!

GUROJA — *(Sjell shtratin aty ku është Teli, por nuk i pëlqen vendi, se i duket i pambrojtur.)* Kujdes për ruajtjen e teknikës dhe forcave të gjalla! Zgjidhni mirë pozicionet! Mitralozi! Me kërcim majtas, kalo! *(Guroja merr shtratin dhe kalon nga e majta ku sipas tij është vend më i*

përshatshëm. Tani secili rri atje ku i duket më mirë dhe duket sikur i kanë dalë borxhit njëri-tjetrit.)

TELI — (Në hall, vazhdon thirrjet e tij) Mos u shkëputni nga njëri-tjetri, shokë! Pesho, analizo, vendos! Vendi më i mirë krijon epërsi!

GUROJA — (I vendosur u këndon shtratit dhe rrotave bashkë.) «Ishe mitralier, o bir, u bëre karrocier!»

TELI — (Dikujt anash) O Lavdim!... Kam zënë një vend që e kam terrenin në pëllëmbë të dorës... por...

GUROJA — (Dialogon me dikë në të kundërt.) Urdhëro?... O po puna është të sigurosh vend të mbrojtur për teknikën dhe forcat e gjalla. Unë si forcë e gjallë, sa të jem gjallë, as që tundem që këtu.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI — Armiku po përparon drejt majës së kodrës. Gati për zjarr të përqendruar!

(Guroja mbështet shtratin e mitralozit pa tytën, kurse Teli s'di ç'të bëjë me tytën.)

TELI — (I mërzhitur) Pthtu! Kush ka qar, e kush ka dëm! (I afrohet shokut dhe i flet me sy ulur.) Turp, nder — mitralozi duhet gati për zjarr.

GUROJA — (Me kokën mënjanë.) Pse nuk e di unë? Shtrati ka një orë që po pret tytën.

TELI — (Duke përgatitur me nxitim armën) Po nuk u bënë bashkë këto dy pjesë të armës, s'kemi gjë. Unë e ula kokën për hir të gjërave më të rëndësishme.

GUROJA — (Duke i ndihmuar me ngut shokut) Phë! Budallallëqe, budallallëqe!... Zihen njerëzit kot!

TELI — Këtu është situatë lufte... kurse unë!
Fundja duhej ta kisha pranuar që atë
ditë se koca është më e mirë e pjekur
me zgarë.

GUROJA — *(Duke vazhduar punën)* Në zgarë
qenka më e mirë në situatë lufte, se po
të mos qe luftë ti do të vazhdoje ava-
zin tënd. Kurse unë ka disa ditë që de-
sha ta pranoj. Më mirë në furrë.

TELI — Lëre tani, ta mbyllim. Të drejtë ki-
she ti.

GUROJA — Jo, or jo! Unë e kisha komplet
gabim.

ZËRI NGA ALTOPARLANTI — Gati për zjarr!
Zjarr!

*(Të dy djemtë shtrihen në pozicion qit-
jeje. Hyjnë Leksi dhe Zeneli.)*

LEKSI — Mitralozi i rëndë?

TELI — *(Raporton)* Çdo gjë në rregull, shoku
komandant i skuadrës.

LEKSI — Guro, ti ç'thua?

GUROJA — Atë që tha Teli... Mitralozi ynë
do ta thotë fort fjalën e tij.

LEKSI — *(Duke qeshur)* Po pse më thanë mua
sikur ju të dy nuk... nuk merreshit
vesh...

GUROJA — *(Shtiret)* Ne?

TË DY — Shpifje!

TELI — Ne me Guron gjithnjë... E si mund të
luftojmë të ndarë?!

ZENELI — Ju lumtë, djema! Na paskan gënjyer
ata që na thanë sikur ju mbani mëri për
punën e një peshku kocë.

GUROJA — Pah, ç'sajojnë!

TELI — Ncë! Ncë! Ç'njerëz! Unë e Guroja ke-

mi qenë gjithnjë të një mendjeje. Me një shije... Koca na pëlqen... E pjekur...
TË DY — (Për hatër të shokut.) E zgarës, e furrës! (E ndërrojnë njëkohësisht) E furrës e zgarës! (E ndërrojnë përsëri në një kohë) E zgarës, e furrës!

DITURI

DITURI

Mbrëmje.

Babai pi qetësisht kafënë. Mamaja thur triko. Beni lexon një revistë.

BENI — Babi! Ç'janë këto baticat dhe zbaticat e detit?

BABI — Cilat zbatica?!

BENI — Pse tërhiqet deti e pse vjen prapë më afër bregut?

BABAI — Nuk... nuk e di.

(Qetësi. Pas pak):

BENI — Babi!

BABAI — Hë!...

BENI — Si formohet breshëri?

BABAI — Breshëri?!... Ëh, ëh... nuk... Nuk e di.

(Qetësi. Pas pak):

BENI — Babi!


BABAI — Folë, bir, i babit!

BENI — Gota pse thyhet nga çaji i nxehtë?

BABAI — Këtë... nuk e di.

MAMAJA — (Me qortim) Beni! Mos e shqetëso babin! Nuk e piu, që nuk e piu kafënë rehat.

BABAI — Po lëre, moj grua! Lëre djalin të pyesë! Fëmijët janë kureshtarë. Duke pyetur, mësojnë. Lëre të mësojë!...



WUK TE MOHIM O KRYET AR



NUK TË NJOHIM, O KRYETAR

Aty vite më parë, në një kooperativë bujqësore, në kufi me rrethin e Fierit, pat ardhur në krye të punës Laver Driza. Laveri pat qenë agronom i një sektori. Sektori kish bërë emër. Agronomi kish meritat e tij dhe, siç ndodh rëndom, kooperativistët e vunë Laverin

në krye të punëve të tërë kooperativës. S'kishin si zgjidhnin kryetar më të mirë. E kjo u vu re menjëherë, se kooperativa doli në ballë të shoqeve.

Po e mira s'ka fund... Sot je mirë ti, unë të shoh ty e bëhem më i mirë. Duar ti e duar unë. Mjete ti e mjete unë. Shkencë bën ti, po bëj dhe unë... Kështu që, pas tri-katër vjetësh, Laverit nuk i vinte mirë kur në rreth i thoshin të hidhte sytë nga kooperativat përbri.

— Përse kooperativa «Liria» merr rendimente më të larta në pambuk? E pyesni veten?

— E vini re grurin e atyre të Fierit, që kini në kufi? Një është toka. Pse nuk shkoni t'i shihni si punojnë? Le të jenë rreth tjetër. Pyetini. Do t'jua thonë.

Laveri ulte kokën. Ç'të thoshte? I ka këto ai që drejton: çekanët më të rëndë mbi të do të bien.

Vërtet punën në kooperativë nuk e bën veç kryetari, por ama një kryetar i shkathët i bën shokët të shkathët. Një kryetar që s'vë gjumë syrit i bën shokët ta gdhijnë.

Kush e pat njohur Laverin vite më parë, tani, do të vinte re ndryshime. Nuk ishte më ai agronomi i brishtë, që bridhte parcelë më parcelë. Në tëmtha flokët i qenë hirosur e pat vënë ca bark. Vitet e pararojës e kishin miqësuar me zyrën e planit në qendër të kooperativës. Aty shihte pasqyrat, aty nga kënaqësia përpiqte buzët, aty shfrynte inatet... Mblidhte përgjegjësit e sektorëve. I raportonin. U jepte porosi. Lidhej me rrethin.

Tamam si ai kali i vrahut, që shkel tërë grurin përreth dhe avash-avash mblidhet pranë strumbullarit, Laveri kish pushuar së bredhuri tërë arat e kooperativës, që mbledhur në zyrat

e qendrës dhe drejtonte që aty. Telefoni ishte shpikje më e fisme se makina. Shoferi i gazit flinte tani orë të tëra në sedilen e pasme me të katër dyert të hapura, për veri.

Ama kur nis të çalojë puna, cekanët fillojnë e rrahin të tërë njëherësh. Si me sustë. Nga larg, nga poshtë, anash. Dhe ku s'ti gjejnë gjynahet...

— Shoku kryetar, je mbyllur në guaskë!

— Shoku Laver, nuk po i rri punës mbi kokë!

— Lëviz, Laver, se mbete në zyrë! Shifrat flasin, po njerëzit kanë gojë dhe veshë.

I dëgjonte e nuk i dëgjonte Laveri këto, po e madhja plasi në një mbledhje të zgjeruar aty pas fushatës së shirjeve, ku një brigadier tha në sy të të gjithëve:

— Kemi kryetar po nuk e shohim të na vijë!

— Avash, ti, Llazo, avash! — ia preu llafin Laveri që nga tryeza. — Fol qetë e mos u nxi-to. Në sektor ka përgjegjës... pa ka agronom...

— Jo, po nuk e ke drejt! — i kundërshtoi brigadieri kryetarit. — Plehun nuk e shpërndaj-në si duhet. Përgjegjësi mbledh të dy supet. Dy supe ka dhe agronomi. I mbledh dhe ai. Na rruat! Kërkojmë kryetarin, thonë që mund ta shohim vitin që vjen...

Në sallë plasi gazi.

Laveri u ngrit me rrëmbim.

— Shoku Llazo! — ia bëri.

Brigadieri qeshi nën buzë dhe uli kokën. Pastaj hodhi shikimin rreth e qark dhe ia nguli sytë Laverit.

— Më quajnë Gaço, shoku kryetar! Na urdhëro ndonjëherë të bëjmë dy para muhabet! Dhe u ul.

Po mbaheshin dot më të qeshurat? Nuk qe-

shën vetëm ata të radhës së parë, se u vinte zor. Ama u frynë, ngritën sytë në tavan e kafshonin buzët. Ç'ishin prapa tyre, nuk mbahe-shin. Ata që drejtonin mbledhjen, në të dy anët e Laverit, ulën kokat, morën nëpër duar kalem-at e hiqnin vija...

Nuk e zuri gjumi atë natë Laverin. Të vër-tetën e ke përpara, ti mos e prano po të duash.

Të nesërmen vendosi të dilte fushave. Dha ca porosi dhe u nis. Shoferi i vajti prapa, por Laveri i tha të mos lëvizte, se gazi mund të duhej aty për ndonjë punë.

E merrte këtë rrugë dhe një çikë si i natosur me veten.

Ishin ditët kur prashitej misri...

Bëri një copë udhë me qerre. Pastaj një ze-tor e shpuri në një bostan. Aty hëngri një shal-qi të tërë dhe mori përsëri rrugën duke u mbë-shtetur në një shklop prej thane.

Kapërcente Laveri kanale, udhë qerresh, përshëndeste majtas e djathtas dhe ndalej ve-tëm aty ku shihte që duhej ndalur domosdo. Këmbehej me njerëz që e njetjetonin të pasi-gurt. Nga pas ndiente shikimin e tyre dhe La-verit i zinte veshi pëshpëritje: «Duhet të jetë kryetari! Ai është, kryetari!»

Lodhja ia kishte rënduar çapin, por inati është inat. Aty nga ora katër e ndjeu veten të këputur. U ngjit në breg të një kanali dhe vësh-troi përçark. Nga do të zinte syri njerëz që pu-nonin duke llafosur me njëri-tjetrin, duke kën-duar, duke qeshur.

Ca metra më poshtë, aty metanë kanalit, nja dhjetë a pesëmbëdhjetë veta kishin lënë shatat dhe ishin ulur nën hijen e një kumbulle të vet-muar. Një burrë me një xhakëtë doku në pëqi diç u tregonte, e ata qeshnin.

Laveri vendosi të freskohej pak në kanal e të ulej me ta. Hoqi këpucët, lagu këmbët, u freskua dhe i veshi përsëri. Do të vazhdonte udhën. Por atje tej, nën kumbull, muhabeti nuk po merrte fund.

Burrin me xhaketë Laveri nuk e njihte.

«O kujtesë, që na lë në baltë! — murmuriti Laveri. — Do të jetë ndonjë Llazo tjetër ky, që përfundon Gaqo!»

Me një kërcim u hodh metanë kanalit dhe iu afrua kumbullës nën hijen e së cilës valonte muhabeti për shtatë palë qejfe.

— Mirë se rrini! — u tha jo pa një farë ironie.

Njerëzit lëvizën nga vendi dhe po e shikonin me kureshtje...

— Prashisni misër? — i pyeti.

— Misër, — u përgjigjën disa nëpër dhëmbë.

— Laveri u përkul dhe ngriti një misër që e kishte prerë shati.

— Më me kujdes! Më me kujdes! — u hoqi vërejtjen nëpër dhëmbë.

Pastaj përfshiu bishtin e një shati dhe prashiti dy-tri rrënjë me shkathtësinë e dikurshme. Asnjëri nuk po lëvizte. Të tërë rrinin grup, të nemitur. Shikonin si të përhumbur Laverin, që pat rrëmbyer shatin.

— Po hə, — tha ky më në fund, — nuk mbaruat? Nën hije muhabeti është i ëmbël, po na presin punë të mëdha!

Përsëri nuk lëvizi askush. U ngrit vetëm burri me xhaketë doku. Laverit, ta vrisje, nuk i kujtohej emri i tij, por, megjithatë, nuk iu ndenj dhe ia hoqi një vërejtje:

— Hə, — i tha, — mos i mbaj me shakara. Punë, punë!

— Më falni! — i tha burri me xhaketë do-ku. — Kush jeni ju?

«Deh, o pikë e zezë, deri ku arrin puna!» — ia bëri Laveri me vete.

— Nuk më njihni?

— Jo, — ia ktheu tjetri.

— Unë jam kryetari! — tha Laveri.

Asnjëri nuk pipëtinte. Burri me xhaketë u afrua më shumë.

— Cili kryetar?! — pyeti.

— Cili kryetar?! — u çudit Laver Driza, -- kryetari i kooperativës, more!

Burri me xhaketë në fillim i çapëloi sytë, pastaj me buzëqeshje i tha Laverit:

— Më falni, po kryetar jam unë!

— ?????!!!!...

Dielli përvëlonte si saç. Megjithatë nuk ishte punë dielli këtu...

Laver Driza pat kapërcyer me kohë kufijtë e kooperativës së tij dhe pat hyrë në kooperativat e Fierit...



R A S A T

komedi me një akt

VETAT: BAXHULI — nëpunës, anëtar i komisionit të strehimit në lagje. BEJKUSHI — i biri, QAKOJA — pedagog i gjuhës në shkollën e mbrëmjes, VASKA — i biri Qakos.

TABLOJA E PARË

Në rrugën që të shpie në shkollën e mbrëmjes Baxhuli dhe Bejkushi hahej me njëri-tjetrin...

BEJKUSHI — Baba!

BAXHULI — Ç'baba, more!... Tani që atestimi ta kërkon shkollën e mbrëmjes nuk di ku të futesh, mban shpresën tek unë... «Babai është anëtar i komisionit të strehimit, — thua ti me vete, — profesori ka nevojë për strehim».

BEJKUSHI — Baba! Po mbeta edhe në këtë provim e humba vitin.

BAXHULI — S'do mend! Se mbete edhe në fizikë e në histori. S'di të lidhësh dy fjalë. Mbetesh si guak. Ç'ka historia, more! Ç'ka historia? Njëqind vjet më shumë, njëqind vjet më pak! Vra ca turq e pushto ca kështjella e hidhu tutje.

BEJKUSHI — Baba! Thuaji një fjalë profesor Qakos.

BAXHULI — Hiç mos m'u lut! Shtrengohu vetë e mos mbaj shpresë nga unë. Baxhulin nuk e ke për këto punë. Nuk abuzoj unë. Nuk ngatërrohem hiç (*Bejkushi del. Pauzë.*) Ptthu! ...Mos u ngatërro po të duash. Të nxin faqen ai... «Turp! — do të thonë. — Vetëm djali i Baxhulit mbe-ti» ...Po qe se profesori nuk ka marrë vesh që i dhamë zgjerim, u zgjidh kjo punë. Po e pati marrë... Do ngatërrohem.

QAKOJA — (*Duke hyrë.*) Shoku Baxhul!

BAXHULI — Ah! Si je, more profesor? Nuk e kisha mendjen hiç.

QAKOJA — Ç'u bë për atë problemin tim, shoku Baxhul?

(Pauzë.)

BAXHULI — (I qetësuar meqë tjetri nuk di gjë) Ëëë... (Ka në dorë situatën.) Po do të bëhet, o profesor.

QAKOJA — Kam biseduar edhe me kryetarin e komisionit. Nuk jam ngushtë, por martova djalin dhe...

BAXHULI — Të kuptoj... Po ti e di, profesor, të tërë në një mendje nuk janë. Nganjëherë i them vetes: «Shyqyr, o Baxhul, që të peshon fjala, se për nder, rrezik të marrë zgjerim ndonjëri që s'ka hall e të mbetet profesor Qakoja që... Pu pu!» ...Hajde, profesor, të pimë një kafe.

QAKOJA — E dini... Nxitoj për në provim.

BAXHULI — Aaa, provimi!... Shiko, harrova!... Dhe harrova kot, se im bir, Bejkushi, tërë këto ditë na ka futur datën me atë provim... Na e ka bërë shtëpinë rrëmujë me fletushka e po na ziejnë veshët akoma. «Paskajore, kallëzore... kallëzore paskajore!» (Qesh) Ishte në merak, i gjori. «Unë jam — ti s'je, ai është — ajo s'është»... Thamë se u çmend atje në dhomën e pritjes. «Babai im është minator, babai im mori flamurin». Unë as minator jam, as flamur kam marrë, po ai shembullat të gjitha me «baba» i bën. Ne flinim, ai hiç. Sa na dilte gjumi, nga dhoma e pritjes vinte zëri i djalit: «Babai im bleu një keç, Babai im e mban fjalën», Ha, ha!... Ti ma njeh Bejkushin?

QAKOJA — Po, po, patjetër!

BAXHULI — Ka sedër, i gjori. Vuan... «Ik pa merak, — i thashë, — se profesor Qakoja do të të japë hakun».

QAKOJA — Patjetër, patjetër!

BAXHULI — Po më vuri edhe mua në merak... «Kur ta marrësh provimin, hajde më thuaj, — e porosita. — Më nxirr edhe nga mbledhja e komisionit», — i thashë... Se tani do të mblidhemi edhe ne për ndarjen e pallatit të ri.

QAKOJA — Unë shpresoj shumë, shoku Baxhul.

BAXHULI — Të gjithë shpresojmë, shoku Qako, të gjithë. *(I jep dorën)* Hajde provime të mbara ti andej e ne dalshim faqebardhë në komision këtej!... Të dy hallin e djemve kemi, o profesor... Ç'nuk bën babai për fëmijën!

QAKOJA — Mirupafshim! *(Del me nxitim.)*

BAXHULI — *(Duke parë profesorin që pas.)* Bejkush, dembeli i babait, do të kalosh!... Po herë tjetër as mos mbaj shpresë te babai... *(Vetes)* Përpara, baba! Një kafe e ke hak e prit djalin me lajme të reja...

TABLOJA E DYTË

Në të dy anët e kundërta të tryezës së provimit rrinë Qakoja e Bejkushi. Këtij i është tharë buza. E ndien veten ngushtë.

QAKOJA — Hë, Bejkush, ke mbetur i fundit... Pyetjes së parë nuk iu përgjigje fare. Të dytës keq... Kemi mbi tre çerek ore së bashku...

- BEJKUSHI — (*Duke fshirë djersët.*) Së bashku, profesor.
- QAKOJA — Unë dua që ti të kalosh.
- BEJKUSHI — (*I habitur.*) Doni?
- QAKOJA — Po, patjetër!
- BEJKUSHI — Po kush na pengon?... Se edhe unë dua!
- QAKOJA — Po ja, pra, ti!... Ti duhet të përgjigjesh. Duhet të japësh prova se e zotëron lëndën. Lexoni fjalitë që ke shkruar.
- BEJKUSHI — Si urdhëron! Po i lexoj: «Babai im është në mbledhje».
- QAKOJA — Ti the: «Babai im është në mbledhje»... Ç'është babai?
- BEJKUSHI — Është anëtar i komis... Është emër...
- QAKOJA — Emër!... Pra ti ke zgjedhur babanë si emër për ta lakuar nëpër të gjitha rasat. M'i lexo fjalitë!
- BEJKUSHI — «Babai im (*duke fshirë djersët*)... është në mbledhje.
- QAKOJA — E mora vesh. Vazhdo... Gjinore, dhënë, kallëzore...
- BEJKUSHI — «Tani për të folur është radha e babait».
- «Babait tim ia dëgjojnë fjalën».
- «Mos ma zemëroni babanë».
- QAKOJA — (*Qesh.*) Vazhdo!
- BEJKUSHI — «O baba, ç'po heq unë i ziu!»
- «Prej babait varet gjithçka».
- (*Pas një pauze.*) E kam mirë?
- QAKOJA — Kalo në pyetjen e fundit.
- BEJKUSHI — Turp, nder, — këtë nuk e di.
- QAKOJA — Nuk e kalon provimin, Bejkush.
- BEJKUSHI — Mbetem?!
- QAKOJA — Mbetesh. Takohemi në vjeshtë...

BEJKUSHI — Nuk do të takohemi fare, profesor... Unë mbetem fare, po të më lini edhe ju.

QAKOJA — Atëherë nuk takohemi, Bejkush... Të lashë.

BEJKUSHI — Domethënë unë të shkoj t'i them babait?

QAKOJA — Mund t'i thuash... edhe xhaxhait! (Bejkushi del. Qakoja mbështetet, i lodhur me kokën në duar. Me nxitim hyn Vaska.)

VASKA — Baba!... Baba!...

QAKOJA — Prapë me këtë «baba». (Ngre kokën.) O qenka Vaska!

VASKA — Baba! Ç'ke, je lodhur?

QAKOJA — Biri im... tani lashë në provim një nxënës.

VASKA — E pastaj? Bëre gabim?

QAKOJA — Nevojat familjare më thoshin që ta kaloja, se në një farë mase duhej, kurse ndërgjegjja më thoshte ta lija në klasë... Unë dëgjova ndërgjegjen.

VASKA — (Duke tundur gishtin pleqërisht) «Kush vepron me ndërgjegje e ndersmëri, del gjithmonë i fituar»... Po të sjell një lajm të mirë: Komisioni na e dha zgjerimin!

QAKOJA — Vërtet?! (E puth të birin.) Kështu. (Duke qeshur fillon të lakojë.) «Babai yt veproi drejt». «Ti ndiq shëmbullin e babait».

VASKA — (E ndërpret.) «O baba, provimi mbaroi!».

INTERVISTË NË PORTËN E FUTBOLLIT

VETAT: TRAINERI, INTERVISTUESI

Në stadium. Skuadra bën stërvitje. Intervistuesi rri pranë trainerit e pothuajse e gjithë intervista zhvillohet nën kërcënimin e topave, që fluturojnë mbi kokat e tyre.

TRAJNERI — Gjuani saktë, more djema!.. Pasoni!... Me kërcim!... Duhet të kishe shënuar!... Kërkoje golin!... Kërkoje golin!... Prapë nuk shënove.

INTERVISTUESI — Pse nuk shënoni gola? Kush e ka fajin?

TRAJNERI — (Me sytë nga ata që stërviten) Fajin?... Hajde gjeje fajin! Katër janë faktorët që nuk na lënë të bëjmë gola.

a — Kundërshtarët. Na e nxijnë jetën. Na bëhen pengesë e vazhdueshme.

b — Arbitrat... Hedhin vickla dhe ata. Jo ishe ofsajt, jo e godite me dorë. Janë tre arbitra, mor xhan. Kujt t'i ruhesh më parë?

c — Shtyllat.

INTERVISTUESI — Shtyllat?

TRAJNERI — Po, po, shtyllat. Ose na i kthejnë topat mbrapsht ose i shmangin jashtë. (*Të dy ulin kokat, se përmbi ta kalon një top.*)

d — Terreni... Bëhen ca pëllgje me ujë e me baltë para vijës fatale... E vete topi na ngec atje... (*Ulin kokat*)

INTERVISTUESI — Po këta topa që vijnë drejt nesh! Mos duan të na godasin? Ç'kanë me ne?

TRAJNERI — Me ne nuk kanë asgjë. Ata stërviten për gjuajtje në portë. Po ja, këmba u vete këtej... Djalosh, gjuajtja është një art i vështirë. (*Ulin kokat*)

INTERVISTUESI — Të gjenim një vend më të sigurt.

TRAJNERI — Posi. Ejani me mua, djalosh! (*Nisen të dy e futen në portë. Bile ngjitur me rrjetën*)

INTERVISTUESI — Po këtu është rrezik më i madh. Ata po gjuajnë drejt nesh.

TRAJNERI — (*Duke buzëqeshur.*) Çlirohu, djalosh, e rri i qetë. Nuk ka vend më të sigurt se ky. Ku ta gjejmë të na godasin. Flisni!

INTERVISTUESI — T'ju pyes për humbjen tuaj të fundit? Mos ju vjen zor?

TRAJNERI — Jo, more, çfarë zor!... Me sa shoh, më zor ju vjen juve se mua.

INTERVISTUESI — Si shpjegohet që pasi stërviteni një muaj rresht me një formacion, ditën e fundit përpara ndeshjes...

TRAJNERI — E ndërrojmë, ëh? Rezervat bëhen të parë e të parët rezerva... Mbrojtësin e djalos të vë sulmues të majtë dhe anasjelltas, ëh?

- INTERVISTUESI — E kemi vënë re se e bëni gjithmonë. Pse e bëni këtë?
- TRAJNERI — Nuk e kuptoni?
- INTERVISTUESI — Jo.
- TRAJNERI — Vërtet nuk e kuptoni?
- INTERVISTUESI — Vërtet.
- TRAJNERI — Çudi! As unë nuk e kuptoj!
(*Duke ndjekur stërvitjen*) Ose, po si nuk bënë një gol?! S'na qëlluan një herë.
- INTERVISTUESI — Disa vjet më parë skuadra juaj, dhe jona natyrisht, ka dhënë rezultate të paharruara. Ç'ndryshime ka skuadra tani?
- TRAJNERI — Në peshë. Për arsye të rritjes së mirëqënies dhe kujdesit, të kushteve në përgjithësi, skuadra në global tani peshon afro tre kuintalë më shumë se skuadra e parë.
- INTERVISTUESI — Si e frymëzoni këtë brez futbollistësh me traditën e futbollistëve tanë më të njohur?
- TRAJNERI — Vetëm me fotografi.
- INTERVISTUESI — Nuk u tregoni as se si stërviteshin, as si e bënin regjimin sportiv... as disiplinën e tyre personale ...Golat e tyre të paharruar?
- TRAJNERI — Eh, s'harrohen/ ...(*I nxehur*) Kurse këta të mitë!... Por gjuani, ore djem, se na turpëruat!
- INTERVISTUESI — Si duket na ruajnë ne.
- TRAJNERI — Jo, more, po u vete këmba shtrembër. (*Lind një mendim*) Kam një ide. Prit! (*Futbollistëve*) Mjaft për gola sa për sot. Tani përpiquni t'i nxirrni jashtë. Fillo! (*Një breshëri topash godasin rrjetën dhe trajnerin tok me intervistuesin*)



ÇMIMI I PARË

S K E Ç

**VETAT: KRYETARI I JURISË, KATER ANËTARË
NJËRI PAS TJETRIT**

Një zyrë. Në qoshe të saj janë stivosur komeditë e dërguara në konkurs.

KRYETARI — Ja pra, shokë, erdhi dita e shënuar që të ndajmë çmimet e konkursit letrar. Më të qeshur, shokë. Ne nuk jemi juri e dramës, as e tragjedisë. Bile as e kritikës letrare. Ne jemi juria e komedisë. (*Fytyrat e të gjithëve çelen.*) Hajde pra, shokë, propozoni. Komedi kanë qënë shumë. Ndonjëra na ka mbetur pa lexuar. Po e ka lexuar shoku në krah. Le të ballafaqohemi. Kujt do t'i japim çmimin e parë?

ANËTARI QË PROPOZON — Më falni, po mua më vjen të qesh me pyetjen tuaj. Si mund të pyesni kujt do t'ia japim çmimin e parë?

ANËTARI QË PI DUHAN — Ajo dihet... çmimin e parë do t'ia japim...

ZËRA — Bilbilit! Bilbil Bubushit!

PROPOZUESI — Bilbil Bubushi e ka marrë gjithmonë çmimin e parë. Po nuk ia dhëmë ai do të preket.

DUHANXHIU — Ai vuan edhe nga zemra.

PROPOZUESI — Ai do të pyesë: Pse, këtë radhë paska rënë niveli im?

ANËTARI GAZMOR — Nuk do të pyesë vetëm ai. Të gjithëve do t'u bëjë përshtypje. Bilbil Bubushi shkruan gjithmonë komedi të bukura. Unë, sa kujtoj Bilbilin, mezi mbaj gazin.

KRYETARI — Më falni, u nxitova. Duhej të kisha pyetur ndryshe: A jeni dakord që edhe këtë radhë çmimin e parë t'ia japim Bilbil Bubushit?

- GATI TË GJITHË — Dakord!
- ANËTARI QË HAP PUNË — Po sikur çmimin e parë t'ia japim këtij djalit të ri, Hasan Xhananit?
- KRYETARI — Hasan Xhanani? Apo Xhanan Hasani?!
- PROPOZUESI — Kush është ky Hasan Xhanani?
- GAZMORI — Ka marrë ndonjëherë çmim ky xhanani?
- PUNËHAPËSI — Jo.
- PROPOZUESI — As që ka për të marrë.
- PUNËHAPËSI — Pse?!
- DUHANXHIU — Si do të marrë kur s'ka marrë më parë?!
- KRYETARI — Të mos zgjatemi, shokë. Qetësi, ti shok atje. Të qeshim, por duke qeshur të jemi edhe seriozë.
- GAZMORI — Më falni, m'u kujtua Bilbili. (Qesh) Mua sa herë më kujtohet Bilbili... (Nuk e mban dot gazin) Më falni nuk mundem dot!
- KRYETARI — (Rreptë.) Pi ujë! Dhe ti, shok atje, lëri kopjet e dorëshkrimet.
- PUNËHAPËSI — Dua t'i hedh një sy komedisë së Bilbilit.
- DUHANXHIU — Ç'e do. Çmimi i parë u dha.
- PROPOZUESI — Të dytin, shokë... të dytin unë them t'ia japim Mensurit, që e ka marrë gjithnjë. Të tretin Xhevdetit...
- TË TJERËT — Që ka marrë gjithnjë çmimin e tretë.
- PUNËHAPËSI — Unë kam kundërshtime akoma për komedinë e Bilbilit. Ta shohim.
- KRYETARI — Qetësi! Çfarë të shohim?
- PUNËHAPËSI — Së pari ta shohim si kopje, se këtu është zhdukur.

PROPOZUESI — E kanë grabitur. Kam thënë që duhej ruajtur në kasafortë.

(I drejtohet Punëhapësit.) Ç'është kjo? Hë de, pse nuk marrin komedinë e atij Hysen Xhananit tënd?

PUNËHAPËSI — Unë deklaroj se tërhiqem nga juria. (Pauzë e rëndë.)

KRYETARI — Shoku ka të drejtë. Kush qesh aty?

GAZMORI — Unë.

KRYETARI — Nevojat e teatrove janë të mëdha, por ne nuk duhet ta kishim lënë të na e rrëmbenin komedinë e shokut Bubushi. Kemi përgjegjësi si përpara tij, ashtu edhe përpara komediografisë botërore. Autori ka kulluar sytë vite me radhë mbi faqet e saj.

GAZMORI — Kjo është e thjeshtë! Marrim në telefon Bilbilin dhe i themi të na dërgojë një kopje tjetër. (Formon numrin e telefonit të Bilbilit.) Më jepni pak ujë, se më qeshet. Shoku Bil... Bil... Bil! Jemi juria e konkursit. A mund të na dërgoni një kopje të komedisë, se na e kanë rrëmbyer. Por... E duam për çmim.

KRYETARI — (Ashpër, me zë të ulët.) Të mos na dalë llafi!

GAZMORI — (Në telefon) Kuptoj... kup... kup... kuptoj. (Lë receptorin) Ai... ai... nuk flas dot... mama!

KRYETARI — Po fol, de! Ka apo nuk ka kopje?

GAZMORI — Nuk ka. (Duke mbajtur gazin.) Ah, kjo fusha e komedisë! Bilbili thotë se këtë radhë nuk ka dërguar fare komedi për konkurs.

(Pauzë.)

KRYETARI — Kush e kishte lexuar këtu?

(Pauzë.)

— Kush e propozoi?

PROPOZUESI — Unë. Po thash se... e ka lexuar shoku në krah.

GAZMORI — Meqë jeni ngushtë thotë Bilbili, po e filloj, por a prisni dy ditë... (mban gazin.) ...t'ju shkruaj një komedi të re?
(Gazmori mbytet përsëri në gaz.)

NË FABRIKËN E SHKREPSEVE

Skeç

VETAT: TEKNOLOGU KONTROLLORI INXHINIERI
NJË QYTETARE

Kontrollori i cilësisë provon ca shkrepse që ka në tavolinë.

TEKNOLOGU — (Duke ardhur) Këto janë ato që prodhuam javën që shkoi.

KONTROLLORI — (Vazhdon t'i provojë) Me këtë seri u turpëruam.

TEKNOLOGU — Formula e përzierjes...

KONTROLLORI — Klientit s'i duhet formula e përzierjes. Ai do mall me cilësi, ndryshe do të dëgjosh veç kritika të ashpra. Ja një qytetare me shkrepse. Dëgjo të shara tani.

(Vjen qytetarja)

QYTETARJA — Ju jeni kontrollori i cilësisë?

KONTROLLORI — Po.

QYTETARJA — Kam ardhur për këto shkrepset që nxorët javën që kaloi. (Befas i hidhet në qafë.)

KONTROLLORI — (I hutuar prezanton shokun.) Teknologu! Ky i ka prodhuar.

QYTETARJA — Teknologu?! (I hidhet dhe atij në qafë.) Ju falemnderit me gjithë shpirt!

INXHINIERI — (Duke ardhur.) Ç'bëhet këtu?

TEKNOLOGU — (Prezanton) Inxhinieri!

QYTETARJA — Inxhinieri! (I hidhet dhe e puth) Për shkrepset...

TEKNOLOGU — Atë po bisedonim... Këto shkrepse na dolën pak...

QYTETARJA — Të mrekullueshme. Ju lumtë!

INXHINIERI — Ne...


KONTROLLORI — ...Nuk...

TEKNOLOGU —Po kuptojmë!

QYTETARJA — Ç'të kuptoni? Kisha lënë në shtëpi djalin pesë vjeç. Fillikat. Ai kish gjetur këtë shkrepse tuaj. Shtëpia plot me letra, shkrepse, rroba, vajguri. Djali çaf e çuf.

INXHINIERI — Çaf e çuf?!

QYTETARJA — Dësh ta ndizte. S'ndezi dot asnjë. Nuk ndizen. Më shpëtuat shtëpinë. (U hidhet në qafë. Ata ikin, ajo i ndjek)



PORTOFOLË PA MINISTRA

Komedi me një akt

VETAT: ISMET BUXHAKU — kryeministri i fundit
kuisling ZOTI BARÇI AGATHIA — e shoqja AZISI
BEBRI BEU PROFESOR MIHALI NESTORI SEKRE-
TARI I KABINETIT

Tirana në vigjilje të çlirimit. Një kabinet i gjerë i mobiluar rëndë. Një kalendar i madh tregon 30 Tetor 1944.

Ismet Buchaku është në këmbë përpara skrivanisë së tij. Në kabinet janë edhe Azisi, Bedri beu, profesor Mihali dhe Nestori, Ismet Buchaku u ka shtruar të pranishmëve një çështje të rëndësishme, që kërkon zgjidhje të shpejtë dhe po pret përgjigjen e tyre. Dëgjohet tiktaku i orës së murit.

ISMETI — Kjo, zotërinj, është një çështje vitale për kombin tonë të shumëvuajtur. Ju jeni patriotë, thellësisht patriotë, fund e krye patriotë. Patriotizmi juaj ia bën mu... Të mençur jeni... S'ka sesi të mos i vini kombit në ndihmë në një situatë kaq të vështirë. Ju nuk do ta bëni si ca, që bëjnë gati valixhet e ia mbathin. Ia mbathin natën... Ca krerë të Ballit, ca pseudopatriotë, që kanë rrahur gjokset deri më sot... Ikin si hajdutë. Kjo nuk shihet me sy të mirë nga gjermanët... Hë, pra, zotërinj! Më vunë kryeministër, zgjodha ministrat. Katër ministri, që më kanë mbetur, ju thirra dhe jua ofrova juve... (Një shpërthim i mbytur dëgjohet tej. Që të katër kthejnë kokën andej nga erdhi zhurma. Pastaj mbi skrivani njëri nga telefonat bie fort. Të katër zotërinjtë kthejnë kokën nga telefoni)

ISMETI — (Merr dorezën.) Po... Ku sulmuan?
... Pres të më njoftoni me hollësi. (Le

dorezën e telefonit) Zotërinj, pres, përgjigjen tuaj.

(Askush nuk flet, Që larg vjen një zhurmë kamioni.)

NESTORI — Gjermanët tani i transportojnë të plagosurit me kamionë.

(Të gjithë grumbullohen te dritarja. Pastaj kthehen përsëri të shqetësuar nëpër vende.)

SAFETI — Si thoni ju, zoti Aziz, pranoni t'ju vëmë ministër?

AZIZI — Unë ministër? Ekstakfurullah!

ISMETI — Bedri bej?

BEDRIU — Jo, zoti Ismet, jo... Jam plak e vuaj nga reumatizma. ...Dy orë bashkë nuk i bëj dot pa gruan te koka.

ISMETI — Po ju, profesor Mihali?

MIHALI — Mos kam dhënë pak deri tani? Shëndetin tim me kohë ia kam falur kombit... Cazë që më ka mbetur do t'ia fal Mihalit. Najn, ekselens, najn!

ISMETI — Së paku ju, zoti Nestor!

NESTORI — Mjeku psikiatër ngul këmbë të më shtrojë në klinikën e tij. Kështu që...

ISMETI — (I zhgënjyer, buzëqesh me ironi.) Ju falemnderit, zotërinj! Mund të ikni! (Nisin të dalin. Zile e fortë telefoni. Ata ndalen në vend me sytë nga aparati.)

ISMETI — (Merr dorezën.) Po... Ja... Bitte, herr general! (Mbulon dorezën.) Jeni të lirë, zotërinj! (Ata dalin.) I përktheni gjeneralit se e di që po ikin shumë... Unë s'kam as dijeni, as përgjegjësi. Mundohen të gjejnë strehim në Itali... Unë po përpiqem të formoj qeverinë... Njëzet veta kam thirrur deri tani. Asnjë s'pranoi. Arivederci, sinjor... Au au... aufviderzehen herr general!

(Shfaqet sekretari)

SEKRETARI — Zoti Barçi po pret të hyjë.

ISMETI — Fute brenda!

(Sekretari del. Pas pak, hyn në kabinet zoti Barçi, një burrë rreth 40-45 vjeç, me flokë të krehur mënjanë. Pak i mvrejtur dhe disi kryelartë)

ISMETI — Urdhëroni, zoti Barçi! Gëzohem që po ju shoh... Tri herë kam dërguar t'ju thërresin.

BARÇI — Zoti Ismet, ju uroj për postin e lartë të kryetarit të qeverisë. Njeri më të përshtatshëm komandatura gjermane nuk mund të gjente. Urime!

ISMETI — Ju faleminderit!... Uluni, zoti Barçi... Cigare? (I ofron paketën) Autoritetet gjermane ju çmojnë shumë.

BARÇI — Këtë e di gjithë bota... Le të çmojnë gjermanët. Ç'e do! Kur nuk të çmojnë të tutë?...

ISMETI — Gjithmonë i pakënaqur.

BARÇI — Padrejtësira, zoti Ismet... Tërë jetën padrejtësira përmbi kurrizin tim të papërkulur.

ISMETI — Obobo, sa ankesa!

BARÇI — Po s'do mend. E kam thënë gjithnjë. Plot qeverira janë formuar. Nuk u gjend një post ministri për mua?! Po do të vijë dita ime!

ISMETI — Ka ardhur, zoti Barçi. Për këtë ju kam thirrur. (Zë vend në tavolinë) Duke çmuar zotësinë, talentin, patriotizmin, trimërinë, burrërinë, shkathtësinë, ju thirra ju që t'ju besoj diskasterin e ministrit të komunikacioneve.

BARÇI — Oh, ju faleminderit! (Befas thellohet) Të komunikacioneve? Ç'komunikacioneve?!

Oh ç'ironi! Talleni me mua apo si? Ku kemi ne komunikacione? Ministër për ato pesë a gjashtë makina që vërtiten nëpër Tiranë?! Le që ku të venë?! Jugun e kanë në dorë komunistët. Veriun...

ISMETI — Zoti Barçi...

BARÇI — Jo po kam hak... Më thirrret të më bëni ministër apo shofer. Unë kam mbaruar fakultetin e filozofisë në Vjenë. Ç'ne unë me makinat e me pajtonet!

ISMETI — Merrni flakë shpejt. Puf! Unë për ju jam gati...

BARÇI — Ju për mua të bëni këtë: të më besoni një dikaster më dinjitoz. Ia hiqni ndonjë tjetri dhe më besoni mua.

ISMETI — Kjo që thoni...

BARÇI — Nuk bëhet e di... Se nuk ia hiqni dot postin tjetrit.

ISMETI — Cilin dikaster kërkoni ju, për shembull?

BARÇI — Të drejtësisë.

ISMETI — *(I zgjat dorën.)* Mos goftë e prishur!

BARÇI — *(Duke i zënë dorën.)* Po prit. Kaq lehtë e paskeni?

ISMETI — Për ju...

BARÇI — Po atëherë të zgjedh një tjetër... Der fall ist der König des Welts! — thotë gjermani. Cilin kemi ministër të jashtëm?

ISMEI — S'kemi, Është bosh.

BARÇI — Aq më mirë. Ministër i jashtëm!

ISMETI — Urime, punë të mbarë!

BARÇI — *(Ulet i kënaqur.)* Ashtu... *(Pasi mendohet pak)* Cilin keni në ministrinë e brendshme? Eh, zoti Ismet?

ISMETI — A, ja, kjo ministri na ka mbetur pa njeri.

BARÇI — Bosh?

- ISMETI — Bosh.
- BARÇI — Bosh. Po tregtia, bosh?
- ISMETI — Bosh.
- BARÇI — Bosh. Po arsimi bosh?
- ISMETI — Bosh.
- BARÇI — Bosh?
- ISMETI — Bosh, bosh.
- BARÇI — Po si?... Po për ushtrinë?
- ISMETI — Nuk kemi.
- BARÇI — S'kemi ministër?
- ISMETI — Puna është... hem.. ta themi hapur,
nuk kemi as ushtri. (Pauzë.) Po s'ka asgjë
shqetësuese... Kemi ushtrinë gjermane.
- BARÇI — (Mendueshëm.) Po atëherë do të më le-
joni të mendohem edhe njëherë?
- ISMETI — Megjithë qejf. (Duke u ngritur) Ju
mjaftojnë pesë minuta?
- BARÇI — Ou!
- ISMETI — (Në të dalë.) Nëse jua ha syri... mund
t'ju ofroj të drejtoni dy ministri njëhe-
rësh. (Te dera.) Oh, ç'fat! Në para-
dhomë paska ardhur dhe zonja Barçi!
- BARÇI — Agathia?!
- ISMETI — Urdhëroni, zonja Barçi! Burri juaj ka
nevojë për këshillën tuaj. (Hyn Agathia.)
- ISMETI — (Duke e përshëndetur.) Jeni mirë?
- AGATHIA — Falemnderit!
- ISMETI — Po ju lë. (Del.)
- BARÇI — Gatha, po ti këtu?
- AGATHIA — I dashur. Po më merret fryma. Zo-
ti Jani dhe zoti Filip paskan ikur.
- BARÇI — Ku?
- AGATHIA — Në Itali. I dashur, të gjithë po
ikin. Ikim edhe ne.
- BARÇI — Lëri marrëzirat dhe dëgjo këtu... Më
ofruan një portofol ministri.
- AGATHIA — Oh, e zeza unë që s'më kupton!
Pas ca ditësh do të jetë vonë.

BARÇI — Përralla! Dëgjove ç'të thashë? Më ofruan një portofol.

AGATHIA — Portofol?!

BARÇI — Tërë jetën kam ëndërruar një portofol dhe sot...

AGATHIA — Bosh apo kish para brenda?

BARÇI — O zot! Duan të më ngarkojnë një dikaster. Më ndihmo të zgjedh!

AGATHIA — Ministër?

BARÇI — E, e!...

AGATHIA — Çfarë ministri?!

BARÇI — Po ku di unë! Ja, prandaj të pyeta.

Ç'ministër të më bëjnë? S'po gëzohesh?

AGATHIA — Ohu, ku të rreh ty! Dynjaja po ikin. Po ikin krerët e Ballit Kombëtar.

BARÇI — Po ikin?!... S'po shoh njeri unë të ikë.

AGATHIA — Ikin natën. Fshehurazi. Të ikim dhe ne, mor burrë! (Duke qarë.) Të ikim!

BARÇI — Fillove ti me budallallëqet e tua?... Gjermanët janë të fortë, moj. Nuk tunden ata.

AGATHIA — Aman të ikim.

BARÇI — Jo! Tani që u bëra ministër, të iki? S'dua!

AGATHIA — Gjete kohën për ministër! Ikim!

BARÇI — Po mirë, moj, ikim, po të iki të pak-tën si ministër.

AGATHIA — Unë po përgatit djalin dhe valixhet. Të tërë përgatitin valixhet.

BARÇI — Lëri, moj, valixhet! Ç'të zgjedh?

AGATHIA — (Qan) Mhë! Mhë!

BARÇI — Epo do të zgjedh vetë! Të mos kemi llafe pastaj!

AGATHIA — Lëre ministrin, merre atë portofolin dhe hajd të ikim!

BARÇI — (I nevrikosur.) Grua injorante! Më lër të mendohem vetë! (Barçi e nxjerr

gruan përjashta e pastaj vërtitet nëpër kabinet duke turfulluar. Bie telefoni)

BARÇI — (Vrapon ta marrë.) Alo?

NJË ZË NË MIKROPARLANT — Shkëlqesi?...
Zoti Ismet?

BARÇI — Zoti Ismet ka dalë.

ZËRI — Ai më porositi t'i raportoja. Kush jeni ju?

BARÇI — Kush jam unë? Ministri.

ZËRI — Cili ministër?

BARÇI — Cili ministër? (Me vete.) Ku di unë!
...Unë s'di vetë!

ZËRI — Se unë s'mund t'ia them çdo ministri.

BARÇI — Ai ministër që do ti, ai jam unë.

ZËRI — Se është sekret...

BARÇI — Jam ministër i drejtësisë.

ZËRI — Urdhëro?

BARÇI — I tregtisë.

ZËRI — Janë probleme të xhandarmërisë.

BARÇI — Fol, more halldup, se unë jam edhe ministër i brendshëm!

ZËRI — Para tri orësh na sulmuan partizanët...
Na vranë dyzet veta, zoti ministër.

(Pauzë.)

BARÇI — Sa ishit ju?

ZËRI — Njëqind e dyzet.

BARÇI — Paski mbetur njëqind.

ZËRI — E, e, njëqind!... Ç'njëqind zeza!

BARÇI — E zeza thotë! Di aritmetikë ti apo...?

ZËRI — E, e, e...

BARÇI — Ishit njëqind e dyzet, ju vranë dyzet... Nga njëqind e dyzet heqim dyzet, mbeten njëqind. Këtë s'e luan topi.

ZËRI — Këtu s'hyn aritmetika... Hyn frika...
Shumica ia kanë mbathur, zoti ministër.

BARÇI — A ia kanë mbathur... (Ulërin.) Po ia

mbathni dhe ju! Mbathjani! Mbushuni!
Po Gjermania është e fortë, more! Ata
ikin!
ZËRI — Ajo që është më shqetësuese, zoti mi-
nistër, brigadat partizane po rrethojnë
Tiranën.

(Pauzë.)

BARÇI — E sigurt?

ZËRI — Shumë e sigurt. Sot... (Ndërpritet)

BARÇI — Alo! Alo!... U prë linja. Me siguri e
prenë partizanët. (Barçi lë telefonin dhe
sillet nëpër kabinet. Poshtë skrivanisë i
tërheqin vëmendjen dy valixhe. I nxjerr
t'i shohë. Janë dy valixhe të mbyllura
mirë.) Zoti Ismet i paska bërë gati.
(Shumë i preokupuar) Ka të drejtë Gatha
... Injorante, po injorante me nuhatje...
Injorante e mprehtë. S'ka kohë për minist-
tër. Kur na jep shejtani miell, perëndia
na merr thasët.

(Hyn Ismet Buxhaku)

ISMETI — Hë?

BARÇI — Brigadat partizane do të sulmojnë
Tiranën.

(Pauzë e rëndë.)

ISMETI — (Mbledh veten.) Hë, hë... Le të sul-
mojnë. (Pauzë.) Ju, zoti Barçi, vendosët?

BARÇI — Përse?

ISMETI — Për... për... (I hutuar.) Se ç'kishit
për të vendosur ju...

BARÇI — Për... Hë, për të zgjedhur ministrinë.

(Pauzë.)

ISMETI — Do të marrin një mësim të mirë
ata...

- BARÇI — Me siguri... me siguri.
- ISMETI — Pra, zoti Barçi?
- BARÇI — Juve mund t'ju duket çudi, po unë do të kthehem tek ideja juaj e parë.
- ISMETI — Cila ide?
- BARÇI — Po pranoj komunikacionet... Se, t'ju them të drejtën, as për to unë nuk jam i zoti. Nuk di fare ç'kemi e ku kemi. Për shembull, a kemi ne vaporë që ikin për Itali?
- ISMETI — *(Pas një pauze.)* Po, vërtet... A kemi ne vaporë që ikin për Itali?
- BARÇI — Që të të shpien brenda ditës, them... Të të shpien sagllam... për shembull të nishesh sot...
- ISMETI — Po ku di unë. Dhe unë s'e di. Gjëja e parë që duhet të kisha pyetur.
- BARÇI — Se me aeroplanë...
- ISMETI — Jooo... Ku ka aeroplanë! Vetura është me rreziqe.
- BARÇI — Ohu!... Vetura është pesë me hiç. Ku të vesh me gra, me fëmijë...
- ISMETI — Vaporë. Vaporë. Ai bën punë. *(Në telefon me ngut)* Alo!... Durrësi!
- BARÇI — Është puna që të mos dinë gjermanët se ç'mjete komunikacioni kemi ne.
- ISMETI — Po ç'ne! Ne jemi qeveri e pavarur. *(Në telefon.)* Alo, Ismet bej Buxhaku jam. A kemi ne vaporë që shkojnë në Itali?... Vaporë pasagjerësh?
- BARÇI — *(Me zë të ulët.)* Po qoftë edhe mallrash. *(Ismeti e shikon si i humbur.)* Unë si ministër dua të di.
- ISMETI — Qoftë edhe mallrash.
- BARÇI — *(Po në atë telefon.)* Po ama që të nishesh sot!
- ISMETI — *(I lë telefonin Barçit.)* Unë të pyes me

telefonin tjetër Shkodrën, Shëngjinin. (*Duke marrë telefonin tjetër.*) Nuk kemi, e di unë.... Ah, për komunikacione!

BARÇI — S'do mend! Unë zgjodha sektor të vështirë. Alo! Phu!

ISMETI — Alo Shkodrën! Ismet Buxhaku jam. Pyesni...

(*Dëgjohen të shtëna të largëta mitrolozash. Të dy burrat mbeten si të goditur nga rrufeja*)

BARÇI — Të jenë ata, thua? Filluan mbi Tiranën.

(*Pauzë*)

ISMETI — Tani të kisha një ministër për ushtrinë.

BARÇI — O po të zgjidhim komunikacionin njëherë. (*Në telefon*) Alo, për të ikur... Duam të ikim...

TË DY — (*Njëkohësisht*) Alo!... Ne duam të ikim? Nga të ikim? Ë... Si të ikim?... Urgjent!... Që tani... Nga iket?... Si të ikim?... Bobo!... Të ikim!

(*Krisma, zhurmë, panik*)

ÇURREJ UNË TEK NJERËZIT

Dialog

VETËT: MEMOJA ASTRITI

MEMOJA — Mburrja është gjëja që urrej më shumë te njerëzit unë.

ASTRITI — Dhe unë... Mua më vjen ndot. Më mblidhet lëmsh në stomak. Një ditë tregonte diçka për veten shoku Toli në klub. Mburrej. Të tërë e dinin që gënjente, por bënë sikur e besonin. Mua m'u mblodh kafeja xhumbë! Brrram! karrigen tutje dhe kërcita. Ika. Të gjithëve sikur u ra tavani. Guxim prej të marri paske pasur! — më tha Leloja.

MEMOJA — Se nuk janë mësuar kështu. Guximin e dinë se është vetëm në fjalor. Unë, një ditë, nxora jashtë kryeinxhinierin. Më hyri pa trokitur. Ti e njeh Peçon tonë. Dy kuintalë burrë. Dy okë mustaqe. Kur ngriset ai, edhe diell të ketë, nisin bubullimat. Dil jashtë, i thashë. Trokit, pa hyrë! Unë të trokas! Po, ti të trokasësh. Do të habitesh, po kështu ia bëra.

ASTRITI — Nuk habitem hiç. Edhe unë e dua

korrektesën. Si ajrin. S'rroj dot pa korrektesë.

MEMOJA — Qenke si unë! Unë...

ASTRITI — Unë, të thashë më tetë — të vij më tetë. S'di unë tetë pa pesë e tetë e pesë. Ama dhe ty të dua të më vish më tetë.

MEMOJA — Më tetë të vij. Unë këtë e shoh si shfaqje të respektit. Të respektit për kohën. Të respektit për shokun. Për punën. Këtë ndjenjë e kam trashëguar nga të parët dhe ua kam rrënjosur fëmijëve.

ASTRITI — Edhe unë! Unë...

MEMOJA — Unë ua kam ushqyer fëmijëve me biberon. Ata, që në djep, kanë pirë më parë edukatë e pastaj qumësht. E kam merak...

ASTRITI — Merak, thotë!... Si të mos e kesh. Fëmija është pasqyra e babait. Unë u them: Mos më duani! Në krahë mos më mbani! Vetëm më nderoni emrin! Siç e kam nderuar vetë. Dhe kam fëmijë të mirë... Si unë, nuk i ka njeri!

MEMOJA — I kam unë! Fëmijët e mi janë krenaria e lagjes.

ASTRITI — Nuk habitem. Nuk habitem, se kam fëmijët e mi. Dua të ndërroj shtëpinë, nuk më lë shkolla. Jo, thonë, se na heq fëmijët e ç'mbeti më për ne pastaj?... Për atë të voglin tim thonë se ka she-njat e gjenit.

MEMOJA — Djali im është...

ASTRITI — Për dhjetë vjet djali yt, më thonë, do të bëjë t'i harrohet emri Ajnshtajnit.

MEMOJA — Kur kalon djali im, mësuesit lënë bisedat e vihen, pa dashur, në radhë!

Djali i Memos! Djali i Memos! Dhe heqin kapelet.

ASTRITI — Për tim bir thonë se shkollën e bën kot. Vetë familja ka qenë shkollë për të. I ati...

MEMOJA — Si për mua!...

ASTRITI — Vetë i ati, thonë...

MEMOJA — Mua më thonë; hiqe se...

ASTRITI — Unë për ta jam pedagogu...

MEMOJA — Prit! Hiqe, thonë, se shkolla do të ta prishë, ngaqë unë...

TË DY — *(Pa pritur e pa dëgjuar njëri-tjetrin)*

Për fëmijët e mi, thonë se... — (M) Mua

më propozuan t'i lë të gjitha punët... —

(A) do të kalojnë pak vite e s'do t'i heqë nga goja bota e tërë... — (M) e të merrem vetëm me edukim fëmijësh... — (A)

Do të pushtojnë faqet e gazetave!... —

(M) E duan ndihmën time për aftësinë që

kam në të edukuar... — (A) Të shikosh

se si do të lulëzojnë të tëra degët... —

(M) në të gjitha pikëpamjet! Daç të nder-

shëm, daç te singertë, trima, apo të thjeshtë!... — (A) në të cilat do të vënë

shpatullat pjellat që kam rritur unë... —

(M) Apo të thjeshtë! Sidomos të thjeshtë!... *(E kështu vazhdojnë derisa u merret fryma.)*



AFËR DHE LARG

Skeç

VETAT: NËPUNËSJA E NTI-së, NËPUNËSI I NTI-së,
NËPUNËSJA E NTU-së, NËPUNËSI I NTU-së, POS-
TIERI NGA PT-ja.

Jemi me një ndërtesë në të cilën janë administratat e dy ndërmarrjeve tregtare të qytetit, të cilat për t'u përmirësuar puna janë ndarë e bashkuar njëmbëdhjetë herë e nuk është çudi që pas tre vjetësh të bashkohen përsëri. Por në çastin e zhvillimit të ngjarjeve të mëposhtme janë të ndara. Në plan të parë shohim njëkohësisht dy zëra, të njëjta për nga madhësia e të ndryshme nga mobilimi. Nga krahu i NTI-së nëpunësi formon një numër në telefon. Bie zilja në telefonin e NTU-së dhe receptorin e ngre një nëpunëse.

NËPUNËSJA E NTU-së — Kush jeni?

NËPUNËSI I NTI-së — NTI-ja jemi. Dëshëm pak shefin e zyrës.

NËPUNËSJA E NTU-së — (*Fryn në receptor.*)
Fu! Nuk dëgjoj mirë. Pfu! Se ç'ka ky telefoni ynë.

NËPUNËSI I NTI-së — Shokun Nusret deshëm. Shefin.

NËPUNËSJA E NTU-së — Prisni ta thërres, ju lutem!

(*Nëpunësja e NTU-së lë telefonin hapur dhe del në korridor. Ndërkohë që nga jashtë vjen nëpunësja e NTI-së.*)

NËPUNËSJA E NTI-së — Si u gdhive, Sanije?

NËPUNËSJA E NTU-së — Mirë, Manushaqe, si t'u bë djali?

NËPUNËSJA E NTI-së — E vizitova, më mirë. Erdha, se presim një kontroll këtej nga ne.

NËPUNËSJA E NTU-së — Ne jemi qetë. Do të shihemi.

(Nëpunësja e NTI-së hyn në zyrën e saj, ku gjen nëpunësin që pret me telefonin në vesh. Nëpunësja e NTU-së hyn në një zyrë, të vendosur pak më thellë e që an-dej del tok me shefin e saj.)

NËPUNËSI I NTU-së — Kush është?

NËPUNËSJA E NTU-së — Nuk e mora vesh. Nuk punon mirë telefoni. (Nëpunësi hyn në një zyrë, ndërsa nëpunësja del jashtë.)

NËPUNËSI I NTU-së — Alo! Nusreti jam:

NËPUNËSI I NTI-së — NTI-ja ju flet.

NËPUNËSI I NTU-së — Kush? Pfu! Nuk u rregullua ky telefon. Dëgjo, more shok! Më merr edhe një herë. Bjeri numrit të NTI-së! Të të flas nga zyra përballë.

NËPUNËSI I NTI-së — Përballë! Kulmi! Na... (Të dy lënë receptorët dhe hapin dyert ballëpërballë.)

Kështu nuk punohet! Në ç'zyrë përballë të të marr?! Unë që nga ajo po të flas. Ju lutem shumë, rregulloni telefonin!

NËPUNËSI I NTU-së — Na falni! Kujtuam se merrnin nga larg. (Kthehen. Mbyllin dyert dhe marrin telefonat.)

NËPUNËSI I NTI-së — ...Ju mora për problemin e magazinave që ia kemi kaluar ndërmarrjes suaj. Ne i boshatisëm.

NËPUNËSI I NTU-së — Fol më fort!... Nuk kuptoj. Pfu!

(Lë telefonin dhe shkon hap pak derën. Tani zëri i kolegut të ndërmarrjes përballë dëgjohet që nga dera.)

NËPUNËSI I NTI-së — Magazinat tona që do të merrni ju?

NËPUNËSI I NTU-së — Po, tani dëgjoj më mirë.

NËPUNËSI I NTI-së — Ne i kemi boshatisur dhe tani presim t'i merrni ju. Ejani të bëjmë dokumentin.

NËPUNËSI I NTU-së — Kam ardhur dhe nuk ju kam gjetur.

NËPUNËSI I NTI-së — Nuk qëndron kjo.

NËPUNËSI I NTU-së — Urdhëro?! Prit pak!
(Shkon e hap derën më shumë) Alo!
Qëndron. Nuk ju kemi gjetur.

NËPUNËSI I NTI-së — Hajd, ta zëmë ashtu.

NËPUNËSI I NTU-së (Që tani telefonin e mban kot në dorë dhe flet me kolegun matanë.) Jo ta zëmë, po ashtu ështëë!

NËPUNËSI I NTI-së — Mirë. Brënda katër ditësh duhet ta përfundojmë. Presim kontroll e s'duhet që të na i gjejnë bosh ndërtesat.

NËPUNËSI I NTU-së — Jemi dakord.

NËPUNËSI I NTI-së — U kuptuam?

NËPUNËSI I NTU-së — Qartë. Kemi gjë tjetër?

NËPUNËSI I NTI-së — Jo! Shëndet!

NËPUNËSI I NTU-së — Shëndet!

(Lënë telefonat.)

NËPUNËSI I NTI-së — Sidoqoftë, Manushaqe, nisi NTU-së edhe një telegram zyrtar.

NËPUNËSJA E NTI-së — Si urdhëron!
(Nëpunësi i NTI-së del në korridor dhe aty ndeshet ballëpërballë me nëpunësin e NTU-së që po del gjithashtu nga zyra.)

NËPUNËSI I NTI-së — Nusret, ke shkrepëse?
NËPUNËSI I NTU-së — Kam, mbi tavolinë.

*(Hyjnë të dy në zyrën e NTU-së.
Shkëmbejnë cigaren, e ndezin dhe da-
lin përsëri në korridor duke biseduar
për kohën.)*

NËPUNËSI I NTI-së — Ftohtë sot.

NËPUNËSI I NTU-së — Nga shiu që ra. Shën-
ndet!

NËPUNËSI I NTI-së — Shëndet!

*(Futen në zyrat e tjera të ndërmarrje-
ve të tyre. Që jashtë vjen nëpunësja e
NTU-së me një byrek në dorë dhe fu-
tet në zyrën e NTI-së, prej nga u bë
biseda telefonike.)*

NËPUNËSJA E NTU-së — *(Duke i dhënë by-
rekun shoqes së NTI-së.)* E mora për
ty. Me siguri nuk do të kesh ngrënë.

NËPUNËSJA E NTI-së — Rrofsh!

NËPUNËSJA E NTU-së — Ke punë jashtë,
që të dalim tok. Unë do të shkoj në
park.

NËPUNËSJA E NTI-së — S'dal dot. Jam e
zënë. Po të lutem, Sano, më lër një
telegram në postë.

NËPUNËSJA E NTU-së — Me gjithë qejf. Ja,
të mbyll zyrën.

*(Nëpunësja e NTU-së del e mbyll zy-
rën. Nëpunësja tjetër del dhe i jep te-
legramin.)*

NËPUNËSJA E NTI-së — Urdhëro! Lëre në
postë!

NËPUNËSJA E NTU-së — Qenka për ne!

*(Largohet nëpër korridor drejt postës
kryesore duke lexuar telegramin.)*

NËPUNËSJA E NTI-së — *(Kthehet në zyrë
e nis të hajë byrekun.)* Sa mirë kur me-

rresh vesh me shoqen përballë! (Nga
posta vjen postieri, i cili sjell telegra-
min e sipërpërmendur. Troket tek zy-
ra e NTU-së dhe gjen derën të mby-
llur. Nuk di se si të bëjë e pastaj ve-
ndos të trokasë tek dera përballë e
NTI-së.)
Hyr!

POSTIERI — Ku janë këta?

NËPUNËSJA E NTI-së — Kanë dalë. Ç'ki-
shit?

POSTIERI — A t'ju lë një telegram që t'ua jep-
ni?

NËPUNËSJA E NTI-së — Posi. Ua japim! (*Fir-
mos*) Sa shpejt shërbeni!

POSTIERI — E po kështu duhet.

NËPUNËSJA E NTI-së — Është telegrami që
nisëm ne.

POSTIERI — I juaji?! (*Mbetet gojëhapur.*)

Ju lutemi shumë!... Ju lutemi shumë! ...
Mb...mbli...Mblidhni mendjen!



QEROSI QË U SHPËTOI KURTHEVE TË
MBRETIT. DHE I MORI TË BIJËN

Përrallë popullore e përpunuar

VETAT: QEROSI MBRETI SHËRBËTORI QË FLET
ÇUPA E MBRETIT I BIRI I MBRETIT ABRASH
SHËRBËTORË, ROJA DHE OBORRTARË

Ngjarjet e përrallës zhvillohen këtu e qindra e mijëra vjet më parë në një pyll, në një livadh pranë një burimi e pastaj në oborrin e mbretit. Do të kemi bilbila magjikë, diell, hënë e mjegull, përrallë...

KONFERENCIERI — Na qe mos na qe... Na ishte një, atje qoftë, pa derë e pa portë, na ishte një Qeros... Një ditë Qerosi, duke ecur, dëgjoi një zë bilbili që vajton-te.

ZËRI — Ndhimë!... Ndhimë!... Oh!... Më shpëtoni! (Qerosi me shkop godet një gjarpër dhe pasi flak tutje gjarprin e vrrarë e merr në duar bilbilin e vogël dhe e përkëdhel në pëllëmbë)

BILBILI — Falemnderit, o Qeros!... Nuk do të ta harroj këtë që më bëre. Fyelli t'u bëftë magjik! Po të jap dhe këtë unazë. Sa herë t'i frysh e të thuash ti «Lidhu!» gjithçka të duash ti do të lidhet. Sa herë t'i frysh e të thuash «Zgjidhu!», gjithçka do të zgjidhet. (Qerosi e lëshon bilbilin) Falemnderit, Qeros! (Bilbili fluturon e ulet diku lart mbi një degë peme. Dëgjohet kënga e tij e bukur.)

KONFERENCIERI — Në ato anë, në ato kohëra rronte një mbret dinak. Ai kishte dyzet kuaj... E kishte vënë një kusht: «Cili bari do t'i ruante tri ditë e do t'i kthente pa mungesa të dyzet kuajt në pallat, atij mbreti do t'i jepte për nuse të bijën. Sepse kruhen këta mbretërit e i martojnë cupat me baste, s'merret vesh, — tërë pë-

rrallat kështu thonë. Përralla de!... Kush-ti thoshte dhe tjetrën. Në rast se bariu i sillte kuajt mangut, mbreti e vriste.

Në skenë del çupa e mbretit që shkon e freskohet tek çezma me shtatë sylynjare. Deri tani dyzet veta kishin provuar t'i kullotnin kuajt dhe nuk i kthehin dot në pallat, se kuajt ishin të sertë. E për çupën e mbretit kishin lënë kokën dyzet veta, që ditën e parë. Qerosi u paraqit te mbreti. Mbreti ia dha kuajt e Qerosi me ndihmën e unazës magjike e fyellit të tij i kulloti kuajt e i ktheu që të dyzetë në pallat. I ktheu ditën e parë, i ktheu ditën e dytë. E kështu erdhi dita e tretë. Doli dielli...

(Qerosi vjen hipur mbi kalë dhe vë re çupën e mbretit. Ajo veshur në të bardha me një kurorë lulesh mbi kokë, vazhdon të freskohet në burim. Kur shikon Qerosin, i buzëqesh dhe largohet me vrap. Qerosi e ndjek me sy, pastaj zbret nga kali i sertë.)

QEROSI — (Kalit) Lidhu!

(Kali lidhet vetë dhe sado që përpiqet ta largojë kapistrën, mbetet i lidhur. Pas pak, i prirë nga rojat dhe i mbajtur nga katër shërbëtorë, përmbi një tezgë, vjen mbreti. Qerosi bie në gjunjë e ul kokën përdhe.)

MBRETI — Ç'po bën, o Qeros?

QEROSI — Po ruaj të dyzet kuajt, madhëri.

MBRETI — Shiko se mos të mungojë ndonjë sonte.

QEROSI — Do të t'i sjell tamam, madhëri! Dhe sipas llafit dua çupën tënde!

MBRETI — Do të ta jap, Qeros! Unë jam mbret.
Fjalën e mbaj! Do të ta jap.

Dhe gjithë vrer mbreti godet me kam-
zhik shërbëtorët, që e shpien më tej.

QEROSI — Yh, cil! (U bërtet kuajve.) Yh, cil,
mos më ik. Lidhu! Ashtu! (Qerosi del tu-
tje nga ana e kuajve. Aty në shesh kullot
vetëm kali i lidhur. Hyn mbreti i veshur
tepdil si fukara dhe mundohet të trem-
bë kalin. Por kalin e mban kapistra. Mbreti
mundohet ta zgjidhë. Shan nëpër dhë-
mbë, përpiqet e përpiqet, por më kot.
Kthehet Qerosi)

MBRETI — Kush i ka këta kuaj?

Qerosi — Unë.

MBRETI — Aman, o njeri! Dua të më japësh një.
Vetëm për sonte. Nesër ta sjell. Po më
vdes djali e dua të marr doktorin.

QEROSI — Jo, nuk të jap dot asnjë.

MBRETI — Aman!

QEROSI — Jo, jo! S'bëhet ajo punë. Më ikën
koka.

MBRETI — Do të të jap një qese me florinj.

(Pauzë.)

KONFERENCIERI — Këtu Qerosi dyshoi dhe e
njohe mbretin e qëllimin e tij të keq.

QEROSI — Po ti je i varfër. Ku i gjete florinj-
të, o njeri?

MBRETI — Ohu! Histori e gjatë! Po të puth
këmbë e duar të më japësh një kalë!

QEROSI — Mirë. Po unë dua vërtet të më pu-
thësh këmbët.

(Pauzë.)

MBRETI — Mirë. Do të t'i puth.

(Mbreti i puth duart Qerosit e pastaj, kur ky heq opingat, ia puth me neveri edhe këmbët.)

QEROSI — Shko merre kalin.

MBRETI — Nuk e zgjidh dot kapistrën.

QEROSI — (Kalit duke fryrë në unazë.) Zgjidhu! (Kali vjen tek mbreti, ky hipën në të dhe niset.)

MBRETI — Të gjetsha shëndoshë, o Qeros!

(Mbreti zhduket.)

QEROSI — Sa budalla që je, madhëri! Unë do të ta marr kalin përsëri. Ja, me këtë fyell!

(Hyn dielli e del hëna.)

QEROZI — (Duke fryrë në unazë.) Kuaj, zgjidhuni të shkojmë në pallat. Hajde, fyell, të thërresim kalin që na mori mbreti!

(Qerosi i bie fyellin dhe pas pak dëgjo het troku i kalit e menjëherë shfaqet kalli. Qerosi hipën në të.)

Hajdeni tani të shkojmë e t'i marrim çupën mbretit! (Qerosi në majë të kalit niset për në pallat të mbretit.)



Pallati i mbretit. Plot me roja dhe oborrtarë.

MBRETI — Sonte do t'i presim kokën Qerosit dhe do ta fejojmë çupën tonë me djalë e mbretit Abrash. Hajde këtu pranë nesh, o dhëndër! (Dhëndri vjen e ulet krahu mbretit.)

NJË SHËRBËTOR — (Duke ardhur) Mbret, po vjen Qerosi me dyzet kuaj!

MBRETI — Jo me dyzet. Njërin ia mora unë dhe e kam në ahur.

SHËRBËTORI — O mbret! Kali ka ikur nga ahuri dhe është bashkuar me të tjerët. Qerosi po e sjell kopenë, të plotë!

MBRETI — (*Me tërbim.*) Ah qafiri, ma fitoi bastin!

(*Hyn Qerosi dhe përkulet përpara mbretit.*)

QEROSI — Mbret i ndritur! Kuajt i ke të gjithë në ahur. Rojat i numëruan. Bastin ta fitova. Dua çupën tënde.

(*Pauzë.*)

MBRETI — Nuk e ke fituar akoma, o Qeros! (*Shërbëtorëve.*) Sillni këtu një shportë.

(*Shërbëtorët sjellin një shportë.*)

Po të jesh i zoti të ma mbushësh këtë shportë me llafe e paç hallall çupën time. o Qeros.

QEROSI — Nuk e bëmë fjalën kështu, o mbret.

MBRETI — Mbushe shportën me llafe, se të iku koka!

(*Pauzë.*)

QEROSI — Mirë. Ma jepni shportën. (*Fillon të tregojë brenda në shportë.*) Një mbret i kishte dhënë Qerosit t'i ruante dyzet kuaj. Si e pa që Qerosi po i ruante vërtet, mbreti u mundua t'i vidhte një. Hoqi rrobën e mbretit dhe u vesh si fukara. I kërkoi një kalë e meqë Qerosi nuk i dha, u detyrua t'ia heqë opingat, të ulë kokën dhe...

MBRETI — (*Kërcen.*) Mjaft! E mbushe shportën.

(*Pauzë e rëndë. Të gjithë presin.*)

Megjithatë çupa e mbretit nuk është për Qerosin. Ajo do të bëhet nusja e të bi-

rit të mbretit Abrash. (*Dhëndrit.*) Hajde këtu ti, djalë! (*Djali vjen*) Dhe ti, bija ime! (*Çupa vjen kokulur.*) Dhe tani i jepni dorën njëri-tjetrit, u trashëgofshi e Qerozi të mbetet me gisht në gojë! (*Dhëndri shkon te çupa dhe i zgjat dorën.*)
— Çupë! Jepi dorën! (*Ashpër.*) Jepi dorën!

(*Çupa ia jep.*)

QEROSI — (*I fryn unazës*) Lidhu!

ÇUPA — (*E trembur*) Ç'është kjo?! Nuk ndahemi dot.

DHËNDRI — (*Përpiqet të ndahet*) O bela! Ç'patëm kështu!?

MBRETI — (*Një shërbëtori*) Ndaji!

QEROSI — Lidhu!

(*Me çupën dhe dhëndrin mbetet i lidhur edhe shërbëtori.*)

SHËRBËTORI — Oh, ç'më gjeti! Hiqmëni!

MBRETI — (*Një tjetri*) Shko ti!

(*Lidhet dhe shërbëtori tjetër. Zhurmë, përpjekje për t'u zgjidhur.*)

MBRETI — (*Rojës*) Shko dhe ti, përpiqu t'i ndash.

(*Roja u afrohet.*)

QEROSI — Lidhu!

(*Mbetet i lidhur dhe roja. Të gjithë ngatërrohen, mundohen të zgjidhen por më kot.*)

MBRETI — Ç'bëhet kështu?! Hapuni, se do t'i zgjidh vetë! (*Mbreti i afrohet tufës së lidhur.*)

QEROSI — Lidhu mbret!

(*Mbreti lidhet me të tjerët.*)

MBRETI — Ah, ç'është kjo punë! Shtyhu pak!
Tërhiqe dorën! Hapu!

ZËRA — Lëshomë!

— Lëshomë ti!

— Ti s'më ndahesh!

(Një nga një fillojnë e lidhen të gjithë sa janë. Kur s'ka mbetur asnjë i zgjidhur atëherë Qerosi i fryn përsëri unazës.)

QEROSI — Kali i mbretit: Zgjidhu!

(Dëgjohet troku dhe kali që vjen.)

QEROSI — Çupë e mbretit: Zgjidhu!

(Çupa e mbretit zgjidhet dhe vjen pranë Qerosit. Ai e zë për belë dhe e hipën në kalë.)

O mbret, deshe të ma bëje me të pabesë. Unë çupën ta mora. Mbetsh me shëndet, lidhur në tufë!

(I bie kalit dhe ikën tok me çupën e mbretit. Mbreti me të tjerët mundohen të ndahen.)

MBRETI — Ma mori! Ma mori!

(Mbreti i tërheq pas dhe të tjerët për të ndalur Qerosin. Por Qerosi tanimë është larg.)

KONFERENCIERI — Dhe Qerosi me nusen u martuan e u trashëguan. Bënë dasmë të madhe... E kush nuk u vajti në dasmë. Isha dhe unë... As përralla ju rrëfeva, po desha e ju gënjeva.

VENDI I PARË

VETAT: RAKIPI — kooperativist. MËSUESJA E SHKOLLËS SË NATËS — KOOPERATIVISTË TË TJERË, NXËNËS...

Në shkollën e mbrëmjes. Rakipi ka dalë në dërrasën e zezë.

MËSUESJA — Hë, Rakip, je përgatitur?

RAKIPI — Me sa kemi pasur mundësi, shoqja mësuese. Kemi pasur edhe punë.

MËSUESJA — Dua të më analizosh fjalët në një fjali të tillë. (*Lexon nga libri, Rakipi shkruan.*) «Po të ishim mobilizuar më shumë do të kishim zënë vendin e parë».

RAKIPI — Ku?

MËSUESJA — Si ku?

RAKIPI — Them: ku do ta kishim zënë vendin e parë?

MËSUESJA — Kjo s'ka rëndësi.

RAKIPI — E eee, po këtu është rëndësia. Dale e ta marrim vesh se çfarë gjelle është kjo?! Pa kuptim?!

MËSUESJA — Mirë, mirë, (*Shpejt.*) ...Po të ishim mobilizuar më shumë do të kishim zënë vendin e parë në prodhimin e dritërave të bukës. Është e plotë fjalia?

RAKIPI — (*Duke buzëqeshur u shkel syrin shokëve.*) E plotë, por e kotë!

MËSUESJA — «Do të kishim zënë» Ç'është?

RAKIPI — Asgjë nuk është. Ne si sektor për prodhimin e drithërave zëmë vendin e parë në të gjithë kooperativën.

MËSUESJA — Po mirë, për punë gramatike s'ka rëndësi.

RAKIPI — Dale, dale. Unë vij në shkollë tërë qejf, se kemi zënë vendin e parë, mësuesja më thotë: «Do ta kishim zënë vendin e parë». Moj e uruar, ne e zëmë! Jo! Do ta kishim zënë. (*Qesh me të madhe.*)

MËSUESJA — (*Duke qeshur.*) Dale, dale, Rakip! Nga pikëpamja mësimore mua më lipset mënyra, koha...

RAKIPI — Po mënyra revolucionare! Koha... (*Mendohet*) S'kemi pyetur për kohë ne! Ditën, ditën! Natën, natën! Kur është fjala për bukën.

MËSUESJA — Mirë, mirë, ju lumtë, po tani hajde dhe analizoje!

RAKIPI — Le ta analizojnë ata që zënë vendin e dytë, të tretin e ata që janë prapa. Ne, që zëmë të parin, s'ta analizojmë hiç! Bile edhe si kooperativë. Kooperativa jonë e ka plotësuar dhe tejkaluar planin e drithërave. Nuk e di ti, moj shoqja mësuese?

MËSUESJA — Ne kishim veçoritë e foljeve në mënyrë kushtore, por... ty, Rakip, nuk të vjen keq të të pyes hapur: Mos vallë kjo gjë të ka bërë të lësh mënjanë përgatitjen në gramatikë.

RAKIPI — (*Pas një pauze.*) Ne kemi faqen e bardhë në prodhim, ditën... E po nuk do

ta nximë në mësim, natën! Një kushtore do ti? Mbylle librin! Ta jap unë fjalinë: «Po t'i plotësojmë të gjitha detyrat, siç plotësuam sivjet këtë të drithërave të bukës, nuk do ta ulim kokën e nuk do ta ndejmë dorën, po do t'i themi rrethimit: Na marrsh të kegen!».



A DONI MË PËR BELULIN?!

Sipas Q. Buxhelit

Belul Gjeraqina, që po përkujtojmë sot, ka qenë një shkrimtar i shquar. Parafolësit përmendën kontributin e tij, idetë që përforcoi ai. Po për këto flet vepra që na ka lënë. Këtu unë do të them të pashkruarat, që ta njihni

ju që s'e keni njohur nga afër, siç pata unë rastin, nderin, mundësinë dhe kënaqësinë.

Ç't'ju tregoj për Belulin?...

Më kujtohet si sot takimi i fundit me të. Ashtu si gjithë jetën, edhe në ato çaste unë iu ndodha pranë. Pranë më desh gjithnjë. «Ti, Sello, më frymëzon, — thoshte, — m'i shton forcat!» Dhe ia shtoja vërtet. Ai nuk gënjente kurrë. Natyrisht ai më çmonte, po unë nuk do të rri tani të flas për veten. Ne po përkujtojmë Belulin! Ku e lamë! Hë... Më kujtohet si tani. U ngrit në bërryle dhe më tha: «Selahudin, i dashur, mik i shtrenjtë, afrohu!» Unë iu binda. «Ti, Selahudin, — më tha, — ke qënë njeriu më i afërt për mua». «Asgjë, o Belul», thashë. «Ah jo, — tha, — ç'e do jetën po nuk pate pranë një njeri me vlera siç je ti!» (E kishte fjalën për mua). Dhe ai, vëllezër, nuk gënjente. As nuk bënte lajka. Jo, jo, këto cilësi të vyera i kish.

Ç't'ju tregoj tjetër për Belulin?...

Më lejoni t'ju përmend një cilësi të veçantë të tij: Nuk ishte fare ziliqar: S'vuante nga zilia Beluli. Se nga vajta i lexova një novelë që kisha shkruar unë. Ç'bëri vaki thoni ju? Kur mbarova leximin ai u ngrit, mori nga rafti dhjetë novela, të tija të pabotuara dhe i hodhi në zjarr. «Ç'bëre?!» — i thashë. «Gjepura, — më tha, — tani që dëgjova novelën tënde, më vjen turp. Ti je gjeni, Selahudin. As që e merr me mend sa i madh do të bëhesh. Për shumë kohë njerzit, bashkohësit e tu (e kishte fjalën për ju) nuk do ta kuptojnë dot se kanë në mes tyre një gjeni!» (E kishte fjalën për mua). Dhe parashikoi drejt. Kanë kaluar njëzet vjet e atë novelë nuk po ma botojnë. E quajnë pa vlera ...Hi-hi-hi! (Po unë o e botoj atë novelë o vdes!) Ju e kuptoni, vëllezër, mua më vjen rëndë tani të përsëris këtu

fjalët që tha ai. Mbi të gjitha, për fat të keq, kur i tha Beluli këto fjalë, aty nuk u ndodh asnjë dëshmitar. Po ja, jam unë. Unë nuk hesht kur është puna për të treguar se ai s'vuante fare nga zilia.

Ç'tju tregoj tjetër për Belulin?

Talenti, vëllezër, që njëra anë e tij. Ana tjetër që burrëria, trimëria. I kishte marrë zjarr shtëpia një herë. Të gjithë kishin dalë nga rreziku, po Beluli ndodhej brenda. Flakët krrakërinin deri në qiell e përvëlonin ç'të gjenin. S'pyesnin ato ishe poet a prozator! S'pyesnin ato ishe talent i madh apo mesatar! Të afërmit e Belulit kishin ulur kokat, të tjerët kishin ngritur duart. Zjarrfiksat panë ç'panë e i prenë shpresat. Hoqën helmetat e thanë: Vajti kjo punë! Keq puna. Mua s'më mbante vendi. Natyrisht nuk është rasti këtu që, duke folur për jetën e një shoku, të flasë njeriu për veten. E thamë njëherë këtë. Megjithatë s'ri dot pa thënë se kam një të keqe të madhe. Jam kokëkrisur, mbaroi. S'pyes rrezik. Lere pastaj kur më rrezikohet shoku. Atëherë mos më dil përpara, se bëhem tigër. E tigri më parë ulërin. Ulërita:

«S'gjëndet këtu një burrë?! S'ka këtu një trim të na shpëtojë Belulin?!»

Asnjë. Atëherë u sula vetë në mes të flakëve. Për dhjetë sekonda u ndodha përpara Belulit. Belulit s'i dridhej qerpiku. (Fjala vjen se qerpikët i ishin djegur.) Beluli priste me guxim, me trimëri. Një ta hedhur në krahë dhe e nxora jashtë. Vetë digjesha si pishtar, por punë e madhe! Shpëtoi Beluli.

Ja, miqtë e mi, përpara syve tuaj trimëria, burrëria, guximi! (I Belulit sigurisht)

Ç'doni më për Belulin? A doni më? Këtu
dikush m'u lut të flas diçka për veten time.
Hiç mos prisni! Për vete as edhe një fjalë! Hm,
unë dola t'ju tregoj vetëm për Belulin! A doni
më për Belulin?!

LETËR

e katër nëndrejtorave të shkollës së Verigës, dërguar kryedrejtorit të zonës

I nderuari shoku kryedrejtor,

Ne, kolektivi i nëndrejtorave të shkollës së Verigës, jemi tepër të indinjuar (brenda kufijve pedagogjikë) për fjalët që kanë ardhur në veshin tuaj se gjoja nuk shkojmë mirë njëri me tjetrin e se gjoja nëndrejtori Nr. 2 nuk i flet nëndrejtorit Nr. 4.

Këto shpifje në fushën arsimore nuk i shërbejnë mbarëvajtjes. Është e vërtetë që na u hëngrëm ca për ndarjen e punëve, por ama kjo u zgjidh dhe harmonia u betonua me disa vendime për të cilat po ju vëmë në dijeni:

1. — U vendos përfundimisht që zilja e shkollës të mos jetë në kompetencat e nëndrejtorit Nr. 2 por të nëndrejtorit Nr. 1.

2. — Për dhënie leje mësuesve që duan të mungojnë, të kenë të drejtë të katër nëndrejtorët njësoj dhe jo si deri tani, që nëndrejtorit Nr. 2 i ishte hequr kjo kompetencë. Ai me të drejtë ishte fyer. Tani leje mësuesve po u jep edhe ai. Shkurt po japim që të katër.

3. — U vendos t'ju paraqitet një kërkesë juve, shoku kryedrejtor, që brenda mundësive të

na shtoni edhe dy nëndrejtorë të tjerë. Të pak-
tën një për shkumësat, se nuk i mori asnjëri.


4. — Dhe së fundi u vendos njëzëri që nën-
drejtori Nr. 3 dhe nëndrejtori Nr. 4 të ndërroj-
në numrat.

Të mbështetur në ankesat e mësuesve të
thjeshtë, që ngatërrojnë nëndrejtorët, dhe të
mbështetur edhe në shpresën se do të bëhemi
gjashtë po shikojmë propozimin e një mësuesi
për të qepur prapa kurrizit dhe në kofshë nga
një numër të rregullt/

Besojmë se ju do të na ndihmoni.

Të fala pedagogjike, brenda organikës
Katër nëndrejtorët njëri pas tjetrit

Verigë, 3 prill 1975



AH, TI DHËNDËR I STONUAR

Skeç

VETAT: QAMILI — muzikant, E SHOQJA, E BIJA,
DJALI që do të bijën e muzikantit

Në shtëpinë e Qamilit. Vajza po dëgjon pranë dritares zërin e një djali që këndon nga jashtë. Hyn Qamili me violinë nën sjetull.

NJË ZË — (Nga jashtë)

Kur kalon ti rrugës për n'uzinë;
më shikon dhe të shikoj,
por sa kohë duhet ta kuptosh
me shikim të them të dashuroj.

QAMILI — (Vajzës.) Bukur, ëh?!... Të pëlqen?

VAJZA — (E hutuar.) Babi, po këtë këngë e ke kompozuar ti.

QAMILI — A, prandaj e dëgjon ti, ëh?! Tundu! Na përgatisni darkën. (Vajza del) Unë e kam kompozuar... E di. Kam fituar dhe çmim... Po më duket se po e paguaj shtrenjt.

GRUAJA — Këngë e paharruar, Qamil.

QAMILI — E paharruar s'do mend!... Të lë ta harrosh ky bandill?! Ky zorzopi, që...

GRUAJA — E ç'faj të ka? Të pëlqen kënga, e këndon... Ti për popullin punonjës e ke kompozuar.

QAMILI — Shiko! Për popullin, moj, dakord po ç'e do se populli punonjës vjen e ma këndon këtu nën dritare!... Për çupën time. Babai kompozon, shoku e këndon, çupa fluturon... Fiuuuu!

GRUAJA — Ti, Qamil, kot e ke marrë inat.. Ai është djalë i mirë... Ty të është prishur qejfi që s'të pyeti.... S'është çudi që të bien dakord e të martohen pa pëlqimin tonë... Këtë nuk e ndien?

QAMILI — E ndiej, e ndiej. E ndiej. S'gjeta njëherë rehat... Vjen në shtëpi e në vend që të qetësohesh të turbullojnë akorde disonante. Çupa lidhet në duet me një tip antipatik... Kur hop, bashkohet dhe gruaja dhe formojnë një trio...

GRUAJA — E ke kot, Qamil!

QAMILI — (Bërtet) Mjaft! Mjaft, të them! Na lëshoni bukën!

ZËRI — *Kur kalon ti rrugës për n'uzinë... më shikon dhe të shikoj...*

GRUAJA — Nuk e shikon që vajza është e mër-zitur nga qëndrimi yt. (Ndërsa zëri dëg-johet.) Dhe ky djalosh i gjerë kot nuk të pëlqen.

QAMILI — Jo, bile më pëlqen shumë!... Ka futur në repertor këngët e mia dhe kuj-ton se do t'ia miratoj... Është i zgjuar ai... Hë hë!...

GRUAJA — Është simpatik.

QAMILI — Shumë... E di? Them të marr vi-olinën e të dal ta shoqëroj. (Rrëmbehet) Të dal t'ia thyej violinën kokës, dëgjo-ve?! Dëgjova thuaj!

ZËRI — *Kur kalon ti rrugës për n'uzinë...*

QAMILI — Bobo e zuri gjysmë toni më lart. Turp kush ta dëgjojë! Nuk arrin dot. Hë! Ja, ngeci. (Vrapon në dritare, i bër-tet djalit.) Hë, hë!... Është kockë e for-të për ty ky refreni! (Gruas) Të thashë? E, ç'na torturoi!... Mojë, po do të vijë dar-ka apo jo? Dua të ha!
(Ndërkohë vjen vajza me djalin për do-re. Babai ngrin)

QAMILI — Ky nuk hahet... Ja, ky nuk hahet fare.... Çfarë do, more djalosh?

VAJZA — Baba! Ne kemi vendosur...

DJALI — Ju nuk më njihni... T'ju them ca gjëra për përsonein tim. Jam punëtor me ata të pararojës...

QAMILI — Me ata të pararojës po...

DJALI — Kam vetëm nënën në shtëpi. Tjetër... Unë marr pjesë prej vitesh në grupet artistike diletante.

QAMILI — Je diletant?

DJALI — Si urdhëron, diletant.

QAMILI — Po në prova pse nuk shkon? Tjetër?

DJALI — Ku di unë?!... Ç't'ju them tjetër për veten time... Shpresën e dashuroj marrëzisht dhe jam djalë i mirë... Kaq.

GRUAJA — Po ulu!

DJALI — Jo nuk kam ardhur të rri... Bile as përgjigje nuk pres. ...Babai e ka zor... Unë vetëm kaq erdha të them... S'ka forcë në botë që të më ndajë nga Shpresa.
(I jep dorën Shpresës dhe del).

GRUAJA — Tani silli darkën babait.

QAMILI — Tani u ngopa, s'dua më... Ju falemnderit edhe ty, edhe ty!... Dëgjuat!

ZËRI — Kur kalon ti rrugës për n'uzinë...
(Të gjithë presin finalen e vështirë. Djali përsëri stonon).

QAMILI — O ooo obo bo!... Aman, moj bijë, dil në dritare e thuaj ta zërë më ulët, se s'arrin dot... Në do diezis, thuaji!... Dreq, o punë, si do ta kaloj jetën me këtë dhëndër të stonuar!...



Ç'ËSHTË KJO PAKO

Sipas T. Aliajt

VEËAT: ÇEÇOJA, LEFTERIA SABIKOJA STEFANI

Ngjarjet zhvillohen në një zyrë administrative. Në tryezë punon Lefteria. Hyn Sabikoja.

LEFTERIA — Të kërkoja, Sabiko.

SABIKOJA — Më thanë. Isha në komunale.
(*Bën shenjë nga tryeza tjetër.*) Ky paska dalë?

LEFTERIA — Për këtë të thirra. Sot më bëri të qaj. Tani ia tregoj unë qejfin atij.

SABIKOJA — Si është puna?

LEFTERIA — Ia tregoj unë! Më pa që nga dritarja kur më qerasi Moza me një pastë. Kur erdha më pyeti. I tregova se vajta të bisedoja me përgjegjësen e trikotazhit, që e kam timen, që t'ia mbarojë Mozës bluzën dy ditë përpara.

SABIKOJA — Po ti e njuh Çeçon.

LEFTERIA — Bëri namin. «Pse thyeni rregullat?... Ç'janë këto ndërhyrje?. Do të bëhet bluza e Mozës, po do t'i mbetet një tjetre pa bërë.» Pastaj nisi të më tallte. «Lum si zyra jonë, thoshte, që e zgjidhi problemin e trikotazhit. Po u zgjeruam, mund të hapim edhe këtu një repart. Do të na vijnë në zyrë pasat, akulloret, farefisi...» Kur iku ai, unë qava.

SABIKOJA — Punon me të në një zyrë dhe nuk ia di huqet. Ai nuk i shkel kurrë rregullat. Kur dal me shërbim me të, unë rri si nxënësja para mësuesit. Ai i urren qerasjet dhe ndërhyrjet.

LEFTERIA — Nuk qenka dhe aq sa tregohet.

Tani ia tregoj unë! Shiko se çfarë i kanë dërguar... (Naxjerr që poshtë tryezës një pako.)

SABIKOJA — Ç'është?

LEFTERIJA — Një pako. Një pako me bisht. (E vendos mbi tryezë) E di ç'ka brenda?

SABIKOJA — E nga ta di?!

LEFTERIA — Tri shishe litroshe me raki rrushi për Çeçon, një palë këpucë meshine të zeza për Çeçon, një palë çorape për të shoqen e Çeços, një të kuq buzësh për të shoqen e Çeços dhe një stilograf për Çeçon e të shoqes. Mirë që nuk i kanë dërguar ndonjë gjë edhe për fëmijët, prindërit apo fqinjët. Çeçoja ynë. Parimori hë!

SABIKOJA — Ti... Ia hape?

LEFTERIA — Unë ia mbylla. Atij që i sollti iu çka pakoja dhe e paketuam përsëri. S'kishte faj pakoja. Gjithë këto asortimente; për të pirë, për të veshur. Ai burri ishte një skërfyell. «Më ka bërë një nder Çeçoja, që nuk ia harroj, tha. Po munda, do të vij prapë ta gjej. Shtëpinë nuk ia di». Sidoqoftë i la një letër. Ja shoku Çeço, që më bëri mua të qaj për një copë bluzë. Pa mëngë.

SABIKOJA — Kaq e asgjë tjetër?

LEFTERIA — Pse, deshe akoma ti?

SABIKOJA — Jo, po desha të them se Çeçoja mund t'i ketë porositur... me pagesë, desha të them.

LEFTERIA — Jo, moj, jo! Ai më tha copë: Më ka bërë një nder. E more vesh tani? Nderi nuk porositet. As shpërblehet.

SABIKOJA — S'më besohet.

LEFTERIA — E ee! Për një pastë çfarë s'më

tha. Ja, po i dëgjoj zërin, tani do të kënaqemi.

SABIKOJA — Unë po iki se ai nuk ka qejf të na shohë pa punë. Më gjeti këtu. (Shtirret sikur ka ardhur për punë. Hyn Çeço Resuli. Është një mesoburrë. Duket që është në qejf.)

SABIKOJA — Prit t'i shënoj edhe një herë: dyzetë e shtatë, tridhjetë e shtatë, katërqind.

ÇEÇOJA — (Sabikos) Paske ardhur ti, zeshkë e qëmotit?...

SABIKOJA — Ja, po marr ca shifra.

ÇEÇOJA — Shifra të japim sa të duash ne... Bile edhe gjëra të tjera. Po pate ndonjë bluzë ne mund të ndërhyjmë, se përgjegjësen e kemi tonën. Veç duam të na gostisësh me pasta. S'është ndonjë harxh kushedi çë.

SABIKOJA — Jo, jo, nuk kam asgjë.

ÇEÇOJA — Nuk të bëjnë dëm të madh. Një pastë është. Me krem.

SABIKOJA — Unë nuk i ha pastat.

ÇEÇOJA — Ca më mirë. I hamë ne. Bile edhe në orarin e punës.

SABIKOJA — Mos e bëni kaq të madhe, shoku Çeço. Gjëra që ngjasin.

ÇEÇOJA — Ngjasin, si nuk ngjasin... Bile edhe ngjisin.

(Sabikoja del.)

LEFTERIA — E po unë rakinë nuk e pi, prandaj ha pasta.

ÇEÇOJA — Dhe për atë do të ishe mangut ti...

LEFTERIA — Orekse-orekse janë njerëzit...

ÇEÇOJA — (Shkon te tryeza e tij dhe shikon pakon.) Ç'është kjo?

LEFTERIA — Një pako.

ÇEÇOJA — Pako?!

LEFTERIA — Dhuratë... bakshish... merre si të duash...

ÇEÇOJA — Kush e solli?

LEFTERIA — Një burrë i gjatë. Stefan e quajnë.

ÇEÇOJA — Stefan? Për kë e solli ky Stefani?

LEFTERIA — Për Çeçon, tha.

ÇEÇOJA — Për mua?!

LEFTERIA — Epo mua nuk më quajnë Çeço.

ÇEÇOJA — Çeço më quajnë mua. Çeço Resuli. (I habitur) Ah! (Me vete.) Kush do të jetë vallë ky Stefani? (Me inat) Kush? Stefan Dajlani... Jo... Stefan Mashani... Stefan Shejtani... Asgjë nuk po marr vesh... (Zbërthen pakon) Ah! (I numëron të gjitha ato që përmend Lefteria më parë duke nxjerrë klithma habie.) Mirë, o xhaxha Stefan, po unë nuk të njoh. Paskeni dhe një letër... Po unë nuk i kam syzet. I paskam lënë në komunale... Lef-të, do të ma bësh këtë të mirë të ma lexosh.

LEFTERIA — Unë?! Po ajo është për ty. Të fshehtat e tua...

ÇEÇOJA — O po jepi se s'turpërohem.

LEFTERIA — (Lexon) Merr Çeço Resuli!

ÇEÇOJA — E mora. Vazhdo!

LEFTERIA — «I dashur, shoku Çeço! Ajo punë, që i hyre ti, mori fund. Ai miku që e kish në dorë atë muhabetin, e mbaroi. Me t'i thënë unë asaj, ajo ta tha ty, ti i the atij, ai ma dha. Kisha frikë se kur

- ta tha ajo, s'ma tha as si ta tha e qysh
ta tha. Veç kur ai fap, ma dha».
- ÇEÇOJA — Tha, tha, ra, tha, dha. Unë s'mora
vesh gjë... Lexoje edhe një herë!
- LEFTERIA — (*E përsërit leximin.*) Të puth me
mall.
- ÇEÇOJA — Kush?
- LEFTERIA — Stefani kush? Stefan Sojku. Po-
shtë shënim: «Unë me ty s'lahem dot.
Lojta mendsh nga gëzimi!»
- ÇEÇOJA — Lojta mendsh, thotë? Epo qenka
i lojtur. E besoj.
- LEFTERIA — Ai nuk ishte hiç i lojtur. Tha se
do të vijë përsëri.
- ÇEÇOJA — Ah, përsëri? Kështu tha?
- LEFTERIA — Po. Dhe unë besoj se do ta mba-
jë fjalën.
- ÇEÇOJA — Ah, ti beson?
- LEFTERIA — Po. Ai (*tregon pakon e hapur*).
e ka dhënë një provë për këtë. Edhe ju
duhet ta besoni.
- ÇEÇOJA — (*Disi i hutuar*) Po, e besoj, e besoj...
- LEFTERIA — Kështu mendoj edhe unë. Ja, er-
dhi.
(*Hyn Stefani. Ai po fluturon. Kjo filli-
misht e tremb Çeçon, po ai nuk e jep
veten.*)
- STEFANI — Shoku Çeço! Të gjeta! Ha! Ha! Me
ty nuk lahem. (*Sulet e përqafon*) Ha-ha.
Çeço! Shoku Çeço! I miri Çeço! Ha-ha!
Nderi s'harrohet. Ha-ha! (*I jep dorën
Lefterisë.*)
- LEFTERIA — U takuam një herë.
- STEFANI — Po... Unë desha Çeçon. (*I hidhet
Çeços.*) Nuk ta harroj, Çeço. U bë.
- ÇEÇOJA — U bë?
- STEFANI — U bë!

ÇEÇOJA — Si doli?

STEFANI — Djalë!

ÇEÇOJA — Djalë?! (*Habitet*)

STEFANI — Po, pra. Pse, po të kishte dalë vajzë, vija unë këtu?

ÇEÇOJA — Mor shok, s'kam njeri me barrë që të pres lindjen. Me gruan këtë llogari e kam mbyllur.

STEFANI — Unë them për atë porosinë që mori fund.

ÇEÇOJA — Mori fund?

STEFANI — Mori fund.

ÇEÇOJA — Mbaroi?

STEFANI — Mbaroi.

ÇEÇOJA — Çfarë mbaroi? (*Pauzë.*)

STEFANI — Ajo, de, puna e dhomës. Ma dhanë zgjerimin. Më dhanë dhe një dhomë. Tri ditë pasi ike ti. (*Lefterisë*) Kisha shumë nevojë. Ishim tri kurora... Tri kurora e gjysmë. Dy kurora ty t'i thanë. Gjysmë kurorë, ti e kupton. Kurora tjetër se ne jemi kështu.

ÇEÇOJA — Or, vëlla, ta themi copë, kush je ti? Unë nuk të njoh.

STEFANI — Paske kujtesë të dobët, Çeço... A ishe ti në Sojak me shërbim. Me Sabikon.

ÇEÇOJA — E njeh dhe Sabikon?

STEFANI — Po, e kam kushërirë. Ti a e njeh shefin tonë të strehimit?

ÇEÇOJA — E njoh.

STEFANI — A e ke shok të ngushtë?

ÇEÇOJA — E kam.

STEFANI — Ai ma dha. Pimë kafe unë, ti e Sabikoja. Pastaj unë i thashë Sabikos. Ajo të tha ty, ti i the atij. I thashë, të tha. Ai ma dha. Ja ç'bëri një kafe... një llaf goje... për kaq gjë kisha nevojë.

- ÇEÇOJA — S'po marr vesh gjë.
- LEFTERIA — A t'ju lë vetëm, shoku Çeço, që të merreni vesh? Po dal.
- ÇEÇOJA — E di ç'ke ti? Dil dhe më thirr Sabikon.
- STEFANI — Qëparë nuk ishte.
- LEFTERIA — Ka ardhur. *(Del.)*
- STEFANI — Po ishim tri kurora e gjysmë kurore...
- ÇEÇOJA — Kush është kjo gjysmë kurore?
- STEFANI — Unë jam ndarë nga gruaja.
- ÇEÇOJA — Or mik; mos fillo përsëri me kurorat... E more dhomën, e gëzofsh! Po unë nuk pranoj dhurata.
(I mbledh dhuratat në pako) Nuk më takon asgjë.
- STEFANI — Shih, shih! Po kjo është gjë e vogël. Unë mora zgjerim.
- ÇEÇOJA — E po unë e ndiej veten ngushtë. Merri!
- STEFANI — Do t'i marrësh ti! *(I shtyn.)*
- ÇEÇOJA — Nuk i marr. *(I shtyn.)*
- STEFANI — Do t'i marrësh, se unë i kam bërë dalje.
- ÇEÇOJA — Po ja që unë nuk i bëj hyrje.
- STEFANI — Peshqeshi nuk kthehet.
- ÇEÇOJA — Kthehet dhe me resto, bile!
(Vazhdon shtyrja e pakos sa nga njëri aq dhe nga tjetri.)
- STEFANI — Unë jam mësuar t'i shpërblej nderet me nder, nuk jam nga ata që i bie qylit unë.
- ÇEÇOJA — Dukesh ti.
(Hyn Sabikoja dhe Lefteria.)
- SABIKOJA — Stefan!
- STEFANI — Biko!... E mora... ç'bën miku... Ma

dhanë sa ikët ju. Kjo është meritë e shokut Çeço.

ÇEÇOJA — Si është puna, moj Biko?

STEFANI — (*Sabikos*) Pse hiqet kështu ky?

LEFTERIA — Shoku Çeço, të dal, se më duket ju vjen zor nga unë.

ÇEÇOJA — Rri, moj, rri ti e dëgjo!

STEFANI — (*Sabikos.*) Biko, nuk t'u luta unë t'i thoshe Çeços që kishte shok shefin e strehimit?

SABIKOJA — Unë nuk i thashë asgjë veças.

STEFANI — Nuk i the? Pse?

SABIKOJA — Unë të thashë, Stefan. Çeçoja nuk futet në këto gjëra. Meqë kishe të drejtë e të takonte, ata shokët e Sojakut do të ta jepnin zgjerimin.

STEFANI — Po ata ma dhanë. Pse ma dhanë?

SABIKOJA — Se të takonte.

STEFANI — Pa mik?

SABIKOJA — Pa mik.

ÇEÇOJA — E paske kaluar jetën me hile ti, or shoku Stefan.

STEFANI — (*Sabikos.*) Domethënë ti nuk më ndihmove?

SABIKOJA — Jo.

STEFANI — Ta mbash mend. Këtë nuk e prisja. Po ç'kushërirë më qenke ti?

SABIKOJA — (*Duke i ardhur zor nga Çeçoja dhe Lefteria.*) Epo ja. Kështu jam... S'më ke njohur?

STEFANI — Nuk e vure fare ujin në zjarr ti?!

SABIKOJA — Po nuk ishte nevoja, Stefan.

STEFANI — Si, moj? Po a kisha hall unë?

SABIKOJA — Po ja, de, ta zgjidhën. Kot bën fjalë tani.

STEFANI — S'kam gjë me ata të strehimit. Inatin e kam me ty.

- SABIKOJA — (*E bezdisur.*) Ohuuu!
- ÇEÇOJA — (*Ndërhyn.*) Ore, shoku Stefan! Më fal po kot e zgjat tani.
- STEFANI — (*Çeços*) As me ty s'kam inat, shoku Çeço, Se kjo nuk të tha. (*Duke i bërë qejfin.*) Të ta kishte thënë unë jam shumë i sigurt se ti do të ndërhyje, se ti je burrë i mirë... Ti je...
- ÇEÇOJA — (*Duke u përmbajtur.*) Nuk jam aq burrë «i mirë».
- LEFTERIA — Thuaj shyqyr që nuk i tha.
- STEFANI — (*Kthehet nga Lefteria.*) Pse shyqyr?
- ÇEÇOJA — Ik i qetë tani!
- STEFANI — (*Lesterisë*) Jo, pse shyqyr?
- ÇEÇOJA — (*Vazhdon të përmbahet.*) Se jam ca me huqe unë. Do të më kapërcente ndonjë damar ters e do të të bëja qepaze e të të prishja punë. E more vesh tani?
- STEFANI — (*I nxehur*) Ashtu? Ju paçi atë faqe që keni, pa unë ç'pata për të bërë e bëra. Yh! E shihni tjetrin tri kurora e gjysmë dhe...
- ÇEÇOJA — Dëgjo, ti, ore gjysmë e kurorës... Dil që këtej me të mirë, se do të t'i shkul ato lule që ke nën hundë.
- SABIKOJA — (*Stefanit*) Dil shpejt, se po u nxeh Çeçoja...
- STEFANI — Vërtet thua? (*Del i trembur.*)
- ÇEÇOJA — Nuk i hoqëm qafë akoma këta matrapazë. Një kërkesë që kanë nuk e ndoqën njëherë në rrugë të drejtë. Oh ç'ma la këtë pakon...
- LEFTERIA — Dhe ku e la pa! Mbi tryezën e punës.
- ÇEÇOJA — Hë dhe ti këtë deshe, apo jo?

LEFTERIA — Unë? Po ç'hyj unë këtu? Këto janë probleme të strehimit...

(Stefani shfaqet në derë.)

ÇEÇOJA — Mirë se erdhe!

STEFANI — (Tregon me gisht.) Pakon!

ÇEÇOJA — Merre e piji lëngun!

STEFANI — (Vjen e merr me frikë.) Të ma mbanni mend. Nuk jua kisha borxh. (Duke marrë nga toka një lidhëse nga të pakos.) As këtë nuk ua lë. (Del duke u penguar të lidhësja.)

ÇEÇOJA — Yh! Kujdes, se do të thyesh hundët! (Dhe duke rifilluar punën murmurit i nevrrikosur kundër Stefanit. Pastaj, vajzave) Po ju ç'keni që çuqurisni?

SABIKOJA — (Duke ngacmuar Lefterinë.) Ja po e pyesja Leftën. Para një ore e kishim parë me lot në sy.

LEFTERIA — (Qesh dhe ul kokën) S'kisha gjë me Çeçon. Më kishte rënë diçka në sy.

ÇEÇOJA — Ç'hyj unë në këtë mes? Ajo që ngatërruar nëpër pasticerira dhe mund t'i ketë hyrë në sy o ndonjë cifël lajthie o ndonjë plaçkë sherbeti, apo jo, Leftë?

LEFTERIA — (E pajtuar.) Ashtu është, shoku Çeço. Topi nuk e luan.

KËNGËT E FUNDIT TË VITIT

VETAT: BIRÇJA ZAÇJA.

ZAÇJA — Në fund të vitit njerëzit bëjnë bilancet e festojnë arritjet. Festojnë Vitin e Ri me suksese punonjësit e industrisë dhe të bujqësisë.

BIRÇJA — Vitin e Ri e festojnë dhe ata që nuk plotësojnë planin. Dhe ata pinë e këndojnë.

ZAÇJA — Pinë e këndojnë që ç'ke me të!

BIRÇJA — Veç gëzimi dhe festa për ta nuk është e plotë. Ata e festojnë Vitin e Ri e thonë se duhen përveshur mëngët...

ZAÇJA — E festojnë si të thuash me një dozë autokritike.

BIRÇJA — Ja ç'ndodhi në një sektor pëmëtarie që nuk i kishte plotësuar detyrat.

(Marrin kitarat)

Qetësi, shokë! Po përgatitim koncertin e Vitit të Ri që do të këndojmë përpara kooperativistëve e drejtuesve të sektorit. Merrja, Zaçe!

ZAÇJA — *(Qëron zërin dhe këndon):*
Ç'u mbush mali plot me rrush
plot me rrush,
thotë nëna s'janë krushq,
s'janë krushq.

— Të është pjekur lëkura e ballit, — më tha Caci.

— Lëre, lëre, më ka djegur mirë dielli në mes të arës së korrur, — ia ktheva, më tepër për t'i treguar se atë paradite kishim qenë kolektivisht për të mbledhur kallinj.

Në bisedë e sipër, drejtori im, që kthehej nga një shërbim jashtë rrethit, iu afrua tryezës sonë. U ngrita, u përqaftova. Pastaj e njoha me Cacin. Drejtori nuk deshë të ulej dhe ashtu, në këmbë, më pyeti se si na shkonin punët. Dhe unë, me dy-tri fjalë, i thashë se punët shkonin mirë, pastaj shtova:

— Sot mblodhëm kallinj, u ndihmuam kooperativistëve.

— Ashtu? Bukur! Pjesëmarrja ishte e mirë?

— Jo keq, — ia ktheva. — Shokët e reparatit tim ishin të gjithë, pa përjashtim.

Dukej që drejtorit iu bë qejfi.

— Mblodhët ca? — u interesua më tej.

— Po, si reparat, them se i mblodhëm nja dhjetë a dymbëdhjetë kuintalë grurë të harruar.

— Vërtet, more?! — për një çast ai hezitoi të besonte, por pastaj shtoi: — Po pse nuk thua ti që... Na paski nderuar... na paski nderuar, — përsëriti i kënaqur. — T'u themi shokëve ta publikojnë në stendat tona.

Atë çast ndjeva një goditje të fortë në fyellin e këmbës. Ishte këpuca e Cacit, i cili ndërkohë po e ndiqte me shqetësim të dukshëm bisedën tonë.

— Pa dhe gazetës i duhet dërguar një informacion, — vazhdoi drejtori.

Këtu mora një goditje të dytë nga Caci.

— Ndenjët shumë në fushë? — pyeti përsëri drejtori.

— Deri aty nga ora katër, -- iu përgjigja

fare natyrshëm, dhe nuk kuptova përse mora goditjen e tretë poshtë tryezës.

Me të ikur drejtori, u ula t'i kërkoja llogari Cacit.

— Ç'pate ti?! — e pyeta me një farë inati.

— Ç'bëre ashtu, more? — ma ktheu.

— Asgjë. Informova. Raportova. Po...

Caci dukej shumë i shqetësuar.

— Po a je i sigurt për ato që i the? A janë të gjitha të vërteta?

— Po, sigurisht, mor Caci! Pse, ta ha mendja që unë gënjej? Ja, ta zëmë se s'qenë dymbëdhjetë kuintalë, janë gjashtë! Se mos ai do të shkojë t'i peshojë.

Lëkundja ime sikur e bëri më këmbëngulës Cacin.

— A papa! Nganjëherë, more mik, ndonjërin e zë një sëmundje e çuditshme dhe fryhet si palloi... Ke parë se si i fryn pendët palloi? Do të shitet për më shumë se ç'është. Janë me zarar, more xhan, këto punë.

Unë po e shikoja me kureshtje.

— Ca vite më parë... — nisi të më tregonte Caci. — Të kujtohet? Ca vite më parë punoja në NPSR; e kishim zyrën në atë kodrinën atje, — dhe zgjati dorën për nga kodrat, matanë të cilave dielli tani qe fshehur fare.

— E di, — i thashë.

— Isha përgjegjës i administratës. Në atë kohë qe shpallur një fushatë pyllëzimesh. Vend ne kishim sa të duash. Duhej të mbillnim plepa. Po hë t'i mbjellim sot, hë t'i mbjellim nesër... Në mbyllje të fushatës mezi u mblodhëm. Hapëm tri gropa e mbollëm tre plepa.

— Sa?

— Tre, or, tre... Një-dy-tre! Turp i madh. Unë vetë nuk kisha asnjë faj, por kur më pye-

tën nga qendra e ndërmarrjes, turpi më rëndoi.

«Mbollët?» — më thanë.

«Mbollëm» — u thashë.

«Po sa?».

T'u thosha tre, për nder, se si më vinte. Mendohesha me telefon në vesh. T'u thosha pesëdhjetë, apo njëqind?

«Nëntëdhjetë e tre!», u përgjigja për ta bërë më të besueshme.

— Ja ky ishte raportimi. U mbyll telefoni, iku fjala.

«E, more, thashë me vetë, plepa janë! Bile as plepa, por filiza. Kush do të vijë t'i shohë? Se mos i thashë që prodhuam televizorë e do të më thoshin na i sillni në magazinë! Plepat-plepa! Një zë, dy nuk zënë. Një thahet, një shkulet...»

Kjo qe. Por do ti që atyre se si u humbi shifra dhe pas disa kohësh më pyetën përsëri... Tërë ato ditë isha mësuar me nëntëdhjetë e treshin dhe më dukej se vërtet kishim mbjellë aq. Prandaj ngaqë më dukej ashtu, sikur më vinte keq të mos shtoja edhe ca. Nuk kishte gjë më të lehtë. S'e zgjata më. E bëra shifrën pesëqind e nëntëdhjetë e tre. Por nuk mbaroi këtu. Sepse, kur më pyetën nga drejtorja e përgjithshme, e pashë të udhës t'i jepja dhe dy-tri pompa shifrës. Demek, hajd, se plepa janë! Dhe për ata tre plepa të gjorë vajti në Ministri një goxha shifër: Në aksh kodër etj., etj., u mbollën nëntëqind e nëntëdhjetë e tre plepa! «Na falni që nuk arritëm dot të plotësojmë mijën», raportova me keqardhje.

— Uf, more Caci! — ia bëra unë i habitur.

— Qesh ti, qesh, po ç'kam hequr unë më vonë. E kisha harruar fare këtë punë. U tha

ajo shifër dhe iku. Fushata fushatë! Ajo që mbyllur, plepat duhej të ishin rritur. Dhe unë të vuaj pesë vjet më vonë! Për ca djall plepa! Më zë njëri me syza dielli... Ama gjatë tërë bisedës nuk i hoqi. Seç ishte një, që as e pyeta. U hutova fare. Nuk e kam parë më atë fytyrë. Kush ishte? O ndonjë shakaxhi, që ma bënte enkas, o ndonjë që interesohej vërtet. Po më futi datën, ama!

«Ju jeni filani?», më thotë.

«Po,» i them.

«Bukur! Sa plepa keni mbjellë...».

«Hej, o bela! Mbaju, Caci, i thashë vetes, se dynjaja bien nga fiku, ti me sa duket do të biësh nga plepi!» Tani t'i thosha shifrën e parë, të dytën apo të tretën?... Po i them të parën, vendosa.

«Nëntëdhjetë e tre!», i thashë tak-fak.

«Në drejtorinë tuaj të përgjithshme keni raportuar se u mbollën nëntëqind e nëntëdhjetë e tre, më tha. — Kjo është mrekulli e vërtetë!».

«Epo, mrekulli është!», ia ktheva unë dhe një e dredhur më zuri peshkun e kurrizit. Duke mbajtur shënime, ai mëmëriti:

«Kjo është e pabesueshme!»

O bela e plepave, nga më zure këmbët!

«Ta besoni», i thashë

«Është e pakrahasueshme!», më tha i mahnitur.

«Jo, krahasojeni po deshët!», e nxita padashur. Kisha hyrë mirë në valle unë.

«Atëherë, aty te ju qenka bërë vërtet një korije gjigante!» më tha ai.

«Korije, thua ti! —, i rashë shkurt, duke i dhënë dorën për t'u ndarë. — Pyll, ore, pyll i vërtetë!»

«Pra, nuk qenkan të kotë ca zëra që thonë se një ekip profesorësh të gjeografisë duan ta përfshijnë në hartën e vendit!

Këtu më zunë djersët e ftohta. Tre plepat e mi të futeshin në hartën e vendit!

«Dale, — i thashë, — në drejtori nuk e kanë shifrën e saktë. Se, helbete, janë vite që ikin këto... Më duket se është pesëqind dhe jo nëntëqind...»

Njeriu me syze u fut në mendime.

«Sa keq! — tha. — Nejse, prapë, kërkesën që do të bëjnë ata të fabrikës së shkrepseve mund ta përmbushni. Ata duan njëmijë metra kub dru plepi për fijet».

Këtu nuk durova më.

«Ore mik, — i thashë, — se nuk ta di as emrin. Atyre të drejtorisë së ndërmarrjes u humbi shifra e parë dhe kërkuan përsëri... Ka të ngjarë që pastaj të jem hutuar... Ata ishin nëntëdhjetë e tre. Po, po, nëntëdhjetë e tre...»

Dhe i dhashë dorën për së dyti... Por, që pas, dëgjova fjalët e tij të thëna me keqardhje:

«Patën fat vetëm fëmijët. Të paktën, do të kënaqen ata».

Nuk munda të bëj asnjë çap më tej.

«Pse, or aman, — e pyeta që larg, — ç'duan fëmijët?»

«Po, ja, thuhet se aty do të ngrihet një kamp verimi klimaterik. Dhe aq plepa sa thoni ju, mjaftojnë...»

As iu afrova më. Megjithatë, duke u larguar, e nxora të vërtetën:

«Gjeografinë lëreni rehat, ata të shkrepseve të bëjnë hall gjetkë e fëmijët të na falin. Doni troç ju? Hapur! Aty ne mbollëm vetëm tre plepa, dhe ato na i hëngrën dhitë!»

Dhe u zhduka. As e pashë e as më pa që atëherë. Por nga ajo kohë vura mend dhe kurrrë s'bëj më raportë me lulka... Ja, ti tani po i thoshe drejtorit tënd ca fjalë të mira që e kënaqnin. Mua s'më mbante vendi. Dymbëdhjetë kuinalë! Ta zëmë se është ashtu. Ty do të të thonë: «Të lumtë!». Po ai që i paska harruar ata kallinj nëpër arë, e pranor, këtë ai? Si i lënka tjetri sheshit dymbëdhjetë kuinal grurë? Pastaj vërtet punuat deri më katër?

Unë heshtja. Por thellë në ndërgjegje i jepja të drejtë. Se, në fakt, drekën e kisha ngrënë në shtëpi, fiks në orën dy. Sa për sasinë, tani isha i bindur që as dy kuinalë nuk bëheshin. I kisha thënë, ç'i kisha thënë drejtorit, të tëra vinin nga përçartja e sëmundjes së dikurshme të Cacit, që, me sa dukej, kish nisur të më rrezikonte edhe mua...



TELAT PËR VIOLINË

Të them se kam bërë një padrejtësi, nuk është tamam ashtu... E megjithatë, ditë të tëra nuk më ka zënë gjumi...

Ç'të kisha bërë, o Andon Ledhi, që më nxive qershorin, më hidhërove me të afërmit, më neverite bar-lulishtet, detin, telefonin e apartamentit tim të bukur në rrugën e Postës?!...

Pse, o Andon Ledhi, — më shtyve deri aty e tani më bren ndërgjegjja dhe e ndiej veten fajtor?!...

*

*

*

Në një ditë të bukur qershori, në shtëpinë time, ndërsa dëgjoja e ridëgjoja në magnetofon pasazhe orkestrale nga simfoni të pavdekshme, u hap dera dhe m'u fut brenda vëllai im i madh, Rushani.

— Dëgjo, Muço, — më tha, — do të bësh çmos të pranohet në konservator djali i një mikut tim.

Bashkëshoqërimi muzikor i kësaj kërkesë ishte fare i papërshtatshëm.

Unë mblodha supet.

— Po këtë e ka në dorë komisioni i pranimit. Unë nuk bëj pjesë në komision.

— Je caktuar, — më tha, — i kemi marrë vesh të gjitha.

Këtu magnetofoni sillte në veshët tanë ca akorde madhore, monumentale dhe unë tendosa vëmendjen të mos më kalonte ky moment.

— Andon Ledhi quhet, dëgjon? Andon Ledhi... Ledhi, Andon!

Unë ndala magnetofonin dhe e vështrova në sy si i përhumbur.

Qetësi.

— Andon Kozma Ledhi! — theksoi im vëlla dhe u grrit e iku.

*

*

*

Im vëlla, Rushani, ishte i pari....

I dyti u bë Koçi, kushëriri i parë i gruas,

një tip i shkathët, i hedhur, si janë përgjithësisht kamerierët e lokaleve të kategorisë së parë. Ai më mori në telefon.

— Nesër, — më tha, — të pres në lokal. Kam një bisedë tepër të rëndësishme. Zëmë një tavolinë të qetë dhe bisedojmë më nge. Kam ditën e pushimit.

I vajta. Koçi porositi kafetë dhe, pasi pimë gllënjkat e para, vuri duart mbi filxhan, zgjati kokën përpara dhe më pa drejt në sy:

— Muço, dua të më bësh një nder. Kurrë s'të kam rënë në qafë. Kurrë s'të jam lutur. Për asgjë. Tani dua... mos më pyet si, qysh e pse!... Mbyll sytë e ma bëj.

— Pa të shohim, — i thashë.

— Oh, fillove ti me të shohim e s'të shohim! Thuaj s'ta bëj e pikë muhabeti!

Koçi u mërzit e piu dy gllënjka të tjera.

— Epo hë, — i thashë, — thuaje të shkretën! Ç'do nga unë?

— Do ma bësh? — dhe Koçit i ndritën sytë.

— Po... varet, a bëj dot...

— E bën ti, e bën!... Kam një njeri. Dua të ma futësh në shkollë. Për muzikë.

«Bobo!, mendova, filluan këto kërkesa të bezdëshme!» Kaq herë isha lutur të mos më përfshinin në komisionin e pranimit, por në fund të fundit më bindnin se pjesëmarrja në komision ishte një detyrë e rëndësishme.

— Do ta bëj! — i thashë. — Ka marrë fund!

— Më qafsh! Nuk do të ta harroj. Nuk besoja kurrë se do të thoshe po më të parën.

Unë i shtrëngova dorën me një lëvizje disi teatrale.

— E them dhe e bëj! Është ndonjë çikë i talentuar?

— Nuk marr vesh nga ato gjëra unë! — ia bëri Koçi i bezdisur. — Ti je profesor.

Profesor ziu! Të thonë profesor e të pengojnë të bësh detyrën e profesorit...

— Mirë, — i thashë, — po u binda që është i talentuar, do ta tund, do ta tund. Bile, bile, të them, zëre të mbaruar.

Po Koçi nuk ngopet me lugë të zbratur.

— E në mos qoftë aq... i zoti? — pyeti duke rrudhur vetullat i merakosur.

Unë vazhdoja të pija qetësisht kafënë.

— Po të mos jetë, nuk kam ç'i bëj.

Dhe kur e pashë që ai u mërzit, nxitova:

— Ama, po të jetë i talentuar, vendin e ka të sigurt.

— Po ajo s'do mend! — shtyu filxhanin e zbratur Koçi. — Po të jetë i talentuar, ai do të hyjë... Kjo ia bën muu! Ku qëndron atëherë nderi që do të më bësh?!

— Asgjëkundi! — ia ktheva. — Bile mund të mos më thuash fare falemnderit. Unë nuk do të të mërzitem.

Ai u prek.

— Tallesh me mua ti, apo si e ke hallin?! Unë flas seriozisht, ti më hedh degë më degë.

— Përse do të japë prova?

— Për violinë. Ama është djalë i mreku-llueshëm. Xhanan djalë. I vetëm. Prindërit lënë kokën për të. Është mësues në një shkollë fshati. Tre vjet u bënë. Ditë për ditë nga dy orë rrugë me biçikletë. Ti e kupton...

— Është përgatitur ndonjë çikë?

— Po di unë! — Koçi ngriti supet. — Më lë tabakaja mua? Duhet të jetë... Vetëm në

qoftë budalla, të mos jetë përgatitur. Sidoqoftë... shpresat te ti.

— Aaa... — nisa unë.

— Hë, o Muço, më qafsh, mos u bëj kaq buzëmbledhur dhe ti!

Këtu Koçi m'u afrua më shumë, shkeli syrin e djathtë dhe e uli zërin më shumë.

— Po të jetë i aftë, kjo të lehtëson, e duket sikur e fute ti. Po të mos jetë... po të mos jetë... shtyje ca ti, se me sa marr vesh unë, nuk bëhet qameti! Sos është pjano e madhe e do bjerë në sy ! Violina violi! Me shokë, Kur i biem njëzet veta njëherësh, giu-viu-giu-viuu! merret vesh i rashë keq unë apo i re ti?...

Unë qesha. Ca tipave si Koçi as nuk u mërzitësh dot. Pa le të marrësh përsipër t'u mbushësh mendjen se sa e shëmtuar është kjo lloj pune që kanë marrë përsipër... Nuk binden kollaj dhe të qepen më keq.

— Emrin, — i thashë për të mos e zgjatur më.

— Andon Ledhi.

Ja ku më doli për herë të dytë emri i tij.

— Pa prit, — i thashë, — për këtë Andonin më ka folur Rushani.

Koçi e kapi fluturimthi.

— Ja e sheh... Unë s'dua gjë. Të lutem, bëja nderin vëllait tënd! Po nuk ia bëre vëllait, haram qumështi, i themi ne!... Ka më të afërt se vëllai?!

*

*

*

Rushani i pari, Koçi i dyti... Pastaj nuk e mbaj mend radhën. Për Andon Ledhin më kapnin në rrugë, në institut, në bibliotekë. Më vi-

nin letra. Nga afër e nga larg. Për Andonin punonin postierët e binin zilet — ajo e telefonit për njerëzit që ishin larg, ajo e portës për ata që ishin afër. Orë e pa orë më zgjonin, pasdreke e në mes të natës e më thoshin që duhet ta kisha kujdes Andon Ledhin!... Andon Ledhin!

Iku qetësia.

Shitësi i mishit në lagje më buzëqeshte dhe më zgjidhte mishin më të mirë. Një ditë më pëstolli në letër një kokë dashi dhe, pasi ma zgjati nga sporteli, nxori dhe kokën e tij nga ai sportel e më tha:

— Interesohem për një njeri timin... Andon quhet. Andon Le...

Lashë kokën e dashit mbi banak, i ktheva krahët me neveri dhe dola nga dyqani i mishit.

Që atë ditë s'vura më mish në gojë.

— Ti, Muçi, diç ke, — më thosh gruaja një mbrëmje. — Nuk ke qenë kaq nervoz më parë.

— Nuk kam absolutisht asgjë! — i thashë duke qeshur.

Ishim duke pirë në një bar-lulishte. Mbrëmja qe e bukur, qielli i pastër, i spërkatur me yje të ndritshëm.

— Ti dhe natën në gjumë përpiqesh e gjëmon.

— Gjëmoj?!

— Po, po, gjëmon thellë.

Qesha me këtë përcaktim të padëgjuar dhe me buzën në gaz i bëra shenjë kamarierit të vinete që të shlyenim llogarinë.

Ai erdhi më buzagas se unë.

— Janë të paguara, — më tha.

Unë e vështrova në sy, duke pandehur se talllej.

— Po, po, vërtet janë të paguara. Ngrahuni dhe shkoni të qetë!

Po më merrej fryma.

— Kush të shkojë i qetë? — e pyeta dhe një herë.

— Ju, — tha ai buzagas si gjithnjë.

Gruaja më pa me frikë. Unë zieja i tëri.

— Dëgjo, shok i dashur! Më bëj llogarinë! Dua të paguaj!

— Në asnjë mënyrë! — ma ktheu ai. — Unë i mora njëherë paratë. Nga Kozma Ledhi.

Unë u ngrita me rrëmbim. Shishet bosh të birrës u tundën e çokitën njëra-tjetrën.

— Ku është ai? — thashë dhe pa pritur të ma dëftonte kamerieri hodha sytë përreth.

Të gjithë hanin e pinin qetësisht. Dukeshin të lumtur e të patronditur. Ua kisha zili qetësinë e tyre.

Kamerieri përkuli kokën dhe ashtu, i qeshur, iku me nxitim diku.

Po dridhesha. Ndjeva llërën e freskët të gruas sime, që më shtrëngoi krahun.

— Muçi, eja! — më tha ajo ngadalë, duke u munduar të më heqë që andej.

Ishte e padurueshme ajo ndjenjë. Nxora paratë, bëra llogarinë me mend, e mbështolla kartëmondhën fishek dhe e ngula në grykën e një shisheje të zbrazur.

— Ikim! — i thashë gruas.

Më shtiu hidhësinë në shpirt ky njeri. Më helmoi. Po më bënte mizantrop.

Sapo shihja të më buzëqeshnin, tkurresha. Dhe ndonjë shërbim që më bëhej, ashtu siç ia bëjmë njëri-tjetrit për ditë, me shpirt të pastër, tani e prisja me një lloj frike... Nuk falenderoja, por prisja a do të më kërkonin të ndihmoja në konkurs atë, Andonin.

Një ditë dikush më liroi vendin në autobusin urban. Unë nuk u ula, por e pashë në sy.

— Uluni, — përsëriti ai me mirësjellje.

— Hë, — i thashë, duke tundur kokën, — keni ndonjë kërkesë për të më bërë?

Bashkudhëtari u habit.

— Asnjë kërkesë, — tha si pa të keq. — Ju më dukeni i lodhur e pikë. Thashë t'jua liroj vendin. Aq më tepër që unë do të zbres në stacionin tjetër.

Ja ç'telashe po më sillte puna e këtij Andonit! Kush ishte ky Andon? Si ishte? E përfytyroja të shkurtër, flokëzi, me sy gjysmë të mbyllur, dhëlparak.... Duart duhej t'i kishte të mëdha e krahët leshatorë.

— Kisha nevojë të çlodhesha nga kjo fushatë fantastike që kish hapur i ati i tij, për të fituar votën time. Nuk më pëlqente aq deti, se më pëlqente shkëputja, largimi e qetësia për ca kohë.

Për konkursin kishte ende kohë, prandaj do të bëja mirë të dëgjoja gruan e të shkoja me fëmijët në plazh, larg Koçit e Rushanit. Larg Andonit!...

—

* *

Në vargun e kabinave të plazhit, Andoni kishte dy të njohur. Njëri ma përmendi çështjen e tij ditën e pestë, tjetri të shtatën. Të parin e kisha në të majtë, ngjitur. Tjetrin, tri kabina më tej, në të djathtë.

Ata kishin qenë vërtet të pamëshirshëm. Ma kujtonin violinistin Andon nga tri-katër herë në ditë, kur shtriheshin nën çadra, kur u blinin akullore fëmijëve, kur luanim «pesëkatëshin», ku

shpesh ma linin në dorë derrin-maç, që më dukej si fotografi e Andon Ledhit me sytë gjysmë të mbyllur e me llërët e zeza leshatore.

Aq e padurueshme ishte kjo për mua, sa që shpesh ndahesha nga fqinjët e mi, pa i ftuar futesha në det, duke u munduar të lahesha sa më larg prej tyre. Po ata nuk më ndaheshin e si dy kaçatorpedinierë që shoqërojnë kryqëzorin, më vinin nga të dyja anët — njëri me krol e tjetri me shpinë.

— I ati i Andonit, Kozmai, ka punuar rrobaqepës tok me kunatin tim, — nisi njëri syresh, ndërsa notonim drejt bregut, të lodhur nga deti — I ati i Andonit...

Nuk durova më.

— Ju lutem, — i thashë, — mjaft më! Duri mi ka një kufi. Unë kaq e kam kufinë. Ja ku po jua them sot: atë të atin e Andonit e urrej. Bile dhe Andonin e urrej. I thoni të mos më dalë përpara, se do të bëj ndonjë të pabërë. Dhe ju më lini rehat! Dëgjuat? Më lini rehat!

Dhe një t'u kthyer vërtik e ia mbajta tej nga thellësia. Nervozizmi ua shtoi gjallërinë krahëve të mi të lodhur dhe unë çaja e çaja valëzat e lehta, duke iu larguar dy shokëve që më bezdisnin. Pastaj ngrita kokën e, si pashë që ata po dilnin në rërë, bëra të kthehem.

Këtu më lanë fuqitë dhe ula këmbët të çlodhësia. Piva ujë. U kollita dhe u zhyta nja tri herë, dhe kjo punë do të kishte mbaruar ters, po të mos kalonte andej motoskafi i ndihmës së shpejtë, që si duket e kish pikasur që larg se ç'lloj notari isha.

U kacavara në të e me muskujt të stërlodhur u ngjita lart.

— Desh u mbyta, — thashë duke gulçuar. — Më lanë fuqitë.

— Të vura re, — ma ktheu piloti i motoskafit, një burrë i thinjur, me një kanotierë të bardhë, që dukej pak e ngushtë për krahët e tij të shëndetshëm.

— Piva ca ujë... Të falemnderit!

— S'ka gjë, s'ka gjë — dhe piloti më vështronte ngrohtë me simpati. — Ju merreni me muzikë?

— Po, — ia ktheva, — e... e... e... pastaj?

— Kam dhe unë një djalë...

«Babai i Andonit! — thashë dhe më një të ngritur e bëlldum(!) prapë në det. — Në djall motoskafi! Nuk e dua!»

Po plakushi më zuri nga thembra e këmbës dhe më ngjiti përsëri në bord. Dukej tepër i nxehur.

— Mos luajte menç? Ëh, ç'pate?!

— S'kam më nevojë, — ia ktheva.

— Po nuk të lë unë, — bërtiti thinjoshi i fuqishëm. — Pa më thuaj, njëherë, ç'pate? Ç'të bëra? Ç'të thashë?

Unë ula kokën. Ai i dha gaz motorit pa më thënë asnjë fjalë.

— Juve mos ju quajnë Kozma? — e pyeta unë me drojtje.

— E pse duhet të më quajnë Kozma? Phë, çfarë pyetje!

Unë u lirova.

— Ç'deshët të më thoshit për djalin?

Fytyra e tij u zbut, pastaj u bë e menduar.

— Më doli nga mendja tani... Se ti desh më ike nga duart... S'më kujtohet.

— Për djalin... për muzikën...

— Ah, po! — u kujtua detari. — Kam një djalë

që desh të futej në shkollë për muzikë. I binte pianos. Pyeta mirë e mirë. Ata që kishin haber nga kjo punë, domosdo. Ata mblihdnin supet. «Ç'ka, — thanë, — edhe shtyhet». Aha! Me të shtytur s'e lashë unë. Sa të hiqet zvarrë e të ketë zili shokët e talentuar, më mirë një zanat tjetër dhe pianos le t'i bjerë për qëjft... S'e lashë. Qau ca, po ama gjeti vendin e tij.

Plaku dukej i kënaqur.

— Kam djalë të mirë, — tha dhe qeshi.

Unë e preka lehtë në gju. Me droje. Me respekt. Me dashuri.

*

*

*

Fundi i historisë me Andonin tani...

Ai u paraqit para komisionit që ditën e parë. Ishin provuar shtatë vetë para tij.

Sekretarja qëroi zërin e lajmëroi:

— Andon Ledhi!

Ngrita kokën e ngula vështrimin te dera. Ja, tani do të hynte ai. Hyri. Ish një djalë i hollë, bjond; me sy të mëdhenj bojë qielli, me një pamje naive, që buzëqeshte i drojtur.

Domethënë ky ishte Andoni. Ai Andoni i famshëm. Ç'kisha hequr unë për të!

Ai u përqendrua dhe ngriti harkun. Unë ia ngula sytë. Vetëm me sy e ndiqja Andonin. Veshët nuk më punonin më. E shikoja dhe më vinte inat që nuk ishte ashtu, leshator, si e pata përfytyruar. Harkun e lëvizte me shkathtësi dhe elegancë, po unë nuk dëgjoja asnjë tingull violine. Vetëm shikoja. Mbi harkun e tij kishin hipur e porrinin në gjunjë, me duar të zgjatura nga komisioni tërë miqtë e tij: im vëlla Rushani, kamerier

Koçi, kasapi i lagjes dhe fqinjët e mi të plazhit me rroba banjoje. Binin që të dyja zilet: e telefonit dhe e portës. Trokisnin postierët. Të gjithë më pengonin ta dëgjoja e ta vlerësoja si duhej.

Pashë që djaloshi mbaroi ekzekutimin, lëshoi instrumentin dhe na buzëqeshi me turp.

— Jeni i lirë, — tha kryetari ynë.

Andoni përshëndeti e doli.

Kur votuam për të, ndodhi diçka e çuditshme. U krijua një gjendje barazie. Katër anëtarë ishin për pranimin e tij e katër jo. Nuk kishim votuar unë dhe Llazari, prandaj votat tona vendimtare priteshin me interesim.

— I pakalueshëm, — thashë unë me duf.

Llazari uli kokën dhe u mendua pak.

— Ashtu them dhe unë, — ia bëri më në fund.

— Le të përgatitet përsëri vitin tjetër... Ta dëgjojmë dhe një herë.

Mbaroi kjo punë. Andon Ledhi nuk e fitoi konkursin.



Po ktheheshim në shtëpi tok me Lllazarin. Që të dy ecnim të menduar.

— Ai Ledhi nuk ishte keq, — tha befas Lllazari.

— Nuk e kam idenë, — thashë hapur. — Nuk e dëgjoja.

— Ai ishte përgatitur kënaqshëm.

— Po atëherë, — e pyeta, — përse nuk ia dhe pëlqimin?

Ai shfryu e nuk foli.

— Le të vijë vitin tjetër, — tha pastaj. — Me siguri do të fitojë. Humbi një vit. Për fajin e tij.

Mbase vë mend. — Dhe befaz e ndali hapin. —
Dëgjo, Muço, — më tha. — Ti ke qenë rehat e
nuk ma kupton dot gjendjen time. Ky Andoni
me të atin më torturuan një muaj plot, duke më
fatur njerëz. Ti as e merr dot me mend se ç'bez-
di është. Ja, tani një vit do të më brejë ndër-
gjegjja. Pthtu! Ta marrë-dreqi! Vetë e kanë fa-
jin! Hm!

288

VALIA VALIA VALIA

VALIA — Is për vuanë kurorë... Bashkëbortor-

VALIA — U bëra plot dy javë që jam në...

VALIA — Dëni dot... Po larturore këna për...

VALIA — Nuk ka shok më të atit se gruanë...

VALIA — Buktësi thotë (Befaz) Po për fat...

VALIA — Në kam pyetur nga elashkënie jo...

VALIA — Në dëgjuarë. Po ti e dashur?

VALIA — Unë kam lëndur këtu...

VALIA — E tmerzohem sikur të mos këso...

VALIA — E më bëhet qetill (Befaz) Po ku qapan...

VALIA — Në veshorë. Po ti e angjëlli më...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

VALIA — Në...

SA HAP E MBYLL SYTË

Skeç

NETAT: VAJZA DJALI

VAJZA — Ja pra vumë kurorë... Bashkëshortorë... Sa bukur!

DJALI — U bënë plot dy javë që jemi njohur e deri dje që celebruam fejesën më duket sikur jam... sikur po fluturoj.

VAJZA — Edhe unë!... Po fluturojmë krah për krah.

DJALI — Nuk ka shok më të afërt se gruaja, themi ne andej nga krahina jonë.

VAJZA — Bukur e thoni... (Befas) Po, për fat, s'të kam pyetur, nga cila krahinë je ti, i dashur?

DJALI — Nga Guguzhara. Po ti, e dashur?

VAJZA — Unë kam lindur këtu...

DJALI — E tmerrshme, sikur të mos kishe lindur. I mjeri unë, i mjeri!

VAJZA — Sot në punë më uruan që të gjithë.

DJALI — Sa më bëhet qejfi! (Befas) Po ku punon ti, shpirt?

VAJZA — NË NSHOPQR. Po ti, engjëlli im?

DJALI — NË NRSSHTTHUVXXHYZZH...

VAJZA — Harrova të të them, mua sot në punë

më pyetën: «Tani këtu në ndërmarrje do të mbash mbiemrin tënd apo të burrit?»

Unë e humba fare.

DJALI — Të hutoi pyetja?

VAJZA — Jo, përgjigjja!... Në u njohëm e u fejuam kaq shpejt, sa unë... unë... unë nuk ta di as mbiemrin.

DJALI — Ashtu?! (*Befas i nxehur jashtë mase.*)
Ashtu?! Kjo është fyerje! Injorim... Harrim! Nënvlleftësim!

VAJZA — Ti po shkon?

DJALI — Po!

VAJZA — Ku do të takohemi, shpirt?

DJALI — Në gjyq. Po... (*Zhvendoset dhe i flet gjykatësit imagjinar*) Dua të ndaj gruan... (*duke theksuar.*) Ka dy javë që po bashkëjetojmë dhe s'më di mbiemrin... Padi!... Falemnderit!... Si? Si ma quajnë gruan? (*Hutohet, i ikën inati, pastaj singerisht.*) Oh, unë i harrova emrin... Ishte kaq e shpejtë sa... lëre bosh!... Do ta ndaj!

AFRODITE DHE KUNDERAHOJE

Komedi me një akt

VEHET: AKKAKOVI — komediant i famshëm i Berlinit
DOKU — komediant i famshëm i Berlinit
DOKU — komediant i famshëm i Berlinit
DOKU — komediant i famshëm i Berlinit
DOKU — komediant i famshëm i Berlinit
DOKU — komediant i famshëm i Berlinit



AEROPLANË DHE KUNDËRAJRORE

Komedi me një akt

VETAT: AKSAKOVI — ambasador sovjetik PULIMJOT-ÇIKU — gjeneral, atashe ushtarak KONDRATJEVI — sekretar i Aksakovit TUMBARAMBA I TRETË — mbreti i një shteti afrikan GUNGAMONGONI SHTATË — mbret, kundërshtar i tij ROXHERSI — ambasador amerikan.

Ngjarjet zhvillohen në ditët tona. Skena paraqet zyrën e ambasadorit sovjetik Aksakov. Aksakovi mundohet të marrë lidhje në telefon.

AKSAKOVI — Këtu në Afrikë çmendesh... S'lidhem e s'lidhem dot me ambasadën amerikane. (Në telefon) Alo! Alo! Jam Aksakovi, ambasadori sovjetik!

(Në zyrë futet, nga jashtë, gjenerali Pulimjotçik.)

PULIMJOTÇIKU — (Duke marr frymë me zor.) Me amerikanët nuk lidhesh dot. Ambasadën amerikane e kanë rrethuar.

AKSAKOVI — Demonstratë?

PULIMJOTÇIKU — Këta afrikanët janë tërbuar fare. Qëllojnë me ç't'u vijë për dorë. Mezi kalova me veturë. Bërtasin: «Jashtë të huajt nga Afrika!»

AKSAKOVI — E kanë për amerikanët. Ne na duan.

PULIMJOTÇIKU — (E zë lemza) Hëp! (Aksakovit, që e shikon me habi) Më falni, tavarish Aksakov, por kohët e fundit, sa herë themi ndonjë gënjeshtër, në vend të më skuqet faqja, më zë lemza.

AKSAKOVI — E ç'gënjeshtër u tha këtu?!... Afrikanët ne na duan!

PULIMJOTÇIKU — Hëp!

AKSAKOVI — Na duan, të them!

PULIMJOTÇIKU — Hëp! (Duke sqaruar.) Na duan, por na duan jashtë Afrikës... Në rrugë he dhin parulla: «Amerikanë dhe sovjetikë, mjaft bëtë intriga! Shporruni!» Ka rrezik të vijë dhe këtu.

AKSAKOVI — Le të vijnë po të duan. Tani më
thuj ç'u bë për shitjen e tankeve tona so-
vjetike në Suku Suku?

PULIMJOTÇIKU — Dje parlamenti i shtetit
Suku Suku vendosi t'i blejë tanket nga
amerikanët.

AKSAKOVI — Nga amerikanët?! Na e hodhën.
(Vërtitet nëpër dhomë i xhindosur.)

PULIMJOTÇIKU — (Duke shijuar lajmin që do
të japë.) Dhe ne s'do të mbetemi pa gjë.
Në sallën presin të hyjnë te ju zoti Tum-
baramba e zoti Gungamongo, mbretërit e
dy shteteve të vogla që janë në luftë me
njëri-tjetrin.

AKSAKOVI — Përse e kanë konfliktin?

PULIMJOTÇIKU — Për një ishull. Për atë ishull
deri tani janë vrarë tridhjetë e tre mijë
veta nga të dy palët. Të dy duan përkrah-
jen tonë. Cili mbret do të përkrahim?

AKSAKOVI — Atë që do të blerë armë nga ne.
Të futen këtu një nga një.
(Pulimjotçiku del. Aksakovi ruan ende ina-
tin e parë. Duke u vërtitur nëpër dhomë.)
Amerikanët....

Intrigantët. I shitën tanket.

KONDRATJEVI — (Lajmëron solemnisht.) Ma-
dhëria e tij mbreti Tumbaramba i Tretë,
i mbiquajtur i Madh! (Hyn Tumbaramba
i shoqëruar nga Pulimjotçiku. Aksakovi
e mbreti puthen sipas zakonisht vendas.)

TUMBARAMBA — Jemi miq?

AKSAKOVI — Miq.

(Pulimjotçikun e zë. lemza. Aksakovi e
mbreti puthen përsëri.)

TUMBARAMBA — Ata pretendojnë ishullin e
vogël në mes të lumit... Amerikanët e tho-
në copë se ai është yni...

- AKSAKOVI — Kush e ka pasur më parë këtë ishull?
- PULIMJOTÇIKU — Askush. Ishulli s'ka dalë akoma mbi ujë.
- AKSAKOVI — Si është e mundur?
- PULIMJOTÇIKU — Në mes të lumit që ndan kufirin e dy shteteve është një ishull vullkanik, që vjen duke dalë nga lumi avash-avash... Ç'do vit ngrihet nga njëzet centimetra... Shkencëtarët parashikojnë që ky ishull të dalë në sipërfaqe pas njëqind e shtatëdhjetë vjetësh.
- TUMBARAMBA — Ai do të dalë! Dhe ai ishull na takon ne, dhe vetëm ne!
- AKSAKOVI — E përse juve dhe jo Gungamogos, armiqve tuaj? Mos ishulli do të dalë më afër brigjeve tuaja?
- PULIMJOTÇIKU — Jo, ai po del mu në mes.
- TUMBARAMBA — Ai po del në mes, por zot i ishullit quhet ai që e shkel i pari.
- AKSAKOVI — Mos vallë e ka shkelur njeri këtë ishull të fundosur?
- TUMBARAMBA — Po! Të mbyturit tanë.
- AKSAKOVI — Po kundërshtarët tuaj nuk janë mbytur atje?
- TUMBARAMBA — (*Me triumf*) Janë mbytur. Janë mbytur, po nuk kanë takuar dhe... Kanë lundruar mbi ujë. Dhe ne sot kemi ardhur të blejmë aeroplanë nga ju. Do t'i shfarosim Gungamongot. Duam ishullin tonë!
- AKSAKOVI — Mos e zgjat, shkëlqesi! Ai ju takon juve.
- TUMBARAMBA — (*Shtrëngon dhëmbët*) Jashtë kam ministrin e thesarit. A mund t'i marr aeroplanët që sot?
- AKSAKOVI — Po njoftojmë Moskën t'i nisin.

- TUMBARAMBA — Punë e mbaruar?
- AKSAKOVI — E mbaruar.
- TUMBARAMBA — Na i shitët?
- AKSAKOVI — Jua shitëm.
- TUMBARAMBA — I blemë. Nuk janë stoqe?
- AKSAKOVI — Jo, nuk janë stoqe.
- PULIMJOTÇIKU — Hëp! *(Nxiton të mbyhtë lemzën) Urdhëroni, madhëri! (E shoqëron jashtë. Në paradhomë dy mbretërit, takohen ballë për ballë dhe shohin njëri-tjetrin me hakërrim. Pulimjotçiku e shmang konfliktin. Kondratjevi lajmëron të dytin.)*
- KONDRATJEVI — Madhëria e tij, mbreti Gungamongo!
(Mbreti Gungamongo hyn dhe bën një përshëndetje karakteristike. Aksakovi i buzëqesh, i zgjat dorën, por mbreti tërhiqet dhe fëshet nxjerr një notë.)
- GUNGAMONGO — *(Lexon)* «Ne, mbreti Gungamongo i Shtatë, pasardhës i mbreti Gungamongo i Parë që e vranë, i Gungamongos së Dytë që e therën, i Gungamongos së Tretë që e varën, i të Katërtit që e helmuan, i të Pestit që i nxorën sytë dhe i të Gjashtit që e mbytën në pus, në emër të shtetasve parashtrojmë sa vijon: pika e parë: Protestoj... Protestojmë për veprimin e pabesë të qeverisë sovjetike. Kundërshtari ynë i urryer Mbreti Tumbaramba i Tretë erdhi këtu të blinte aeroplanë... Nga surrati i tij i kënaqur e kuptuam se ju ia paskeni shitur. Kështu ju shkëlmuat miqësinë me ne».
- PULIMJOTÇIKU — Madhëria juaj e pahelmuar, e pambytur dhe e patherur
- GUNGAMONGOJA — E mohoni?
- AKSAKOVI — Nu... Nuk e mohojmë. E pastaj?

GUNGAMONGOJA — (Vazhdon leximin) «Në emër të shtetasve, ne Gungamongo i Shtatë ju shprehim revoltën tonë. (Irevoltuar, ngaqë nuk ka ç'të bëjë, gabimisht gris notën në dy pjesë dhe më tej vazhdon të lexojë ca andej ca këndej.) Ju veproni si tregtarë armësh, si matrapazë, që për hir të leverdisë lini mënjane çdo parim...»

PULIMJOTÇIKU — Madhëri, ule pak zërin, po nuk deshe të vesh pas të Gjashtit!

AKSAKOVI — Kë quan ti matrapaz armësh?! Ne?! Shtetin e madh sovjetik?! (Nxjerr këpucën mbi tavolinë.) A nuk e di ti që në jemi shtet socialist?!

PULIMJOTÇIKU — Hëp! Nuk e di ti?!

AKSAKOVI — Ne ruajmë gjithnjë parimet! Ne ndihmojmë vetëm ata që bëjnë luftë të drejtë.

PULIMJOTÇIKU — Hëp! Vetëm ata.

GUNGAMONGOJA — Të drejtë kemi ne. Ne duhet të na ndihmoni.

AKSAKOVI — Jo. Të drejtë kanë ata.

GUNGAMONGOJA — Ne!

AKSAKOVI — Ata!

GUNGAMONGOJA — Kështu?! (Pauzë) Ju luftën tonë nuk e quani të drejtë.

AKSAKOVI — Aspak!

GUNGAMONGOJA — Dhe nuk bëni tregti armësh?

AKSAKOVI — Jo.

PULIMJOTÇIKU — Ne nuk jemi matrapazë. Hëp!

GUNGAMONGOJA — Atëherë ne s'kemi ç'bëjmë këtu. Po largohemi.

AKSAKOVI — Largohu.

GUNGAMONGOJA — Pa e shtjelluar pikën dy?

AKSAKOVI — Pa e shtjelluar pikën dy. Pse, ç' thotë ajo pika dy?

GUNGAMANGOJA — Thotë se për të rrëzuar aeroplanët që i shitët ju armikut tonë, ne duhet të blejmë një mijë kundërajrorë... Por po e shohim që po kthehemi duar-bosh... Po shkojmë në ambasadën amerikane. Do t'i blejmë kundërajrorët nga amerikanët.

(Mbreti bën të dalë. Lëvizje të shqetësuarra të rusëve.)

PULIMJOTÇIKU — Shkoni, por ambasada amerikane është e rrethuar.

AKSAKOVI — Në fakt nuk e kishit menduar keq. Se ne nuk do t'ju shisnim vetëm kundërajrorët, por dhe sekretet e dobësitë e aeroplanëve tanë rusë, që do të kenë armiqtë tuaj.

GUNGAMONGOJA — A pa-pa-pa! Ah, sa mirë do qe! Kundërajrorët rusë. Rrëzojnë aeroplanë rusë... Po ç'e do! Ju s'na jepni të drejtë.

PULIMJOTÇIKU — Ama hollë-hollë, tavarisht Aksakov, edhe këta janë pa të drejtë.

AKSAKOVI — Eh?

PULIMJOTÇIKU — Nuk janë fare pa të drejtë dhe këta them.

AKSAKOVI — *(Me inat)* Kush tha që janë fare pa të drejtë!

PULIMJOTÇIKU — Nuk ka turp më të madh se të lejojmë që kundërajrorët amerikanë të rrëzojnë aeroplanët tanë.

AKSAKOVI — Po, po, po!... ku do të futej pastaj krenaria jonë kombëtare ruse! U vendos: aeroplanët tanë do t'i rrëzojmë ne vetë.

GUNGAMONGOJA — *(I gëzuar)* Se ai ishull në

mes të lumit është yni... Kështu na thanë dhe amerikanët.

AKSAKOVI — Nuk kemi asnjë dyshim që ju takon juve. Pulimjotçik, përcille madhërinë e tij të bëjë formalitetet. Të merren masa që specialistët tanë të vijnë bashkë me kundërajrorët.

GUNGAMONGOJA — *(Me dyshim)* Po këta specialistët, janë vërtet specialistë?

AKSAKOVI — Specialistë!

PULIMJOTÇIKU — Hëp!

GUNGAMONGOJA — Mos janë nga ata që të lidhin natën në gjumë?

AKSAKOVI — Njet, njet, njet!

PULIMJOTÇIKU — Hëp! Flini të qetë ju!

(Gungamangoja i Shtatë nderon në mënynyrë karakteristike dhe ndalet në një puthje të gjatë buzë më buzë me Aksakovin.)

GUNGAMONGOJA — *(Duke dalë, Pulimjotçikut)*

Se shiko, zotëri, ai ishulli në mes të lumit...

PULIMJOTÇIKU — *(Duke e shoqëruar.)* Jo ishulli, por edhe lumi është juaji. *(Del pas tij.)*

AKSAKOVI — *(Me vete)* Dhe po të ankohen tumbarambat, ne do t'u shesim atyre aeroplanë të tjerë që fluturojnë shumë më lart, aty ku nuk arrijnë kundërajrorët... Kështu, zotërinj amerikanë. Na e hodhët, jua hodhëm.

(Hyn me nxitim Pulimjotçiku.)

PULIMJOTÇIKU — Demonstruesit kanë pushtuar ambasadën amerikane dhe po vijnë drejt nesh...

AKSAKOVI — Çort! Dhe kjo na duhej...

PULIMJOTÇIKU — Thonë që ambasadorin Roxhers e kanë vrrarë. Ca thonë që Roxhersi është zhdukur.

(Kondratjevi vjen të lajmërojë.)

KONDRATJEVI — Zoti Roxhers, ambasadori amerikan!

(Hyn Roxhersi i dërrmuar, i ndotur në fytyrë.)

AKSAKOVI — Ky nuk është Roxhersi!

PULIMJOTÇIKU — Ai është, po nuk njihet... E kanë qëlluar me vezë në fytyrë.

ROXHERSI — U strehuam te ju. Këta janë të papërmbajtur... Po vijmë këtu.

AKSAKOVI — Qetësohuni, zoti Roxhers!
(Ndihet afrimi i turmës. Thirrje. Del i qeshur në ballkon.) Miq të dashur afrikanë, ne duam vetëm të mirën tuaj!

PULIMJOTÇIKU — Hëp!...

AKSAKOVI — ...lumturinë tuaj.

PULIMJOTÇIKU — Hëp!...

AKSAKOVI — ...begatinë tuaj, përparimin.

PULIMJOTÇIKU — Hëp! Hëp!

(Që jashtë qëllojnë me sende të ndryshme. Pas pak Aksakovi lthehet nga ballkoni me fytyrë të ndotur si Roxhersi dhe ulet serioz pranë tij. I ndezin njëri-tjetrit cigaret. Që jashtë vjen zhurma e revoltës nga gjokset e afrikanëve.)